

DIVORCI NE REALITETIN SHQIPTAR TE TRANZICIONIT

Doktorante: Alketa Molla

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në profilin
Sociologji-Antropologji Sociale, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Aleksandër DHIMA

Numri i fjalëve: 50.410

Tiranë, Prill 2016

DEKLARATA E AUTORËSISË

Unë deklaroj dhe mbaj përgjegjësi se ky punim është shkruar prej meje dhe nuk është paraqitur asnjëherë para një institucioni tjetër për t'u vlerësuar. Në këtë punimi nuk përfshihen materiale të shkruara nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe referuara.

ABSTRAKTI

Ndryshimet politike në Shqipëri pas viteve 90-të u shoqëruan dhe me ndryshime ekonomike, social-kulturore. Si pasojë e këtyre ndryshimeve shoqëria shqiptare u hap sepse kishte qenë e mbyllur. Kemi dhe emigracionin si pasojë e vështirësive ekonomike me të cilat u përball shoqëria jonë. Kjo gjë ndikoi në rritjen e numrit të divorceve në vend.

Divorci është bërë një problem i mprehtë në shoqërinë shqiptare të tranzicionit. Vit pas viti, numri i tyre ka ardhur në rritje, sidomos këto vitet e fundit. Janë një mori shkaqesh që çojnë një çift drejt divorcit, duke filluar nga ato më të rëndomta, si mospërputhje karakteri, e deri tek më të rënda, si dhunë fizike e psikologjike.

Përgjithësisht, problemet më të mëdha i kanë çiftet, që kanë njërën nga partnerët në emigracion. Mungesa fizike e partnerit shoqërohet me një sërë vështirësish për partnerin tjetër. Gratë të vetme, duhet të merren me përkujdesjen ndaj familjes, pa e pasur bashkëshortin pranë. Largësia për një kohë të gjatë është një faktor që ndikon drejtëpërdrejt në ftohje të marrëdhënieve në çift, e cila shpesh shoqërohet më vonë me divorc. Kur problemet në çift janë evidente dhe të pakapërcyeshme, partnerët vendosin t'i japin fund martesës. Një martesë merr fund nëse ajo nuk funksionon më dhe e ka humbur kuptimin e saj.

Hapja e shoqërisë ka ndikuar gjithashtu edhe në njohjen dhe ballafaqimin e kulturës sonë me kultura të vendeve të tjera. Kjo gjë ka sjellë rritje në emancipimin e grave për të drejtat dhe liritë e tyre në familje si dhe krijimin e kulturës së divorcit. Ndryshe nga shoqëritë e tjera, ku kultura e divorcit shihet si barazi e partnerëve gjatë martesës, në Shqipëri ajo shihet si një reagim i grave, duke bërë kërkesën për divorc kur u shkelen të drejtat.

ABSTRACT

The political changes in Albania after the '90s were accompanied with economic changes, social and cultural. As a result of these changes Albanian society which until that moment had been closed began to open. Another change was the migration that occurred as a result of the economic difficulties. This contributed to the increase of divorce in the country. Divorce has become an acute problem in the Albanian transitive society. Year after year, their number has increased, especially in recent years.

There are a variety of reasons that lead a couple to divorce, ranging from more common as the character inconsistencies, to the more serious as the physical and psychological violence.

Commonly, larger problems belong to couples who have one of the partners abroad. Physical lack of a partner is associated with a number of difficulties for the other one. Single women, have to take care for the family without having a man nearby. Distance for a long time is a factor that directly affects the defacement of relations in a couple, which is often

associated with a later divorce . Even when problems are evident and insurmountable, partners decide to break up. A marriage ends if it does not work anymore and has lost its meaning.

Opening of society has also affected in recognizing and dealing of our culture with the cultures of other countries. This has led to a growth of emancipation of women for their rights and freedoms in the family and creating a culture of divorce. Differently from other societies, where the culture of divorce is seen as equality between partners in marriage, in Albania we see it as a reaction of women asking for divorce when their rights are violated.

DEDIKIMI

Këtë punim ua dedikoj fëmijëve dhe bashkëshortit tim, që më kanë ndihmuar dhe më kanë qëndruar pranë gjatë kohës së kryerjes së tij.

FALËNDERIME

Falenderim dhe mirënjohje për psikologët e Gjykatës së rrethit Elbasan, Najada Matraxhiu dhe Eriona Hoxha.

Dua të bëj një falenderim të veçantë për Najadën për ndihmën e madhe që më ka dhënë në ofrimin e materialeve shumë të rëndësishme për kryerjen e studimit.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KAPITULLI I: HYRJE	1
1.1.Hyrja.....	1- 4
1.2. Parashtrimi i problemit.....	4-8
1.3. Rendesia e studimit.....	9-10
1.4. Qëllimi dhe objektivat e studimit.....	10-12
1.5. Pyetjet kërkimore.....	12-16
1.6. Përkufizime të koncepteve kryesore.....	16-17
1.7. Kufizimet e studimit.....	17-18
1.8. Organizimi i studimit.....	19-20

KAPITULLI II: SHQYRTIMI I LITERATURËS

2.1. Shfrytëzimi i literaturës së huaj. Kufizime në literature.....	21-22
2.2. Përdorimi i katër teorive të mëdha sociologjike në interpretimin e divorcit...22-25	
2.3. Perspektivat kryesore në fushën e studimit të divorcit.....	25-26
2.4. Autorët më të shquar në studimet mbi divorcin.....	26-28
2.5. Studime empirike mbi divorcin të kryera në rajon e më gjerë.....	28-39
2. 6. Shfrytëzimi i literaturës shqiptare.....	39
2. 7. Shkaqet e rritjes së divorcit në Shqipëri	40-42
2. 8. Të dhëna statistikore mbi martesat dhe divorcet në Shqipëri pas viteve 90..	43-45
2. 9. Problemet me të cilat përballen sot shumë martesa dhe familje në Shqipëri..	45-46
2. 9. 1. Dhuna në familje dhe divorci si pasojë e saj.....	47-50
2. 10. Ndikimi i emigracionit në jetën bashkëshortore dhe atë familjare.....	50-53
2. 10. 1. Statusi civil i emigrantëve në Greqi.....	53-54
2. 11. Ndikimi i kushteve ekonomike tek divorci ose pamundësia për të bërë	

divorc.....	54-55
2. 12. Barazia gjinore në martesë.....	55

KAPITULLI III: METODOLOGJIA

3.1. Përshkrim i përgjithshëm.....	56-61
3.2. Popullata dhe kampionimi.....	61
3.2.1. Popullata.....	61
3.2.2. Kampionimi.....	61-62
3.2.3. Qasja e kampionimit të studimit.....	62-64
3.2.4. Të dhëna mbi pjesëmarrësit në studim.....	64-65
3. 3. Realizimi i studimit.....	65-66
3.3.1. Realizimi i intervistave të drejtëpërdrejta.....	66-67
3. 3. 2. Realizimi i grupeve të fikurit	67-68
3.4. Strategjia e përpunimit të të dhënave.....	68-70
3.4.1. Ndërtimi i udhëzuesit gjysmë të strukturuar.....	70
3. 4. 2. Zbardhja e të dhënave të mbledhura nga intervistat dhe fokus-grupet.....	71
3. 4. 3. Përpunimi dhe analiza e të dhënave.....	71

KAPITULLI IV: ANALIZA

4.1. Shkaqet e divorceve në Shqipëri.....	73-75
4.1.1. Ftohja e marrëdhënieve bashkëshortore si shkak për divorc.....	75
4.1.2. Konfliktet e vazhdueshme ndërmjet bashkëshortëve.....	75-77
4.1.3. Tradhëtia bashkëshortore dhe pasojat e saj në martesë.....	77-86

4.1.4. Bashkëshortët përdorues alkooli	86-87
4.1.5. Dhuna fizike dhe psikologjike ndaj bashkëshortes	87-88
4.1.6. Ndërhyrjet e prindërve të bashkëshortëve në marrëdhëniet e çiftit.....	88-92
4.2. Ekonomia një faktor kyç në rritjen e divorceve.	92-95
4. 2. 1.Gjendja ekonomike e çifteve para dhe pas divorcit	95-96
4.2.2. Gjendja ekonomike e çiftit pas martesës, gjatë periudhës që janë bërë më fëmijë, si dhe para divorcit.	96-99
4.2.3. Gjendja ekonomike e çifteve që kanë shkuar në divorc.	100-108
4.2.4. Gjendja e punësimit ndër çiftet e divorcuara.	109-112
4.3. Divorci në Shqipëri dhe problematika që mbart ai.	113- 114
4.3.1. Faktorë që kanë ndikuar në divorc.	114-117
4. 3. 2. Shkalla e arsimimit tek partnerët e divorcuar dhe diferenca moshore	117-120
4.3.3. Zona në të cilat divorcet janë më të shpeshta	121
4.4. Faktorët e brendshëm që ndikojnë në divorc	121- 125
4.4.1. Si janë realizuar martesat që kanë shkuar në divorc?.....	125
4.5. Ndikimi i emigracionit në marrëdhëniet bashkëshortore.....	126-132
4. 5. 1. Marrëdhëniet bashkëshortore gjatë ribashkimit të çiftit në emigracion.....	133-135
4. 6. Ndryshimet në mënyrën e jetesës së çiftit me ndryshimin e sistemit politik në Shqipëri	

..... 136- 138

4.6.1. Ndërhyrja e shtetit për uljen e shkallës së emigracionit..... 138-141

4.6.2. Masat që ka ndërmarrë shteti për të frenuar emigracionin dhe rritur punësimin
.....141-142

4. 7. Vështirësitë në aspektin psikologjik të përballimit të situatës pas divorcit si nga partnerët
po ashtu edhe nga fëmijët e tyre.142-145

4.8. Familja gjatë regjimit komunist 146-147

4. 9. Ndikimi i emigracionit në ndryshimin e mentalitetit dhe pikëpamjeve për jetën
bashkëshortore..... 148-149

4.9.1. Numri i kërkesë-padive të bëra nga gratë është më i lartë se i burrave
.....149-154

4. 9. 2. Ndikimi i emigracionit në rritjen emancipimit të grave 154-161

4. 10. Ndikimi i ndryshimit të aspektit ligjor në rritjen e numrit të divorceve.....161-163

4. 11. Martesat dhe divorcet me partnere të huaja në emigracion 163-168

4. 12. Specifika të divorcit tek komunitetet romë dhe egjyptian.....168-169

KAPITULLI V: PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

5. 1. Përfundimet.....	170-183
5. 2. Rekomandime për studime të mëtejshme.....	183-184
Shtojcë: Intervista	185-191
Bibliografia	192

KAPITULLI I: HYRJA

1.1. Hyrje

Martesa është një proces i domosdoshëm dhe i rëndësishëm në jetën e njeriut. Falë saj qenia njerëzore trashëgohet, pra lë pasardhës. Nëpërmjet martesës kemi vazhdimësinë e jetës. Çdo njeri e ndërmerr një nismë të tillë me qëllim që të krijojë familje, të ketë fëmijë dhe më pas këtë gjë kërkon edhe për fëmijët e tij. Gjithëkush që martohet dëshiron të ketë një lidhje të qëndrueshme dhe të qetë me partnerin e tij me qëllim që edhe pasardhësit e tyre të ndihen mirë brenda kësaj familjeje. Fatkeqësisht jo gjithmonë ndodh kështu. Martesat jo gjithmonë e përmbushin qëllimin për të cilin janë realizuar. Në shumë raste ato shfaqin probleme të cilat bëjnë që marrëdhëniet ndërmjet partnerëve të kalojnë në krizë. Mirëkuptimi, toleranca nuk gjejnë vend në këto marrëdhënie. Ato zëvendësohen nga mosmarrëveshjet, konfliktet e vazhdueshme të cilat shoqërohen edhe me dhunë fizike e psikologjike. Pra, me pak fjalë, kështu martesës i ka ardhur fundi. Partnerët kujtojnë me nostalgji momentet e para të saj kur të dy ishin shumë të lumtur dhe asnjëherë nuk e kishin menduar se lidhja e tyre do të kishte një fund të tillë. Nga një martesë e bukur dhe e lumtur ajo tani nuk ka më asnjë nga këto cilësi, duke u bërë e padurueshme për të dy partnerët. Ata mundohen të gjejnë shkaqet se përse marrëdhënia e tyre është në këtë gjendje. Në një kthim mbrapa në kohë, ata tregojnë gjithçka kanë kaluar gjatë martesës së tyre duke sjellë me detaje të gjitha ngjarjet e rëndësishme të kësaj periudhe me të mirat dhe të këqijat e saj, momentet e bukura, të lumtura, të trishtuara të dhimbshme nëpër të cilat ka kaluar kjo martesë. Në fund të saj bashkëshortët

bëjnë një bilanc për të mirat dhe dëmet që ka sjellë ajo për secilin prej tyre si dhe kushtet që kanë krijuar një situatë të tillë që e ka çuar këtë martesë në divorc.

Ky studim ka në fokusin e tij divorcin si një problem social në rritje për shoqërinë shqiptare duke e parë këtë gjë në lidhje me emigracionin. Këtu do të trajtohet problemi i divorcit në qarkun e Elbasanit dhe kryesisht tek çiftet me partnerë në emigracion.

Ndryshimet politike në Shqipëri pas viteve 90-të u shoqëruan edhe me ndryshime ekonomike, sociale e kulturore. Shoqëria që deri në ato momente kishte qenë e izoluar dhe nuk mund të komunikonte me botën, me këto ndryshime iu dha mundësia për ta bërë një gjë të tillë. Me ndryshimin e sistemit dukuria e parë që të bie në sy është emigracioni për arsye politike, fillimisht si rezultat i pakënaqësisë ndaj sistemit, e më pas emigracioni ekonomik si rezultat i gjendjes së vështirë ekonomike në të cilë ndodhej vendi ynë. Faktorë shtytës për emigracionin në Shqipërinë e tranzicionit dhe të ekonomisë së tregut kanë shërbyer kriza ekonomike papunësia e lartë dhe varfëria. (Carletto et al., 2004 f.4)

Për shumë prej shqiptarëve, emigracioni u pa si mundësia e vetme për të siguruar të ardhura për familjet e tyre. Nga periudha e ndryshimeve e në vazhdim emigracioni ishte kaotik dhe ilegal, i pakontrolluar apo i organizuar nga institucionet shtetërore. Pastore (1992) i organizon këto momente kryesore të migracionit shqiptar të sotëm në katër faza:

(1) faza e migracionit – protestë (1990); (2) faza e migracionit të pakontrolluar (1991-1992); (3) faza e “migracionit të arsyeshëm” (1993-1996); dhe (4) faza e migracionit në fluturim (1997) (Carletto et al., 2004). Migracioni shqiptar gjatë kësaj kohe konsiderohet si “i

padukshëm” (IOM, 2006; Vullnetari 2007) sepse autoritetet shqiptare gjatë asaj kohe ishin më pak të përfshira në identifikimin dhe parandalimin e pasojave të kësaj vale migratore. Me pak fjalë, shqiptarët emigronin ilegalisht drejt vendeve të tjera pasi nuk kishte një organizim nga institucionet shtetërore.

Pikërisht për këtë gjë emigronin kryesisht burrat duke i lënë gratë dhe fëmijët në vend. Si pasojë e kësaj dukurie kemi ndryshime në jetën familjare dhe në strukturën e familjes. Nëse më parë (gjatë sistemit të kaluar) kishim një familje të konsoliduar me një jetesë të përbashkët, tani ajo ka ndryshuar. Bashkëshortët po jetojnë për një kohë relativisht të gjatë larg njëri-tjetrit. Kjo lidhet, së pari, me emigracionin por, në njëfarë mase, edhe me punësimet jashtë qendrave të banimit brenda vendit. (Beqja & Sokoli, 2000: 51) Njëri nga partnerët, kryesisht burri, jeton larg familjes si rezultat i emigracionit i cili lidhet drejtpërdrejt me pamundësinë për të gjetur një punë pranë qendrës së tij të banimit. Kjo gjë shoqërohet edhe me probleme sociale të cilat reflektohen tek marrëdhëniet brenda çiftit. Një tjetër formë e shfaqjes së “të qenit larg” është divorci emocional, apo martesë e vdekur brenda lidhjes martesore.

Të dhënat tregojnë se numri i familjeve me këtë “status” është 3-4 herë më i madh se numri i martesave të zgjidhura. (Beqja & Sokoli, 2000: 51) Për këto arsye martesë fillon të shfaqë probleme të cilat shtohen me kalimin e kohës derisa vjen një moment kur martesë e humb kuptimin e saj sepse partnerët janë bërë në një farë mënyre si të huaj për njëri tjetrin. Kjo gjë e çon martesën pashmangshmërisht në divorc. Divorcet në çiftet me partnerë larg janë më të shumtë krahasuar me ato që kanë jetë të përbashkët. Jetesa e ndarë e partnerëve krijon probleme në marrëdhëniet e tyre të cilat shtohen me kalimin e kohës. Sa më shumë e

gjatë të jetë koha e qëndrimit larg njëri-tjetrit të partnerëve aq më shumë thellohet hendeku në marrëdhëniet e tyre.

Si rezultat i rrethanave të krijuara nga kushtet ekonomike dhe social-kulturore në vend ka ndryshuar dhe mënyra e jetesës për çiftet, gjë e cila e vështirëson shumë ruajtjen e ekuilibrave në marrëdhëniet e partnerëve gjatë martesës. Këto ndryshime kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e numrit të divorceve në vend sidomos gjatë viteve të fundit.

1.2. Parashtrimi i problemit

Martesa në realitetin shqiptar përballlet me një sërë problemesh si pasojë e tranzicionit të zgjatur. Për arsye apo shkaqe të ndryshme, si faktorë socialë dhe ekonomikë, dallimet kulturore, arsimore, moshore ndërmjet partnerëve, ajo jo rrallëherë shkon drejt divorcit.

Divorci si zgjidhje ligjore e martesës është një problem social që shqetëson shoqërinë tonë. Numri i tij ka ardhur gjithnjë e në rritje sidomos gjatë viteve të fundit. Nëse do ti referohemi statistikave të INSTAT mbi divorcin do të vërejmë se të dhënat tregojnë shifra të larta të tyre sidomos në qarqet më të mëdha të vendit por jo vetëm. Kjo dukuri ka marrë një shtrirje të gjerë si në zonat e zhvilluara urbane po ashtu dhe në zonat rurale, edhe pse këtu numri është paksa më i kufizuar. Gjendja ekonomike, ndryshimet social-kulturore kanë pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në këtë dukuri. Këta janë faktorë përcaktues dhe shumë të rëndësishëm në rritjen e numrit të divorceve. Po ashtu një ndikim të madh ka edhe emigracioni ekonomik.

Por, përse emigrojnë shtetasit shqiptarë?

Ekonomia e prapambetur të cilën trashëguam nga regjimi i kaluar nxiti dukurinë e emigracionit ekonomik si mundësi për punësim në një vend tjetër. Emigracioni ekonomik ishte mundësia e vetme për shumë shqiptare që humbën vendet e punës dhe që nuk kishin mënyrë tjetër për të siguruar të ardhura për vete dhe për familjen e tyre. Kjo dukuri ka vazhduar gjatë gjithë këtyre viteve pasi ekonomia në vend nuk ka pasur ndonjë përmirësim të ndjeshëm.

Emigracioni është një dukuri mjaft komplekse në vetvete. Në të shfaqen dy anë, ajo pozitive dhe negative. Ana pozitive është së familjet me emigrantë falë punës së tyre kanë kushte më të mira jetese, banesa më të mira krahasuar me familjet e tjera që nuk kanë pasur mundësi emigrimi. Pra ekonomia e tyre është dukshëm më e mirë. Ana negative e kësaj dukurie lidhet me faktin e mosprezencës së njërit partner për periudha të gjata kohore. Jetesa larg njëri-tjetrit krijon probleme dhe vështirësi për secilin prej tyre të cilat mund të shmangeshin ose të kapërceheshin më lehtë nëse partnerët do të jetonin bashkë. Këto probleme sociale bëjnë që të ketë një ftohje të marrëdhënieve në çift dhe më pas divorc për një numër të konsiderueshëm të tyre.

Ashtu si në gjithë vendin, edhe në qarkun e Elbasanit divorci është problem mjaft shqetësues përse i përket numrit në rritje të tij. Shkalla e emigracionit në të është mjaft e lartë si pasojë e papunësisë dhe varfërisë. Këtë gjë e reflektojnë më së miri të dhënat e marra nga INSTAT. Treguesit e varfërisë për këtë qark janë: përqindja 11.3, hendeku 2.3, ashpërsia 0.7 (INSTAT, AMNJ, 2012). Rrjedhimisht si pasojë e varfërisë dhe emigracionit problemet sociale që kanë të bëjnë me familjen në këtë qark janë mjaft të mprehta. Kjo gjë pasqyrohet më së miri nga numri i lartë i divorceve të kryera në Gjykatën e rrethit Elbasan në vitet e

fundit. Gjatë periudhës kohore 2008-2014 pranë kësaj gjykate janë realizuar 3345 divorce. Mesatarisht janë realizuar 478 divorce në vit në këtë hapsirë kohore. Kjo shifër është relativisht e lartë, por këtu duhet përmendur se edhe numri i martesave vazhdon të jetë i lartë. Vlen për t'u theksuar fakti se kërkesat për divorc të bëra nga gratë kanë ardhur në rritje krahasuar me burrat. Gratë të cilat kanë jetuar për një kohë të gjatë vetëm, duke u përballur me problemet familjare, pa ndihmën e bashkëshortit, vendosin t'i japin fund martesës, duke iu drejtuar gjykatës. Emigracioni nuk është i lehtë si për burrat po ashtu edhe për gratë. Efektet negative të tij reflektohen tek të dy partnerët. Largimi i njërit bashkëshort ka sjellë pasoja të rënda sociale në familjet shqiptare si dhe ndryshime në marrëdhëniet në çift. Shumë burra, të cilët kanë qëndruar për një kohë të gjatë në emigracion, kanë krijuar lidhje të reja duke lënë mënjane familjen në Shqipëri.

Edhe shtypi i ditës nuk e lë pa trajtuar këtë problem duke sjellë shifra dhe fakte konkrete. Pothuajse të gjitha mediat, si ato të shkruara dhe ato visive, e kanë bërë prezent problemin e divorcit duke i kushtuar një rëndësi të veçantë numrit në rritje si dhe problemeve që e shkaktojnë atë.

Për vetë problematikën delikate që paraqet divorci është parë nga ana ime si një fushë e sociologjisë dhe antropologjisë e cila ia vlen të studiohet. Divorci është një problem delikat për faktin sepse nuk prek vetëm partnerët që bëjnë zgjidhje të martesës por edhe fëmijet e tyre. Pra, në fund të fundit, kemi të bëjmë me një shpërbërje të familjes dhe kjo nuk është një gjë e lehtë. Është e vështirë të krijosh dhe të mbash në këmbë një familje, por është e dhimbshme ta shkatërrosh atë kur në mes janë edhe fëmijët sepse pasojat e divorcit i vuajnë edhe ata.

Nisur nga kjo pikëpamje, studimi i problemit të divorcit dhe ndikimi që ka pasur emigracioni në rritjen e numrit të tij është parë nga ana ime si një lëmë me interes për t'u studiuar.

Studimi është kryer në qarkun e Elbasanit për disa arsye:

Së pari, para se të vendosja për të kryer studimin në qarkun e Elbasanit fillimisht bëra një vështrim të detajuar të gjendjes së përgjithshme në të gjithë qarqet e vendit përse i përket disa treguesve ekonomike por edhe socialë referuar statistikave zyrtare nga INSTAT, Ministria e Drejtësisë, etj.. Nga krahasimi i konstatimeve të gjetura ndërmjet qarqeve vihet re se tregues të tillë si papunësia, niveli i jetesës, remitancat, (kam studiuar remitancat pasi nuk ka statistika për numrin e saktë të emigrantëve) divorcet janë pothuajse në shifra të përafërta me luhatje të lehta nisur edhe nga popullsia që ka secili prej tyre. Situata ekonomike në qarkun Elbasan është pakashumë e njëjtë me qarqet e tjera, po kështu edhe remitancat të cilat në një farë mënyre na informojnë për shkallën e emigrimit të popullsisë. Të ngjashme paraqiten edhe rastet e zgjidhjeve martesore 2008-2014 të realizuara në gjykatat e qarqeve. Nisur nga këta tregues u pa e arsyeshme nga ana ime se duke kryer një studim mbi shkaqet e rritjes së numrit të divorceve në qarkun e Elbasanit i cili paraqitet i ngjashëm me qarqet e tjera të arrihet në përfundime përgjithësuese për të gjithë realitetin në Shqipëri përse i përket kësaj dukurie.

Së dyti, Elbasani është ndër qytetet kryesore që ka njohur një shkallë mjaft të lartë emigracioni, në krahasim me qytetet e tjera. Gjatë sistemit të kaluar, me hapjen e

ndërmarrjeve të industrisë metalurgjike, ky qytet pati rritjen me të madhe demografike si pasoje e punësimit të një numri mjaft të lartë punonjësish që erdhën nga qytete të tjera të vendit dhe u vendosën përfundimisht këtu. Për shkak të mbylljes masive të ndërmarrjeve të industrisë metalurgjike etj., me ndryshimin e sistemit, këta punonjës mbetën të papunë. Shumica e të papunëve panë emigracionin si mundësi e vetme për të siguruar të ardhura.

Së treti, ky qark është i përbërë nga 7 bashki dhe ka një popullsi prej 301397 në total. Përsa i përket ndarjes sipas zonave të banimit kemi një shpërndarje të tillë të popullsisë ku në zonat urbane jetojnë rreth 118,337 ndërsa në zonat rurale rreth 183,060. (INSTAT, 2015, Popullsia) Pjesa më e madhe e popullsisë së këtij qarku rreth 60.7 përqind jetojnë në zonat rurale. Ky qark renditet i treti në vend përsa i përket numrit të popullsisë pra ka një numër të lartë popullsie. Pra kjo gjë më favorizon për të studiuar mirë dukurinë.

Së katërti, unë jetoj në këtë qark, pra jam pjesë e tij dhe për këtë arsye kam qenë e interesuar prej shumë kohësh të studioj aspektin social-kulturor të tij. Këtë gjë kam dashur ta realizoj për të parë kompleksitetin e problemeve sociale që mbart kjo zonë por edhe për të kuptuar vlerat dhe aspektet e veçanta të saj. Divorci, si problem social, ka nxitur një farë kureshtje tek unë përsa i përket faktorëve që e shkaktojnë atë, por edhe pasojave me të cilat ai shoqërohet. Në këndvështrimin tim martesë dhe familja janë të shenjta pasi tek ato gjejmë dashuri, siguri, mbështetje dhe për këto arsye ato duhen ruajtur dhe mbrojtur nga çdo rrezik.

1.3. Rëndësia e studimit

Mendoj se ky studim ka rëndësi sepse do të paraqesë gjendjen aktuale të shoqërisë shqiptare përsa i përket dukurisë së divorcit, gjithashtu çfarë peshe specifike që ka pasur emigracioni, dhe hapja e shoqërisë në rritjen e divorcit. Nga studimet e deritanishme, për këtë dukuri në Shqipëri, nuk rezulton të kenë në fokusin e tyre emigracionin dhe hapjen e shoqërisë si faktorë përcaktues në rritjen e divorcit si dhe në krijimin e kulturës së divorcit si një element që tregon rritje në emancipim të shoqërisë sonë.

1- Gjatë studimit u fokusova për evidentimin e problemit në burime të ndryshme zyrtare, OJF, literaturë si dhe nga puna me pjesëmarrësit në studim. Me këtë studim dua të tregoj ndikimin e emigracionit në marrëdhëniet në çift si dhe ftohjen e këtyre marrëdhënieve, tradhëtinë bashkëshortore duke krijuar lidhje jashtë martesore, shfaqjen e veseve të këqia nga partnerët burra kryesisht, duke i çuar ato drejt divorcit. Nxorra në pah ballafaqimin e kulturës së emigrantit me kulturën e vendit ku ka emigruar përsa i përket divorcit, rritjen e shkallës së emancipimit të grave për të drejtat dhe liritë e tyre. Në studim u trajtua dhe ndryshimet në aspektin ligjor të divorcit. Jam përpjekur ta paraqes problemin në të gjithë diapazonën e tij. Këtu kam parasysh se si i kanë pasur marrëdhëniet çiftet para emigrimit dhe si kanë vazhduar pas tij. A ka qenë faktor thelbësor emigraconi në divorc? Ky problem u trajtua në mënyrë efikase nëpërmjet të dhënave dhe fakteve konkrete të mbledhura nga materialet e referuara.

2- Mbas kësaj pune të kryer gjatë këtij studimi bëhet i mundur pasqyrimi sa më i qartë dhe sa më konkret i realitetit shqiptar përsa i përket problemeve me të cilat përballen

çiftet shqiptare me partnerë në emigracion. Zbulimi i shkaqeve kryesore që shkaktojnë këto probleme, të cilat po i çojnë ato çdo ditë e më tepër drejt divorcit. Gjetja dhe paraqitja e këtyre shkaqeve ka pasur si qëllim të tregojë se sa e rëndësishme është të ndërmerren politika sociale dhe ekonomike për të minimizuar emigracionin ose për t'u krijuar emigrantëve mundësi të një emigrimi familjar.

3- Studimi është realizuar nëpërmjet qasjes metodologjike cilësore duke interpretuar të dhënat parësore dhe dytësore. Nëpërmjet këtij studimi janë ndërtuar themele për studime të tjera sasiore që mund të kenë një shtrirje më të gjerë duke përfshirë të gjithë territorin e vendit.

4- U fokusova në ndikimin negativ që ka pasur emigracioni në marrëdhëniet e çiftit dhe në veçanti emigracioni i njërit partner. Shfaqja e problemeve në këto marrëdhënie të paraqitura në studim, në një farë mënyre janë mesazh për institucionet shtetërore, politike dhe sociale, për të rritur mundësinë për punësim në vend, me qëllim që të ulët shkalla e emigracionit, dhe bashkë me të, edhe numri i divorceve të shkaktuara prej tij.

1.4. Qëllimi dhe objektivat e studimit

Divorci është një fenomen që po shqetëson çdo ditë shoqërinë shqiptare. Ky shqetësim vjen jo vetëm për faktin se ka ardhur në rritje, por edhe për faktin se ai ka kosto si

sociale dhe ekonomike (pasojat psikologjike të partnerëve por edhe të fëmijëve, kushtet ekonomike mbas divorcit etj).

Qëllimi i këtij studimi është:

Emigracioni dhe hapja e shoqërisë shqiptare drejt botës, kanë çuar në rritjen e numrit të divorceve.

Sa është e pranishme kultura e divorcit në realitetin shqiptar? Cilat janë pasojat sociale dhe ekonomike, me të cilat u shoqërua periudha e tranzicionit, në rritjen e numrit të divorceve në Shqipëri? Çfarë ndikimi ka në shoqëri ndryshimi i Kodit të Familjes dhe lehtësimi i procedurave të divorcit? A ka ndikuar kjo gjë në rritjen e numrit të divorceve në shoqërinë tonë?

Në këtë studim bëhet një vështrim i detajuar në aspektin sociologjik, të ndikimit që ka pasur hapja e shoqërisë, ballafaqimi i kulturës shqiptare me kulturat e vendeve të tjera ku kanë emigruar shqiptarët përsa i përket divorcit. Në këtë studim evidentohet ndikimin e këtyre kulturave të tjera, në rritjen e shkallës së emancipimit të grave për të drejtat e tyre në familje. Emancipimi i tyre ka sjellë si pasojë krijimin e kulturës së divorcit, në vendin tonë. Studimi është kryer në një lokalitet të caktuar siç është qarku i Elbasanit duke synuar shqyrtimin e impaktit të emigracionit dhe hapjes së shoqërisë në rritjen e numrit të divorceve në këtë mjedis shoqëror.

Objektivat kryesore që u shtruan në këtë studim:

Objektivi 1: Të evidentohet kategoria e çifteve që janë më të prirur për të bërë divorc.

Objektivi 2: Të trajtohen në mënyrë specifike çiftet që kanë pasur njërin apo të dy partnerët në emigracion për të parë problemet që ka shkaktuar ai në këto çifte.

Objektivi 3: Të evidentohen ndryshimet në mënyrën e jetesës në çift në Shqipëri me ndryshimin e sistemit politik.

Objektivi 4: Të evidentohet krijimi i kulturës së divorcit si rezultat i rritjes së shkallës së emancipimit të grave me ndryshimet politike, social-kulturore në Shqipëri, pra hapja e shoqërisë.

Objektivi 5: Të bëhen prezente vështirësitë me të cilat përballen partnerët por edhe fëmijët e tyre pas divorcit në aspektet ekonomike, sociale dhe psikologjike.

Objektivi 6: Të evidentohen ndryshimet në Kodin e Familjes mbi lehtësimin e procedurave të divorcit në Shqipëri.

Objektivi 7: Të evidentohet roli i shtetit dhe i institucioneve shtetërore në ndërmarrjen e politikave për rritjen e punësimit në vend më qëllim që të ulët shkalla e emigracionit në Shqipëri.

1.5. Pyetjet kërkimore

Për të hulumtuar rreth ndikimit të emigracionit në rritjen e numrit të divorceve në Shqipëri dhe në krijimin e një kulture të divorcit u ngritën disa pyetje kryesore kërkimore të cilat do të mund të orientojnë studimin drejt realizimit të tij. Këto pyetje kërkimore janë ngritur mbi baza teorike dhe empirike.

Së pari, unë mendoj se për të studiuar divorcin si dukuri shoqërore është mjaft e rëndësishme të përcaktohet kategoria e çifteve të cilat janë më të prirur për të bërë divorc ose që janë më të ekspozuar ndaj divorcit. Këtu kam parasysh prej sa vitesh ata kanë qënë të

martuar dhe si ka qënë historia e tyre martesore. Një gjë e tillë tregon se në cilën fazë të ecurisë së saj martesa është më e rrezikuar nga divorci. Një rëndësi të veçantë në studim i kushtohet edhe nivelit arsimor të partnerëve, nëse ata kanë të njëjtin nivel arsimor apo ka disnivel ndërmjet partnerëve për të kuptuar rolin që luan arsimi në marrëdhëniet e një çifti. Vëmendje i kushtohet edhe faktit nëse partnerët janë të punësuar apo të papunë. Punësimi, pavarësia ekonomike rrit mundësinë për divorc apo papunësia ka ndikim negative te martesa? Pjesë e studimit janë gjithashtu përkatësia fshat/qytet e të divorcuarve për të parë se cilët janë më të prirur për të bërë divorc. Pyetja kërkimore që lidhet me objektivin e parë është: (a) *Cilët çifte shkojnë në divorc?* (b) *Cila kategori është më e rrezikuar për të bërë divorc?*

Së dyti, është shumë e rëndësishme që për të studiuar ndikimin e emigracionit në rritjen e numrit të divorcit të evidentohen çiftet që kanë pasur njërin apo të dy partnerët në emigracion. Trajtimi në mënyrë më specifike i këtyre rasteve nxjerr në pah problemet që krijon divorci në marrëdhëniet në çift duke përfshirë këtu të jetuarit veç partnerit. Një tjetër formë e shfaqjes së “të qenit larg” është divorci emocional, apo martesa e vdekur brenda lidhjes martesore (Beqja & Sokoli, 2000, f. 51). Ndikimi që ka pasur kjo mënyrë jetese në jetëgjatësinë e martesës. Pyetja kërkimore që shtrohet për të realizuar objektivin e dytë është: *Sa prej këtyre çifteve kanë pasur njërin ose të dy partnerët në emigracion? Si ka ndikuar ky fakt në marrëdhëniet e tyre?*

Së treti, një vend të rëndësishëm në studim zënë edhe ndryshimet në sistemin politik. Ato kanë sjellë ndryshime në ligjin mbi martesën dhe divorcin. Lejimi i bashkëjetesës si një fazë e rëndësishme njohjeje para martesës. Ndryshimet politike janë shoqëruar dhe me ndryshime sociale. Në traditën e familjes shqiptare tipar themelor është jetesa e përbashkët e

çiftit. Sot ky tipar është cënuar aq sa të qëndruarit larg mund të vlerësohet si një alternativë “jotradicionale” e familjes dhe martesës. (Beqja & Sokoli, 2000: 51). Nuk kemi më një familje solide me jetesë të përbashkët por sot ajo na paraqitet në një formë të ndryshme nga ajo tradicionale si rezultat i kushteve dhe rethanave që janë krijuar nga ndryshimet politike, social-kulturore dhe ekonomike në vend. Pyetja kërkimore për objektivin e tretë është: *Çfarë impakti kanë pasur ndryshimet politike, social-kulturore në vend tek martesa dhe mënyra e jetesës në çift?*

Së katërti, emigracioni bëri që shumë shqiptarë të qëndrojnë në vende të ndryshme atje ku ata patën mundësi për punësim. Në këto vende ata u përballën me kulturën e tyre duke bërë një ballafaqim të kulturës sonë me kulturën e vendit pritës. Për shumë shqiptarë periudha emigratore ka qenë shumë e gjatë. Për një fakt të tillë por edhe arsye bashkëjetese dhe punësimi, procesi i integritetit në këto shoqëri ka qenë shumë i rëndësishëm. Si pjesë e integritetit ata u njohën më vlera dhe norma kulturore të vendeve respektive të cilat nuk i kishin parë në kulturën tonë. Kjo gjë vihet re tek rritja e shkallës së emancipimit të grave për të drejtat dhe liritë e tyre në familje si dhe krijimi i kulturës së divorcit si një element i cili i kishte munguar kulturës sonë. Në një shoqëri ku numri i divorceve ka qenë shumë i ulët nuk mund të pretendohet për ekzistencën e kulturës së divorcit. Divorci stigmatizohet (konsiderohet një turp) nga opinion, forca e të cilit ishte shumë e madhe (Beqja & Sokoli 2000, 43). Pyetja kërkimore që shtrohet për këtë objektiv është: *Si kanë ndikuar emigracioni dhe hapja e shoqërisë, ballafaqimi i kulturës shqiptare me kulturën e vendit ku kanë emigruar shqiptarët në emancipimin e grave dhe krijimin e kulturës së divorcit?*

*Së pesti, divorci është një moment i vështirë, si për partnerët që i japin fund martesës por edhe për fëmijët e tyre. Shkaqet që çojnë një çift drejt divorcit janë të shumta por pasojat edhe problemet me të cilat përballen partnerët dhe fëmijët e tyre nuk janë të pakta. Ato kanë të bëjnë me probleme psikologjike, sociale dhe ekonomike. Bërja prezente e problemeve dhe kapërcimi i tyre është një ndër objektivat e studimit. Fëmijët e vuajnë shumë divorcin e prindërve. Për shumë prej tyre ky proces është i dhimbshëm dhe reflektohet në gjendjen e tyre psikologjike. Periudha pas divorcit është shumë e rëndësishme përsa i përket përshtajtjes me gjendjen e re në të cilën ndodhen partnerët por edhe fëmijët e tyre. (Teoria e ndërveprimit simbolik). Pyetja kërkimore për këtë objektiv është: *A përshtaten lehtë me gjendjen pas divorcit secili nga partnerët si dhe fëmijët e tyre? Si ka ndikuar divorci në jetën e tyre në aspektin ekonomik, social dhe psikologjik?**

*Së gjashti, dukuria e divorcit ka marrë një shtrirje të gjerë dhe ne këtë e konstatojmë nga numri i lartë i zgjidhjeve martesore që kryhen çdo vit pranë gjykatave tona. Këtu duhet trajtuar edhe impakti që ka tek kjo dukuri në rritje ndryshimi i Kodit të Familjes dhe lehtësimi i procedurave të divorcit. Në këtë këndvështrim duhet parë se cilat janë ndikimet që kanë pasur këto ndryshime tek çiftet me probleme në marrëdhëniet bashkëshortore. Pyetja kërkimore që shtrohet për këtë objektiv është: *Çfarë ndikimi ka në shoqëri ndryshimi i Kodit të Familjes dhe lehtësimi i procedurave të divorcit? A ka ndikuar kjo gjë në rritjen e numrit të divorceve në shoqërinë tonë?**

Së shtati, emigracioni ekonomik si dukuri ka lindur për arsye të pamundësisë për të siguruar punë në vend. Mundësia për të gjetur një punë që siguron të ardhura të mira ka nxitur shumë shqiptarë për të emigruar drejt vendeve fqinje kryesisht por edhe drejt vendeve të

tjera. Kjo dukuri në vetvete shoqërohet edhe me problem sociale si për emigrantët por edhe për familjet që kanë lënë në Shqipëri. Nëse do t'u krijohej mundësi punësimi në vend shumica e tyre nuk do të emigronte. Roli i institucioneve shtetërore në ndërmarrjen e politikave për nxitjen e punësimit do të kishte një ndikim të drejtpërdrejtë në zvogëlimin e numrit të emigrantëve dhe rrjedhimisht edhe të problemeve që sjell emigracioni për ta dhe për familjet e tyre. Pyetja kërkimore që shtrohet këtu është: *Pse është e rëndësishme hapja e vendeve të reja të punës si dhe punësimi në vend i të papunëve? A do të ndikonte kjo gjë në uljen e shkallës së emigracionit drejt vendeve të tjera dhe rrjedhimisht edhe të problemeve sociale që shkakton ai?*

1. 6. Përkufizime të koncepteve kryesore

Divorci: Ndarje ligjore, emocionale, ekonomike, bashkëprindërore, shoqërore dhe psikologjike e dy bashkëshortëve. Secili nga bashkëshortët mund të kërkojë zgjidhje të martesës për shkak të grindjeve të vazhdueshme, keqtrajtimeve, fyerjeve të rënda, shkeljes së besnikërisë bashkëshortore, jetesa e përbashkët bëhet e pamundur dhe martesa ka humbur kuptimin e saj për bashkëshortin paditës ose të të dy bashkëshortëve (*Kodi i Familjes*, 2004, neni 132).

Marrëdhënie martesore: Marrëdhënia midis burrit dhe gruas në një martesë duke përfshirë këtu marrëdhënie seksuale të qëndrueshme.

Ftohje e marrëdhënieve bashkëshortore: Ndërmjet partnerëve në një çift nuk ka raport seksual, afeksion për partnerin, e trajtojnë njëri-tjetrin si të huaj, nuk kanë jetesë të përbashkët.

Kultura e divorcit. Kultura e divorcit krahasimisht është një set ose një grup besimesh dhe praktikash që e përcaktojnë martesën si një opsion i kushtëzuar me divorc duke e parë këtë të fundit si një alternativë nëse martesa nuk funksionon (K. Hackstaff, 1999). Kultura e divorcit shpreh barazi gjinore ndërmjet partnerëve në një çift. (Gender & Society, 2005, f. 645).

Emigrant ekonomik: Një person i cili e lë vendin e tij për të jetuar në një vend tjetër me punë më të mirë apo të kushteve të jetesës. “Emigrant ekonomik” është një person që largohet për t’u vendosur jashtë vendit të tij të origjinës me qëllim që të përmirësojë cilësinë e jetës. Ky term përdoret për t’iu referuar edhe personave që përpiqen të hyjnë në një vend pa leje (në mënyrë të paligjshme) dhe/ose duke përdorur procedurat e azilit në mirë apo keqbesim. Ky term përdoret për t’iu referuar edhe personave që largohen në periodha të caktuara për punësim sezonal (IOM, 2009, f. 17).

1.7. Kufizimet e studimit

Ky studim është mbështetur në përdorimin e instrumenteve të *metodologjisë cilësore*.

Së pari - Është përdorur kjo metodë me qëllim që të mblidhen të dhëna sa më të sakta, specifike rreth problemit të divorcit si dhe ndikimi që ka pasur emigracioni në këto divorce në qarkun e Elbasanit. Instrumentet e përdorur janë intervistat e drejtpërdrejta me partnerë që kanë bërë vetë kërkesën për divorc, grupet e fokusit me gra të divorcuara, të dhëna nga dosjet e divorcit të kryera pranë gjykatës Elbasan. Përdorimi i metodës cilësore bën që rezultatet të jenë më të kufizuara dhe ka vështirësi në përgjithësimin e gjetjeve.

Së dyti - Për realizimin e intervistave janë intervistuar 50 partnerë të cilët kanë bërë vetë kërkesën për divorc. Duke qenë se divorci është një çështje personale dhe shumë delikate ka qënë e vështirë për të gjetur persona të cilët ishin të gatshëm për t'u intervistuar. Krijimi i besueshmërisë tek të intervistuarit ishte një hap i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për vijueshmërinë e intervistës.

Së treti - Numri i burrave të intervistuar është i kufizuar. Kam hasur vështirësi në gjetjen e burrave bashkëpunues për kryerjen e intervistave si pjesë e studimit. Burrat janë më të ngurtë dhe të prerë në dhënien e përgjigjeve gjatë intervistës. Ka qenë e vështirë për të vjelë më tepër informacion përveç informacioneve të kërkuara nga intervista gjë e cila nuk ka ndodhur me gratë e intervistuar të cilat kanë qenë më të hapura dhe më bashkëpunuese. Gjatë intervistave të kryera me burrat është dashur shpesh herë ta ripërsëris pyetjen me fjalë të tjera për të marrë informacionin që më nevojitej për studimin.

Vështirësia e realizimit të intervistave me burrat vinte për shkak të çështjes delikate që do të trajtohej por edhe të mentalitetit. Ky problem u kapërcye duke kryer një bisedë paraprake rreth studimit, duke ju sqaruar më së miri konfidencialitetin dhe ruajtjen e anonimatit gjatë prezantimit të të dhënave. Pjesë e bisedës ishte edhe interesi i treguar nga ana ime lidhur me problemet që ai ka pasur dhe në një farë mënyre duke e mbështetur dhe pohuar se zgjidhja që ka bërë ka qënë më e arsyeshmja, në këtë rast divorci. Kjo gjë bëri që i intervistuari të rrisë besueshmërinë dhe shmangë stepjen për të qenë bashkëpunues në studim. Në momentin kur i intervistuari kishte krijuar besim dhe unë isha e bindur bashkëpunimin e tij fillonte zhvillimi i intervistës

1.8. Organizimi i studimit

Ky studim është i organizuar në pesë kapituj.

Kapitulli i parë (hyrës) është paraqitur prezantimi i problemit, rëndësia e studimit, qëllimi dhe objektivat e studimit, po këtu janë parashtruar pyetjet kërkimore, përkufizimi i koncepteve kryesore, kufizimet e studimit dhe organizimi i tij.

Kapitulli i dytë. Në këtë kapitull shqyrtohet literatura e shfrytëzuar për kryerjen e studimit. Materialet e shfrytëzuara janë të ndara në çështje sipas problematikës që trajtojnë. Në çështjen e parë trajtohet kufizimet e literaturës. Çështja e dytë trajton literaturën e huaj që ka të bëjë me divorcin dhe teoritë e divorcit si dhe faktorët që ndikojnë në rritjen e divorcit. Në çështjen e tretë trajtohet literatura që ka të bëjë me perspektivat kryesore në fushën e studimit të divorcit. Në çështjen e katërt dhe të pestë trajtohet literatura nga autorët më të shquar përsa i përket studimit të problemit të divorcit si dhe studime empirike të kryera në rajon e më gjerë. Në çështjet gjashtë dhe shtatë trajtohet literaturë shqiptare, autorët që kanë studiuar divorcin dhe shkaqet e rritjes së tij në Shqipëri. Në çështjen e tetë paraqiten të dhëna statistike mbi divorcin dhe martesat nga institucion shtetërore. Çështja e nëntë trajton literaturën që ka të bëjë me problemet e martesave sot në Shqipëri, ndërsa çështja e dhjetë trajton literaturën që ka të bëjë me ndikimin e emigracionit në jetën bashkëshortore dhe atë familjare. Ndërsa çështja e njëmbëdhjetë trajton ndikimin që kanë kushtet ekonomike në divorc, dhe çështja dymbëdhjetë trajton rolin e barazisë gjinore në martesë.

Kapitulli i tretë. Në këtë kapitull bëhen prezente metodologjia që është përdorur në këtë studim, kampioni i studimit, burimi i të dhënave të përdorura në studim, mënyra e realizimit të studimit hap pas hapi. Në këtë kapitull specifikohet se si u përpunuan dhe analizuan të dhënat që u përftuan gjatë kryerjes së studimit.

Kapitulli i katërt. Në këtë kapitull trajtohen dhe analizohen të dhënat e papërpunuara të mbledhura gjatë studimit të dosjeve të zgjidhjeve martesore që janë realizuar pranë Gjykatës së rrethit Elbasan për periudhën kohore 2008-2014. Gjatë analizimit të këtyre të dhënave janë evidentuar dhe nxjerrë në pah gjithë problemet me të cilat pëballlet familja shqiptare në ditët e sotme. Në këtë kapitull trajtohen gjetjet dhe rezultatet e studimit të kryer nëpërmjet intervistave duke i analizuar dhe diskutuar secilën prej tyre. Këtu trajtohet rritja e numrit të divorceve dhe ndikimi që ka pasur hapja e shoqërisë si dhe emigracioni në zhvillimin e kësaj dukurie. Gjithashtu, ky kapitull trajton faktorët që kanë mundësuar krijimin e kulturës së divorcit si një element i ri i në kulturën tonë i cili tregon për një rritje të shkallës së emancipimit të grave në shoqërinë shqiptare, numri i lartë i kërkesave për divorc nga gratë, problemet që shqetësojnë ato në krahasim me burrat. Shkaqet kryesore që e çojnë një çift drejt divorcit duke përfshirë këtu faktorët brenda marrëdhënies martesore dhe jashtë saj. Në këtë kapitull janë shqyrtuar edhe vështirësitë ekonomike me të cilat përballen partnerët pas divorcit. Roli i shtetit dhe organeve shtetërore në ndërmarrjen e politikave për të rritur punësimin.

Kapitulli i pestë.. Në këtë kapitull jepen konkluzione dhe rekomandime për studime të mëtejshme përsa i përket problematikave të shqyrtuara në këtë studim.

KAPITULLI II: SHQYRTIMI I LITERATURES

2. 1. Shfrytëzimi i literaturës së huaj. Kufizime në literature

Divorci si një problem i të gjitha shoqërive është trajtuar gjerësisht në dy pikëpamje:

Së pari si një ndër të drejtat themelore të njeriut sipas së cilës ashtu si çdo njeri ka të drejtë për tu martuar, po ashtu çdo i martuar ka të drejtë të bëjë divorc. Pra të divorcohen nëse nuk dëshiron të qëndrojnë më i martuar, apo nëse martesë paraqet probleme të pakapërcyeshme.

Së dyti dominanca e burrave në martesë ka rënë kohët e fundit dhe për këtë kanë ndikuar ndryshime të shumta sociale, kulturore, ekonomike. Kultura e divorcit në vetvete shpreh një rritje të barazisë gjinore ndërmjet partnerëve (K. Hackstaff, 1999, f. 2). Referuar shumë studimeve të kryera për shkaqet e rritjes së divorcit, rritja e shkallës së arsimimit dhe punësimit të grave përbëjnë shumicën e përfundimeve në të cilat kanë arritur këto studime.

Për divorcin janë bërë studime të shumta nga tre disiplina shkencore sociologjia, psikologjia dhe ekonomia. Studimet sociologjike janë fokusuar së tepërmi në shkaqet më të rëndësishme social-kulturore të cilat çojnë një martesë në ndarje. Studimet psikologjike janë fokusuar kryesisht në sjelljet e partnerëve gjatë martesës, pasojat psikologjike që shoqëron partnerët por edhe fëmijët e tyre, sidomos periudha pas divorcit. Studimet ekonomike kanë të bëjnë kryesisht me kushtet ekonomike dhe ndikimin që ato kanë në martesë por edhe si

shkaktare të divorcit, ndikimin që ka ekonomia e çiftit në mbarëvajtjen dhe jetëgjatësinë e martesës. Punësimi dhe papunësia apo kriza ekonomike kanë qenë çështje të trajtuar nga shumë studiues. Për të studiuar problemin e divorcit janë përdorur teori dhe perspektiva të shumta në varësi të kohës dhe situatave sociale në të cilën është trajtuar ky problem. Gjatë shfrytëzimit të kësaj literature nuk kam konstatuar ndonjë studim që të ketë në qendër ndikimin e emigracionit në rritjen e divorcit.

2.2. Përdorimi i katër teorive të mëdha sociologjike në interpretimin e divorcit

Ron J. Hammond në librin e tij “Sociologjia e Familjes” duke iu referuar (Levinger and Moles, "Divorce and Separation: Context, Causes, and Consequences" 1979,) Levinger dhe Moles, “Divorci dhe Ndarja: Konteksti, Shkaqet, dhe Pasojat” shprehet se “të katër teoritë e mëdha sociologjike mund të përdoren për të studiuar sjelljet individuale dhe kolektive”. Hammond shpjegon përdorimin e teorisë së konflikteve për të studiuar divorcin “...sepse nëpërmjet saj mund të kuptohet se si dhe pse gjërat bëhen armiqësore dhe nganjëherë divorcet e kontestuara bëhen të dhunshme” (Hammond, R. 2010, f. 39). Sipas tij “divorci mund të studiohet edhe nga teoria funksionaliste për të kuptuar se si divorci është një mjet për zgjidhjen e rrethanave sociale të paqëndrueshme për të vendosur balancë dhe ekuilibër” (f. 39). Divorci gjithashtu sipas Hammond (2010) mund të studiohet duke u përdorur për këtë gjë “...teorinë e ndërveprimit simbolik për të identifikuar se si njerëzit i përcaktojnë rolet e tyre para, gjatë dhe pas divorcit, si ata i rivendosin rolet e reja si beqarë” (f. 39). Hammond mendon se për studimin e divorcit mund të përdoret edhe teoria e shkëmbimit social. Kjo teori përdoret “... për të kuptuar proceset dhe zgjedhjet që çojnë në

vendimin përfundimtar për divorc, shpërndarjen e pasurisë, kujdestarinë e fëmijëve, dhe ndryshimin ligjor në status” (Hammond, R. 2010, f. 39).

“Livinge dhe Moles (1979) duke përdorur teorinë e shkëmbimit social kanë bërë një diskutim për zgjedhjen rracionale që bëjmë bashkëshortët për t’u divorcuar apo të qëndrojnë akoma të martuar. Modeli Livinge paraqitet si në formulë (Argëtim - Pengesë) +/- Alternativa Argëtimeve = Vendimin tim për të qëndruar i martuar apo të divorcohem. Argëtimet janë shpërblime që vijnë nga të qenit i martuar dhe përfshijnë statusin pozitiv shoqëror, akumulimin e pasurisë, prindërimi, marrëdhëniet seksuale, përkujdesje shëndetsore dhe zbutje të stresit që martesa sjell për secilin bashkëshort. Pengesat sipas Livinge janë kostot apo ndërkimimet që mund të ndodhin nëse një person i martuar zgjedh divorcin” (shih; Hammond, R. 2010, f. 165-166).

Hammond mendon se martesa nuk është diçka e bukur prej së cilës duhet pritur veç lumturi. Bashkëshortët sipas tij “duhet të përpiqen për të mbajtur stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e saj” (Hammond, R. 2010, f. 171). Ai mendon se çiftet duhet të kujdesen për të ruajtur martesën e tyre dhe duke e bërë një gjë të tillë do të kenë një martesë më të stabilizuar. “Çiftet që marrin në mbikqyrje martesën e tyre dhe që e kuptojnë se martesa nuk është lumturi dhe se ajo shpesh kërkon shumë punë, ndiejnë më shumë stabilitet dhe forcë” (f. 171) Hammond përdor konceptin “makinë e bukur” duke e krahasuar atë me martesën dhe ashtu sikurse “...makina e bukur do angazhime për të parandaluar dëmtimet sesa të prese për t’i riparuar ato” (Hammond, R. 2010, f. 171), të njëjtin përkushtim kërkon edhe martesa, sipas tij, për të ruajtur stabilitetin e saj.

Edhe pse shkëmbimi dhe kostot janë elementet bazë të konceptimit të sjelljes në martesë fokusi është në sjelljet ndërpersonale të shkëmbimit (Karney, B. Bradbury, Th. 1995, f. 8-34). Një sërë studiuesish kanë fokusuar kërkimin e tyre në këtë traditë duke u përqëndruar në diskutimet e sjelljeve e shkëmbimit gjatë zgjidhjes së problemeve dhe këtu mund të përmendim: Markman, (1981), Stuart, (1969), Wills, Weiss & Paterson, (1974),

“...dhe kanë qenë të udhëhequr nga premisa se shpërblimi ose sjellja pozitive rrit vlerësimin e përgjithshëm për martesën ndërsa ndëshkimi ose sjellja negative i bën dëm asaj” (shih; Karney, B. Bradbury, Th. 1995, f. 8-34). Ndërsa Brandbary & Fincham, (1991), (Gottman, 1990, 1993b) përdorin modelin bihevioral i cili sugjeron se reagimet njohëse ndikojnë tek martesa në sjelljet e mëvonshme. “Me kalimin e kohës akumulimi i përvojave të gjata para dhe pas ndërveprimit, gradualisht ndikojnë në gjykimin e bashkëshortëve për cilësinë e martesës” (Brandbary & Fincham, 1991; Gottman, 1990, 1993b). (shih; Karney, B. Bradbury, Th. 1995, f. 8-34) Teoria e shkëmbimit social është përdorur si perspektive edhe nga Thibout dhe Kelley (1959) në kërkimet mbi marrëdhëniet e ngushta martesore.

Një rol të rëndësishëm në trajtimin e kulturës së divorcit ka luajtur Karla B. Hackstaff. Në librin e saj “Martesa në një kulturë të divorcit” autorja thekson rëndësinë e kulturës së divorcit si një shprehje e barazisë gjinore. Kultura e divorcit u jep më tepër fuqi grave dhe sfidon traditën e dominancës së burrave. Autorja na jep përcaktimin e saj për kulturën e martesës dhe kulturën e divorcit. Kultura e martesës duhet kuptuar si një grup i besimeve, simboleve dhe praktikave, përshtatur me kushtet materiale që përforcojnë martesën dhe pengojnë divorcin (Hackstaff, K. 1999, f. 1). Por autorja nuk e sheh kulturën e martesës si element të veçantë. Sipas saj “kultura e martesës është e përbërë nga tri besime të cilat reflektojnë një qëndrim ndaj martesës dhe divorcit” (Hackstaff, K. 1999, f. 1). Sipas Hackstaff (1999) “martesa është një dhënie, martesa është e përjetshme, dhe divorci është një mjet i fundit” dhe këto përbëjnë ato që autorja i quan besime të kulturës së martesës. Hackstaff na jep gjithashtu edhe përcaktimin për kulturën e divorcit. Sipas saj “kultura e divorcit, përshtatur me kushtet materiale duhet kuptuar si një grup simbolesh, besimesh, dhe

praktikash të cilat parashikojnë dhe përforcojnë divorcin dhe në proces ripërcaktojnë martesën” (Hackstaff, K. 1999, f. 2). Ashtu si kultura e martesës edhe kultura e divorcit ka elementet e saj sipas autores. Kultura e divorcit përfshin tri besime kryesore: matresa është një alternativë, martesa është një pjesë, dhe divorci është një portë (Hackstaff, K. 1999, f. 2). Përveç kulturës së divorcit autorja trajton edhe çështjen e barazisë gjinore. Ashtu si kultura e divorcit, barazia gjinore sfidon status-quo-në në kuptimet martesore (Hackstaff, K. 1999, f. 2). Ajo na paraqet kontestimin që i bëhet ideologjisë së barazisë gjinore nga ideologjia ekzistuese e dominancës së burrave, në një martesë në këto pak dekadat e fundit. Autorja shprehet se “së bashku me divorcin rritja e barazisë ndryshon dinamikën e pushtetit në martesë” (f. 2). Sipas saj “edhe pse përpjekjet për të përfshirë barazinë gjinore në martesë nuk janë fort të reja, sfida e barazisë gjinore nuk ka qenë kaq e përhapur” Hackstaff, K. (1999, f. 2).

2.3. Perspektivat kryesore në fushën e studimit të divorcit.

Në studimet e hershme sociologjike por edhe të kohëve të fundit arsimimi dhe punësimi i grave, karriera e saj, marrja e një page më të larta krahasuar me ato të bashkëshortit, janë parë si një rrezik për divorc. Këtë perspektivë e kanë trajtuar studiues të tillë si Salvini & Vignoli, (2011), Vignoli & Ferro. (2009), Kalmijn, M. Loeve, A. Manting, (2007), Laloaara, M. (2003), Bernardi, F. Martinez-Pastor, J. (2011), Matthijs Kalmijn, M. Poortman, A. (2006), Chan dhe Halpin (2008). Një pjesë e madhe studiuesish janë fokusuar në studimin e faktorëve socio-kulturorë të cilët ndikojnë në rritjen e numrit të divorceve. Kjo perspektivë është ndjekur nga autorë të tillë si: Yodanis, C. (2005), Amato dhe Priveti, (2003), E. Bijwaard, G. Doeselaar, S. (2012), Vignoli & Ferro. (2009), Hiller, V. dhe

Recoules, M. (2009). Një grup tjetër studiuesish janë fokusuar në rëndësinë e bashkëjetesës si një fazë e domosdoshme për të njohjen e bashkëshortit të ardhshëm gjë e cila e bën martesën më të qëndrueshme. Studiues të rëndësishëm të kësaj perspektive janë: Kulu & Boyle (2010), Härkönen, J. 2013, Bernardi, F. Martinez-Pastor, J. (2011). Ndjekësit e perspektivës social-ekonomike si shkaktari kryesor i divorcit janë studiues të tillë si: Amato dhe Beattie (2011), Salvini & Vignoli, (2011), Lalovaara, M. (2003), Bernardi, F. Martinez-Pastor, J. (2011) etj..

2.4. Autorët më të shquar në studimet mbi divorcin.

Paul R. Amato ka dhënë një kontribut të veçantë në studimin e divorcit. Amato së bashku me disa autorë të tjerë kanë realizuar një sërë studimesh për të zbuluar shkaqet e divorcit. Ata janë fokusuar jo vetëm në faktorët socialë të cilat lidhen drejtpërdrejtë me marrëdhëniet e partnerëve, por edhe në ato ekonomike si papunësia dhe të ardhurat ekonomike të bashkëshortëve, kostot dhe përfitimet nga divorci etj.

Paul R. Amato, Denise Previti së bashku kanë kryer një studin për të kuptuar arsyet se përse ndodh divorci. Sipas tyre studimet e mëparshme kanë treguar se tradhëtia midis çifteve të martuara është parashikues i fortë i divorcit të mëvonshëm (shih: Amato & Rogers, 1997) Sipas autorëve tradhëtia luan një rol të rëndësishëm por ka edhe shkaqe të tjera po aq të rëndësishëm të cilët çojnë një martesë në divorc. Autorët bëjnë një studim më të thellë për të kërkuar më tepër se një shkak në zgjidhjet martesore. Ata arrijnë në gjetje të reja të rëndësishme gjatë studimit. Së bashku me tradhëtinë, ankesa për cilësinë e përgjithshme

martesore dhe marrëdhëniet kontradiktore, në rritje, mospërputhje të karakterit, dhe mungesa e komunikimit dominojnë në arsyet e shkurorëzimit të partnerëve (Amato, Previti, 2003, f. 622). Një problem mjaft shqetësues dhe që ndikon në divorcimin e çifteve është edhe përdorimi i substancave narkotike nga partneri. Sipas tyre “partnerët me fëmijë kishin më shumë gjasa të raportonin abuzimin me përdorimin e drogës si shkak të divorcit” (Amato, Previti, 2003, f. 622-623). Studiuesit mendojnë se këta partnerë e bëjnë një gjë të tillë për t’i mbajtur fëmijët larg prindit me probleme. Shihet e mundur që me t’u rritur fëmijët, bashkëshortët kryesisht gratë, të lënë bashkëshortët abuzivë të varur nga substancat narkotike për të mbrojtur fëmijët e tyre. (Amato, Previti, 2003, f. 622-623) Gjatë studimit të tyre ata kanë arritur në këto përfundime:

- 1- Shkaqet e divorcit të njerëzve janë të lidhura me gjininë, ekonominë sociale, dhe ndryshueshmëria e drejtimit të jetës në mënyrë të paparashikueshme.
- 2- Njerëzit të cilët fajësojnë veten e tyre, shkaqet e jashtme, ose ish-partnerët e tyre kanë tendencë të jenë më pak të rregulluar edhe pas divorcit sesa njerëzit të cilët fajësojnë faktorët e brendshme në marrëdhënie martesore.
- 3- Njerëzit të cilët besojnë se ata kishin kontrollin mbi procesin e divorcit (dmth, se ata iniciuan divorcin) kanë tendencë për të treguar përshtatje relativisht pozitive ndaj divorcit (Amato, Previti, 2003, f. 625).

Në artikullin “Does the unemployment rate affect the divorce rate? An analysis of state data 1960–2005”. Paul R. Amato, Brett Beattie. Social Science Research (2011) (A ndikon shkalla e papunësisë në normën e divorcit? Një analizë e të dhënave shtetërore 1960-2005), publikuar në vitin 2011 <http://www.elsevier.com> Autorët paraqesin tre perspektiva për të studiuar divorcin. Perspektiva e stresit psiko-social, perspektiva e kostos së divorcit, perspektiva hibride.

- 1- Perspektiva e stresit psiko-social supozon se papunësia dhe divorci janë të lidhur pozitivisht. Me sa duket stresi i lidhur me humbjen e vendeve të punës përfiton kohë për të shkatërruar një martesë deri në pikën e ndarjes (Amato, dhe Beattie 2011, f. 706).
- 2- Perspektiva e kostos së divorcit, në kontrast, supozon se papunësia dhe divorci janë të lidhura negativisht. Kjo perspektivë fokusohet në faktin se divorcet janë të

kushtueshme në lidhje me standardin e jetesës dhe akumulimin e pasurisë. Këto humbje përfshijnë shpenzimet gjyqësore, tarifat e avokatit, duke lëvizur në një qëndrim të ri për të paktën njërin dhe shpesh të dy bashkëshortëve, blerja e mobilje të reja, duke e ndarë pronën martesore, dhe humbjen e përgjithshëm ekonomike të lidhur me ndarjen e shtëpisë në dy pjesë. Gjatë një periudhe të papunësisë së lartë, bashkëshortët me probleme mund të jenë ngurues që të bëjë këto shpenzime, sepse (1) bashkëshortët mund të jenë të papunë, (2) bashkëshortët mund të kenë nevojë për të hyrë në forcën e punës me kohë të plotë, në një kohë kur vendet e punës janë të pakta, dhe (3) bashkëshortët e punësuar mund të jenë të shqetësuar për papunësinë në të ardhmen. Në të vërtetë, vlera e perceptuar e një burri apo gruaje me një punë të qëndrueshme mund të rritet gjatë periudhave të papunësisë së lartë, duke ulur dëshirën për divorc. Një humbje punë mund të gjenerojnë kufizimet ekonomike duke e bërë të vështirë aksesin në një divorc të kushtueshëm (Amato, dhe Beattie 2011, f. 706).

3- Perspektiva hibride paraqet ndërthurjen ndërmjet shkallës së papunësisë dhe shkallës së divorcit. Shkalla e papunësisë dhe shkalla e divorcit janë të lidhura negativisht kur të dy normat janë matur në të njëjtin vit dhe të lidhura pozitivisht kur shkalla e divorcit është matur në vitet e mëvonshme. Lidhja negativ ndërmjet papunësisë dhe divorci është bërë më e dobët në dekadat e të fundit. Amato, dhe Beattie (2011, f. 707)

2.5. Studime empirike mbi divorcin të kryera në rajon e më gjerë.

Ka teori të shumta lidhur me shkaktarët e divorcit në vende të ndryshme të Europës. Në secilin nga këto vende divorci paraqet një problematikë specifike e cila lidhet me temperamentin social dhe kulturor por dhe kushtet ekonomike të asaj shoqërie në të cilën është kryer studimi.

Nocioni i shkurorzimit ka të bëjë me prishjen e një marrëdhënieje intime afatgjatë. Para se të ndodhte ndarja fizike, kishte ndodhur ndarja sociale tek partnerët (Vanghan, (1986). Vanghan nuk e sheh divorcin si një ngjarje të momentit. Marrëdhënia e partnerëve kalon nëpër disa faza deri sa të vijë momenti i divorcit. Divorci është paraprirë (Vanghan, 1986) nga një ndarje sociale më parë ku bashkëshortët kanë krijuar shoqërinë e tyre të veçantë nga njëri-tjetri dhe më pas ka ardhur ndarja fizike. (shih; Giddens, A. 2007, f. 385)

Carries Yodanis në studimin e saj e trajton divorcin të lidhur si me aspektin shoqëror por edhe atë kulturor. Yodanis e sheh problemin e divorcit jo vetëm në nivelin mikro, por edhe në atë makro duke përfshirë kontekstin shoqëror dhe kulturor në marrëdhëniet brenda çiftit. Sipas autores divorci mund të shihet jo vetëm si një përvojë personale por si një pjesë e një ndryshimi dramatik, social, kulturor. Si i tillë, ndikimi i këtyre ndryshimeve nuk mund të jetë i kufizuar përreth atyre individëve dhe familjeve që drejtpërdrejt e përjetojnë divorcin (Yodanis, C. 2005, f.656). Përkundrazi, këto ndryshime ndikojnë tek të gjithë në një shoqëri, duke përfshirë edhe çiftet e martuara. (Yodanis, C. 2005, f.656) Ajo ka arritur në gjetjen se divorci nuk është një sjellje në nivelin mikro por është i lidhur me zhvendosjen e kulturave në nivelin makro. Nëse divorci nuk është një opsion i pranuar brenda një shoqërie, kërcënimi prej tij është i largët. (Yodanis, C. 2005, f.656) Në shoqëritë të cilat nuk kanë lehtësi në aspektin ligjor për të kryer divorc vihet re që numri i divorceve është i ulët. Nëse shoqëria është liberale ndaj divorcit atëherë dhe numri i divorceve është i lartë. Yodanis gjithashtu shton konfirmimin se “kërcënimet për divorc, si për burrat dhe për gratë, opsionet dhe alternativat e perceptuara brenda marrëdhënieve, janë të ndikuara nga konteksti shoqëror dhe kulturor” (Yodanis, C. 2005, f. 656). Perspektiva teorike për divorc kanë shkuar nga teoritë makro-sociologjike e rolit të divorcit në sistemin familjar ndaj perspektivave të nivelit mikro mbi proceset që çojnë në paqëndrueshmëri martesore (po aty, f.656). Ndryshimet në kontekstin social kulturor reflektohen gjithashtu edhe në marrëdhëniet ndërmjet partnerëve në martesë. Një kulturë e fortë divorci në nivel kombëtar është e lidhur më shumë, dhe jo më pak, me një shpërndarje të barabartë të punës në martesë (Yodanis, C. 2005, f.656). Autorja i kushton një vëmendje të veçantë rolit që luan ekzistenca e kulturës së divorcit në shoqëri, në rritjen e barazisë gjinore brenda një martese. Në vendet ku divorci është më i pranuar dhe

praktikuar gjerësisht, pozita e grave në kuadër të martesave është më e mirë. (f.656) Studiuesja thekson rolin që luan kultura e divorcit në rritjen e barazisë ndërmjet partnerëve në një martesë. Është e mundur që divorci ka më shumë gjasa që të pranohet dhe të jetë më i mundur në vendet që karakterizohen nga barazi më e madhe martesore. (Yodanis, C. 2005, f.657) Gjithashtu ajo pohon se “në një kulturë të fortë divorci pabarazia në martesë ndërmjet partnerëve është më e ulët” (Yodanis, C. 2005, f.657).

M. Kalmijn, A. Loeve, D. Manting, në një studim i kryer në Hollandë, përdorën qasjet tradicionale dhe ekonomike për të studiuar ndarjet martesore. Qasja tradicionale pohon se dominimi mashkullor stabilizon martesat (Kalmijn, M. Loeve, A. Manting, D. 2007, f.176). Kjo qasje nuk mund të ketë të njëjtin rezultat tek bashkëjetesa. Sipas studiuesve “... nuk mund të themi të njëjtën gjë për çiftet që bashkëjetojnë pasi dominanca mashkullore është në konflikt me barazinë gjinore dhe kjo ndikon në destabilizimin e saj (f.176).

Nëse tek martesa dominimi i burrit rrit qëndrueshmërinë e martesës dhe gratë në një farë mënyre janë të varura nga burrat sepse mund të jenë shtëpiake duke rritur fëmijët e tyre apo të papunësura, nuk mund të themi të njëjtën gjë për bashkëjetesën. Në bashkëjetesë në një farë mënyre lidhja është reciproke dhe këtu kemi më shumë pavarësi tek partnerët. Kjo gjë nuk lejon ekzistencën e dominancës së burrit në lidhje. Qasja ekonomike trajton një aspekt tjetër të marrëdhënieve në çift. Kjo qasje shqyrton ndikimin që kanë të ardhurat (paga) e larta e grave tek divorci. Punësimi i grave dhe marrja e një sasive të lartë të ardhurash, madje edhe më të larta se burrat, qoftë kjo nga puna apo fitimi nga investime të ndryshme të bëra prej tyre, rrit pavarësinë e tyre dhe në një farë mënyre destabilizon martesën. Sa më të larta

të jenë të ardhurat në familje të grave, aq më i lartë është rreziku i ndarjes. Dominimi i femrave është destabilizues. (Kalmijn, M. Loeve, A. Manting, D. 2007, f.176)

Kulu & Boyle kanë kryer një studimin me të dhëna nga Austria si një vend i cili ka një shkallë mesatare të divorcit krahasuar me normën e martesave sipas autorëve. Ata kanë parashtruar teorinë mbi ndikimin e bashkëjetesës në qëndrueshmërinë e martesës. Studiuesit vënë në dukje rolin që luan bashkëjetesa në njohjen më të thellë të partnerit. Ata, duke u fokusuar në çifte të cilët kanë bashkëjetuar duke e zgjedhur vetë bashkëjetesën si alternativë para se të martohen, e paraqesin këtë periudhë si një fazë të rëndësishme njohjeje ndërmjet partnerëve. Kjo fazë është quajtur prej tyre një “martesë provë”. Teoria e “martesës provë” thekson rëndësinë e bashkëjetesës paramartesorë në sigurimin e informacionit që lejon për një vlerësim më të saktë të cilësisë së martesës me bashkëshortin e ardhshëm (Kulu & Boyle 2010, f.895-896). Bashkëjetesa paramartesorë e zgjedhur nga vetë partnerët, zvogëlon riskun e ndarjes. Si pasojë, martesat që përfshijnë bashkëjetesën paraprakisht janë më të qëndrueshme se martesat e drejtpërdrejta (Kulu & Boyle, 2010, f. 895-896). Sipas autorëve numri i divorceve që vijnë nga çifte që kanë bashkëjetuar para së të martoheshin është shumë i ulët krahasuar me çiftet të cilët nuk kanë bashkëjetuar para se të martoheshin. Ata konkludojnë se bashkëjetesa ndikon në uljen e rrezikut për divorc për çiftet të cilët vendosin të martohen në të ardhmen.

Vignoli & Ferro kanë bërë një studim mbi risitë e ndarjeve martesore në Itali. Sipas autorëve në Itali vihet re një dukuri e ndryshme nga vendet e tjera të Europës përsa i përket ndarjeve martesore. Në Itali nuk kemi një divorc të menjëhershëm si pasojë e vështirësive ligjore dhe kostos së lartë të divorcit. Partnerët bëjnë një ndarje formale duke i shkëputur marrëdhëniet ndërmjet tyre. Një divorc është i nevojshëm vetëm nëse njëri nga partnerët dëshiron të martohet përsëri. Divorci mund të bëhet vetëm pas tre vite ndarje (Vignoli & Ferro. 2009, f. 27). Ndërlikimi i ligjit të divorcit ka bërë që numri i divorceve në Itali të jetë

relativisht i ulët krahasuar me vendet e tjera në Europë. Lehtësimi ligjor do të krijonte më tepër mundësi për divorc në martesat e padëshiruara. Për më tepër, statusi i punësimit të grave ka një ndikim shumë të fortë pozitiv në ndarjen martesore (Vignoli & Ferro. 2009, f. 27). Studiuesit duke ju referuar gjetjeve të studimit shohin punësimin e grave si një kërcënim për qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë e martesës. Rreziku i divorcit mes grave të punësuar (punonjëse të përkohshëm ose të përhershme), është pothuajse dy herë më i lartë se ato që nuk punojnë (Vignoli & Ferro. 2009, f. 27). Sipas autorëve kjo mund të interpretohet si një rezultat i rritjes së pavarësisë së tyre si pasojë e rritjes së pavarësisë ekonomike. Nga marrja e të ardhura ato kanë fituar pushtet, kjo gjë ul kufizim e një gruaje për të qëndruar në një martesë të padëshiruar (Vignoli & Ferro. 2009, f. 27). Pra pavarësia ekonomike e grave ndikon në rritjen e numrit të divorceve. Puna e grave mund të përfaqësojë një element destabilizues në rolet tradicionale të luajtura tek çiftet (f. 27). Kjo për faktin se humbet roli dominues i burrave në martesë kur gratë janë të punësuar dhe marrin më shumë të ardhura se burrat. Arsimimi mund të jetë i lidhur me perspektivat më të mira ekonomike, të cilat pastaj zvogëlojnë përfitimet relative të roleve tradicionale gjinore brenda martesës (Vignoli & Ferro. 2009, f. 27). Sipas studiesve ka edhe një funksion tjetër "...do të ndihmojë gratë të fitojnë pavarësi ekonomike, duke u ofruar mundësi më të mira punësimi" (f. 27).

Salvini & Vignoli, kanë kryer një studim lidhur me ndarjet martesore në Itali gjatë kohës së ndryshimeve sociale. Në studimin e kryer autorët kanë arritur në gjetjet se me uljen e kostove social-ekonomike të ndarjeve kemi rritjen e numrit të këtyre ndarjeve. Mund të thuhet se arsimi i lartë mund të çojë në një marrëdhënie më të qëndrueshme për shkak të përputhjes së suksesshme të partnerëve (Salvini & Vignoli, 2011, f.164). Sipas studiuesve

arsimi i lartë mund të ndikojë “...në përmirësimin e aftësive të komunikimit që e bëjnë një marrëdhënie të funksionojë mirë (f.164). Arsimi u jep më tepër siguri dhe pavarësi grave dhe kjo vihet re tek përhapja masive e ndarjes martesore në këtë kategori. Gratë me arsim të lartë janë pionieret e përhapjes së ndarjes martesore në Itali (f.164). Gratë e mirëarsimuara janë më të prirura për të pranuar format e reja të sjelljes, pasi ata janë në gjendje për të përballuar si shpenzimet ligjore dhe socio-ekonomike të një ndarje (Salvini & Vignoli, 2011, f.164). Rezultatet e studimit të kryer nga Salvini dhe Vignoli janë në një linjë me argumentin se shkalla e autonomisë ekonomike luan një rol të fuqishëm në mundësitë efektive të një ndarje martesore nga gratë. Gratë me arsim të ulët kanë ndjekur shembullin e grave me arsim të lartë në demokratizimin e procesit të ndarjes martesore në shoqërinë italiane (Salvini & Vignoli, 2011, f. 164). (Po aty) Vendimi i tyre për t’u ndarë është lehtësuar sepse mjedisi kulturor dhe tradicional padyshim është shkelur nga homologet e tyre më të mirëarsimuara. Ndarjet martesore tek burrat nuk paraqesin ndonjë ndryshim me kalimin e kohës se nuk ka ndonjë ndryshim në shkallën e arsimimit të tyre pasi ajo ka qëndruar pak a shumë e pandryshueshme (Salvini & Vignoli, 2011, f. 164).

B. Jalovaara bazuar në të dhëna nga martesat dhe divorvet e kryera në Finlandë në një periudhë të caktuar ka kryer një studim për të parë efektet e përbashkëta socio-ekonomike të bashkëshortëve në rrezikun për divorc. Studiuesja ka konstatuar se “...ka më tepër stabilitet në martesë tek çiftet të cilët parterët kanë të njëjtin nivel arsimor” (Jalovaara, M. 2003, f.77). Ndërsa tek çiftet ku bashkëshortët kanë nivele të ndryshme arsimi rreziku për divorc është i pavarur nga fakti se cili partner është i arsimuar. Partnerët me nivel të ndryshëm arsimor kanë divergjenca në qëndrime dhe vlera. Sa për aktivitetin ekonomik, rreziku i divorcit ishte më i

ulët për çiftet në të cilat burrat ishin të punësuar dhe gratë ishin shtëpiake, edhe pse përbërja familjare ishte e konsiderueshme (Jalovaara, M. 2003, f.77). Studiuesja trajton ndikimin që ka roli gjinor në qëndrueshmërinë e martesës. Specifikimi i rolit gjinor brenda çiftit mund të rrisë jetëgjatësinë e martesës duke forcuar barrierat ndaj divorcit dhe rrit kënaqësinë martesore (Jalovaara, M. 2003, f.77). (Po aty) Në çiftet ku të dy partnerët janë të punësuar rreziku i divorcit nuk është shumë më i lartë krahasuar me çiftet ku gruaja është shtëpiake dhe bashkëshorti është i punësuar. Ky konstatim mund të vijë për faktin se marrëdhënia dhe mirëkuptimi bazohen në ndarjen e përbashkët të eksperiencave të përditshme sipas studiuses, si dhe të ardhurat e larta të cilat ndihmojnë në forcimin e martesës. Rreziku më i lartë për divorc gjendet tek çiftet që kanë gratë, burrat ose të dy bashkëshortët të papunë madje kur arsimi dhe të ardhurat e bashkëshortëve janë të konsiderueshme (Jalovaara, M. 2003, f.77). Autorja arrin në përfundimin se si për burrat po ashtu edhe për gratë veçorite socio-ekonomike kanë ndikim të rëndësishëm në stabilitetin e martesës. Burimet e larta ekonomike pavarësisht nga cili bashkëshort janë siguruar, janë shoqëruar me stabilitet të lartë martesor (Jalovaara, M. 2003, f.77). Studiuesja nxjerr në pah edhe një fakt tjetër. Sipas saj “...megjithatë gratë më të ardhura më të larta kishin rrezik më të lartë për të bërë divorc krahasuar me gratë shtëpiake të cilat janë të pakta në numër (Jalovaara, M. 2003, f.78). Niveli më i lartë i të ardhurave të grave rrisin rrezikun për divorc nëse të ardhurat e burrit janë të ulëta.

E. Bijwaard, G. Doeselaar, kanë kryer një studim mbi ndikimin që ka divorci tek emigrantët familjarë në Hollandë, pas ndryshimit të statusit ata zgjedhin qëndrimin e tyre në emigracion apo largimin drejt vendit të origjinës. Autorët vlerësojnë se numri i

emigrantëve familjarë vjen i dyti pas emigrantëve të punës. Emigrantët e familjes kanë si motiv kryesor të emigrimit të tyre dëshirën për të jetuar së bashku me bashkëshortin. Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme e këtyre martesave përfundojnë në divorc, ashtu si me të gjitha martesat e tjera në botën perëndimore (Bijwaard, G. Doeselaar, S. 2012, f. 18). Nëse marrëdhënia bashkëshortore e emigrantëve familjarë prishet njëri ose të dy partnerët ka gjasa të rikthehen pranë vendit të origjinës. Nëse martesa merrte fund ata nuk kishin më arsye se përse të qëndronin në emigracion. Divorci ndikon në shkurtimin e kohëzgjatjes së migrimit për emigrantët nga vendet më pak të zhvilluara (Bijwaard, G. Doeselaar, S. 2012, f. 18). Studiuesit kanë konstatuar gjatë studimit të tyre se emigrantët nga vendet e zhvilluara janë më pak të prirur për t'u larguar nga vendi ku kanë emigruar pas divorcit. Emigrantët nga vendet më të zhvilluara kanë një shans më të lartë për t'u integruar në shoqërinë holandeze dhe (gratë) për këtë arsye janë më të pavarura pas divorcit (E. Bijwaard, G. Doeselaar, S. 2012, f. 19).

Victor Hiller dhe Magali Recoules në studimin e tyre me titull: "Divorce decisions, divorce laws and social norms"; (2009) (Vendimet e divorcit, ligjet e divorcit dhe normat shoqërore)

publikuar në këtë adresë <http://www.parisschoolofeconomics.eu/IMG/pdf/Magali.pdf> , pohojnë se rritja e shkallës së divorcit është nxitur nga ndryshimet në përbërjen e popullsisë. Këtu studiuesit kanë parasysh individët që respektojnë normat shoqërore dhe ata që i shpërfillin ato. Më konkretisht, një rritje në përqindjen e individëve të cilët e shpërfillin turpin nga normat shoqërore bën që të rritet shkalla e divorcit (Hiller, V. dhe Recoules, M. 2009, f.19). Rezultatet tona tregojnë se një ndryshim i përkohshëm në ligjin e divorcit përshejton

rritjen e shkallës së divorcit, por nuk është forca lëvizëse prapa kësaj dinamike (po aty, f.19). Shpërfillja e turpit ndaj normave shoqërore nuk është nxitësi i vetëm i divorcit pasi “...dinamika e preferencave është endogjene dhe mund të ndikohet nga faktorë ekonomikë” (f. 19). Të dhënat empirike të konstatuara nga studiuesit gjatë studimit kanë treguar se stigmatizimi ndaj divorcit zhvillohet pjesërisht me normën e divorcit. Të qenit i divorcuar (Hiller, V. dhe Recoules, M. 2009, f.19) nuk përbën më një turp dhe kjo sigurisht që ndikon në rritjen e shkallës së divorcit.

Juho Härkönen në artikullin me titull “Divorce: Trends, Patterns, Causes, Consequences” (2013) (Divorci: Tendencat, Modelet, Shkaqet, Pasojat), publikuar në http://www.su.se/polopoly_fs/1.133184.1366922030!/menu/standard/file/WP_2013_3.pdf. Në këtë artikull studiuesi paraqet zhvillimet e reja të jetës në çift. Divorci është bërë një pjesë e institucionit të familjes dhe një mundësi reale të cilat bashkëshortët duhet të marrin në konsideratë kur martohen (Härkönen, J. 2013, f. 23). Megjithëse stigmatizon më pak se më parë divorci ende mund të shkaktojë vuajtje të mëdha dhe përçarje tek të rriturit dhe fëmijët që e përjetojnë atë (Härkönen, J. 2013, f. 23). Po sipas studiuesit “...ka paqartësi të konsiderueshme në përpjekjet për të parashikuar normat e ardhshme të divorcit dhe paqëndrueshmërinë në marrëdhëniet e çiftit” (Härkönen, J. 2013, f. 23). Në këtë paqartësi ndikon edhe rritja e numrit të çifteve që bashkëjetojnë. Rritja e numrit të bashkëjetësive përbën një tjetër sfidë, sesi ligjet e divorcit janë bërë një tregues gjithnjë e më të dobët për paqëndrueshmërinë e marrëdhënieve të çiftit (Härkönen, J. 2013, f. 23). Studiuesi është pesimist për stabilitetin e familjes në të ardhmen. Megjithë ndryshimet në ligjin për divorcin apo përpjekjet për të rritur barazinë gjinore që edhe gratë të ndihen të barabarta me burrat

sërisht familja nuk do të arrijë të ketë stabilitetin që ka pasur disa dekada më parë (Härkönen, J. 2013, f. 23).

Bernardi dhe Martinez-Pastor kanë kryer një studim për të parë se si kanë ndryshuar faktorët e rrezikut të divorcit me kalimin e kohës në Spanjë. Studimi i tyre është fokusuar tek martesat e kryera para vitit 1981 dhe martesat e kryera pas vitit 1981. Këta studiues kanë konstatuar se ndikimi i burimeve socio-ekonomike ka rënë së fundmi në grupin e martesave. Por gjatë studimit ata vërejnë se ndikimet e të pasurit fëmijë, ndikimet e attributeve jotradicionale të lidhjeve martesore, eksperiencat e mëparshme familjare kanë pasur shumë rëndësi. Në gratë e martuara para viteve 1981 të qenit me arsim të lartë dhe aktive në tregun e punës kanë qenë faktorët kryesorë që lidhen me rrezikun e divorcit (Bernardi, F. Martinez-Pastor, J. 2011, f. 789). Por studiuesit nuk konstatojnë të njëjtën gjë në mesin e grave të martuara pas vitit 1981.

Së pari sipas tyre “...niveli arsimor u bë i parëndësishëm, dhe efekti i të qenit i papunë ose të punësuar, kundrejt të qenit joaktiv, është rrudhur; edhe pse në rastin e të punësuarave, ulja nuk ishte statistikisht e rëndësishme” (Bernardi, F. Martinez-Pastor, J. 2011, f. 789). Studiuesit kanë arritur në gjetjet se “...lidhja e arsimit të lartë dhe rriskut të divorcit ishin pozitive dhe të forta në grupet e martesave të vjetra por ishin të vakëta në grupet e reja (Bernardi, F. Martinez-Pastor, J. 2011, f. 790).

Së dyti tiparet jotradicionale (bashkëjetesa) duket se kanë më tepër rëndësi tani sesa kishin në të kaluarën (po aty, f. 790). Studiuesit arrijnë në konkluzionin se “...edhe pse shumica e këtyre tipareve janë më të zakonshme sot sesa ishin në të kaluarën, ato janë ende

larg nga të qenit të përhapura në popullatën spanjolle” (Bernardi, F. Martinez-Pastor, J. 2011, f. 790).

Kalmijn dhe Poortman në një studim të kryer mbi divorcin kanë arritur në gjetjet se efekti i punësimit të gruas është më i fortë në iniciativën e grave për divorc se në nismën e meshkujve për të bërë të njëjën gjë. Punësimi mund t’i bëjë gratë më të pavarura (Kalmijn, M. Poortman, A. 2006, f. 212). Gratë e punësuar ndihen më të pavarura nga burrat e tyre. Punësimi u jep grave një ndjenjë të vetë-respektit, e cila e rrit ndjenjën e aftësisë që të vendosë ekzistencën e saj në vendin e vet (Kalmijn, M. Poortman, A. 2006, f. 212). Në kuptimin që, punësimi nuk mund të ndryshojë koston aktuale të divorcit, por ai mund të ndryshojë kostot e perceptuara të divorcit në mënyrë substanciale (Kalmijn, M. Poortman, A. 2006, f. 212). Problemet financiare kanë ndikim më të fortë për divorc tek gratë se tek burrat ose tek një divorc i përbashkët. Duke qenë se burrat kontibudojnë më shumë financiarisht në martesë, gratë i fajësojnë ata për problemet financiare që vijnë nga borxhe serioze apo nga varësia ndaj bixhozit (Kalmijn, M. Poortman, A. 2006, f. 212).

Tak Wing Chan dhe Brendan Halpin, në artikullin me titull “The Instability of Divorce Risk Factors in the UK” (Paqëndrueshmëria e faktorëve të rrezikut të divorcit në Britaninë e Madhe), publikuar në <http://users.ox.ac.uk/~sfos0006/papers/change8.pdf>, gjatë studimit në retrospektivë të të dhënave studiuesit kanë vërejtur se faktorët e riskut të divorcit në Britani kanë ndryshuar me kalimin e kohës. Sipas autorëve këto ndryshime janë të konsiderueshme, pra janë të mëdha, sistematike, sepse kanë ndryshuar vazhdimisht, dhe të

interpretueshme. Është rritur shkalla e bashkëjetesës dhe është dobësuar vlerësimi për martesën dhe divorcin (Chan dhe Halpin, 2008, f. 15). Sipas studiuesve ka ndryshuar gjithashtu edhe ndikimi i faktorit “arsim i lartë” tek divorci duke e ulur rrezikun për divorc gjatë kohëve të fundit krahasuar me kohët më të hershme. Në mesin e grave të martuara në vitin 1960 më të arsimuarat u përballën me rreziqe më të larta për divorc (Chan dhe Halpin, 2008, f. 15). Me kalimin e kohës ndikimi i arsimit jo vetëm që është zhdukur, por ka qënë i kundërt për ato që u martuan në vitin 1980 (f.15). Studiuesit kanë konstatuar se të diplomuarit në universitet kishin më pak gjasa për t’u divorcuar se gratë e paarsimuara. Të njëjtin impakt të divorci ka dhe pasja e fëmijëve nga martesa. Sipas autorëve “...fëmijët janë investim i madh në një martesë dhe faktori fëmijë është stabilizues për martesën (Chan dhe Halpin, 2008, f.15-16). Fëmijët e bëjnë martesën më të qëndrueshme. Çiftet me fëmijë janë më pak të rrezikuara nga divorci, dhe çiftet që mendojnë se mund të divorcoven nuk lindin fëmijë (Chan dhe Halpin, 2008, f.15-16).

2. 6. Shfrytëzimi i literaturës shqiptare

Gjatë shqyrtimit të literaturës shqiptare kam konstatuar pak studime që kanë në fokusin e vet divorcin. Një studim sociologjiko-psikologjik mbi divorcin është kryer nga Hamit Beqja dhe Lekë Sokoli me titull: “Divorci: Vrojtime dhe refleksione”. Ka një sërë autorësh të tjerë shqiptarë që kanë trajtuar problemin e divorcit, shkaqet dhe pasojat sociale e psikologjike të tij.

2. 7. Shkaqet e rritjes së divorcit në Shqipëri

Beqja dhe Sokoli në studimin e tyre kanë pasur si qëllim të japin shkaqet e divorcit dhe pasojat vetjake e sociale të tij. Ky studim është vendosur në sfondin e ndryshimeve të thella që kanë ndodhur në Shqipëri gjatë tranzicionit demokratik (Beqja & Sokoli, 2000, f. 43). Autorët pohojnë se ritmet më të larta të divorcit vërtetohen në fillim të kësaj periudhe 91-92 që përkon dhe me periudhën e ndryshimeve politike që pësoi shoqëria jonë. Pikërisht këto vite u zgjidhën shumë martesë të konsumuara prej kohësh por të padivorcuara për shkak të pasojave që mund të sillnin për individin” (Beqja & Sokoli, 2000, f.46).

Shkaqet e divorcit autorët i shohin të lidhura me paqëndrueshmërinë e popullsisë. Sipas autorëve sa më e paqëndrueshme të jetë një popullsi e dhënë, aq më tepër shtohen premisat e rritjes së ritmeve të divorcit midis individëve përbërës të saj. Ndërsa në një popullsi që ndryshon sa më e rregulluar të jetë lëvizja, aq më pak divorce mund të ketë (Beqja & Sokoli, 2000, f. 58). Ndër shkaqet më kryesore të divorcit sipas autorëve janë pabesia bashkëshortore. Në Shqipërinë e sotme pabesia bashkëshortore është një nga shkaqet që çon gjithnjë e më shumë në divorc. Të paktën 1 një 4 martesë është zgjidhur për këtë shkak (Beqja & Sokoli, 2000, f. 72). Sipas autorëve tradhëtia bashkëshortore e kryer nga gratë është e patolerueshme nga bashkëshortët e tyre, ndërsa gruaja është më tolerante dhe është më e prirur për të falur tradhëtinë e kryer nga bashkëshorti i saj. Të dhënat tregojnë se pabesia bashkëshortore e gruas ka më shumë peshë në divorc. Në më të shumtën e rasteve iniciatori i zgjidhjes së martesës për këtë shkak është burri (Beqja & Sokoli, 2000, f. 72). Në këtë studim autorët paraqesin gjithashtu shkaqet e numrit të ulët të divorcit gjatë sistemit komunist

të cilat lidhen me stigmatizimit që i bëhej atij nga forca e opinionit e cila kishte një ndikim shumë të fortë në jetën dhe marrëdhëniet bashkëshortore.

Gëzim Tushi në librin “Martesa Familja Seksualiteti” trajton problemet martesore dhe arsyet e rritjes së divorcit. Nga ana tjetër autori i lidh problemet e divorcit me defektet që shfaqen në jetën bashkëshortore. Po sipas tij në përgjithësi divorci prek ato martesa që nuk funksionojnë, që brehen nga grindja, xhelozia, konfliktualiteti, situata e vështirë ekonomike, tradhëtia bashkëshortore. (Tushi, G. 2012, f.77) Autori arsyeton mbi atë se çfarë nënkupton rritja e shkallës së divorcit kohët e fundit në Shqipëri. Ai shprehet se divorci është një rritje e madhe e modernitetit në shoqërinë tonë. Në rritjen e numrit të divorceve autori vëren se “...rritja e rolit të femrës shqiptare në martesë, forcimi i të drejtave dhe shfaqja më publike e personalitetit të saj në raport me burrin patriarkal, nënshtrues apo të dhunshëm” (Tushi, G. 2012, f.77). Gjithashtu kjo sipas autorit është një arritje që nuk mund të mohohet për nga vlera sociale dhe rëndësia individuale (Tushi, G. 2012, f. 90). Por nga ana tjetër autori paraqet edhe anët negative të divorcit dhe pasojat sociale me të cilat shoqërohet ai. Sipas tij divorci është akti më shkatërrues i familjes nga i cili askush nuk del i fituar. Por ata që e pësojnë më shumë, që përjetojnë ankth pasiguri, mungesë orjentimi etj. janë fëmijët (Tushi, G. 2012, f. 100). Autori gjithashtu shprehet se periudha post divorc është një periudhë e re në jetën e gruas së divorcuar e cila në mënyrë sovrane, përpiqet të gjejë rrugën e duhur, atë tipologji, mënyrë të jetuari që i shkon përshtat, që i pëlqen dhe që natyrisht është utilitare dhe me vlerë personale.

Ndërsa në librin “Probleme dhe dilema sociale” Gëzim Tushi shprehet se padyshim divorci është një nga treguesit e lirisë së shoqërisë moderne e cila ka krijuar hapësirë sociale

që lidhja dhe zgjidhja e martesës të jetë një e drejtë ekskluzive e njeriut. (f. 79) Autori arsyeton lidhur me pasojat sociale dhe psikologjike të divorcit. Pavarësisht se divorci është një shprehje e lirisë po sipas autorit ai është një akt civil vërtet i dhimbshëm dhe me pasoja individuale për çiftin e ndarë. Pasojat sociale të divorcit nuk përjetojnë vetëm nga bashkëshortët por këto pasoja i përjeton familja e prishur në tërësi dhe anëtarët e saj veç e veç. Pasojat e divorci sipas Tushit (2006) zbuten po qe se ai perceptohet si një akt që është pjesë e relacionit human midis dy njerëzve që vërtet ndahen midis tyre për shkaqe personale por që nuk janë krejt të huaj dhe aq më tepër armiq me njëri-tjetrin. Pra sa më pak armiqsorë të jenë partnerët me njëri-tjetrin, aq më lehtë e kalon familja këtë akt ndarje të anëtarëve të saj. Divorci sa i dëmshëm është në të njëjtën kohë edhe vlerë e modernitetit, shprehje e lirisë sociale nga koncepti i vjetër i familjes si entitet përfundimisht i mbyllur dhe relacion i determinuar (Tushi, G. 2006, f. 81). Pavarësisht nga pasojat me të cilat shoqërohet sipas Tushit (2006), divorci është një nga të drejtat humane që duhet respektuar si akt dhe sjellje me natyrë të dyfishtë individuale dhe sociale. Divorci duhet humanizuar duke e zhveshur nga ambalazhet dhe standartet e paragjyqimeve të moralit të së kaluarës që e konsideronte e trajtonte si tragjedi për ta bërë sa më të pranueshëm. Por nga ana tjetër duhet të krijojmë vlera të reja të trajtimit të divorcit si një fatkeqësi individuale e kalueshme dhe e rikuperueshme, kur atë e trajton nga parime humane të shoqërisë moderne (Tushi, G. 2006, f. 81).

H. Podrovica e sheh divorcin jo vetëm si një e drejtë por dhe si një institucion martesor. Mund të thuhet se (Podrovica, H. 2011, f.116) zgjidhja e martesës është institucioni më i lartë i së drejtës martesore.

2. 8. Të dhëna statistikore mbi martesat dhe divorcet në Shqipëri pas viteve 90-të.

Gjatë shqyrtimit të statistikave të INSTAT, vihet re se vitet e para mbas hapjes së shoqërisë numri i divorceve ka qenë i ulët. Numri i divorceve në vitin 1990 ka qenë 2,675 ndërsa numri i martesave ka qenë 28,992. Nëse llogarisim raportin martesa-divorc të shprehur në përqindje del se vetëm 9.2 përqind e martesave kanë shkuar në divorc në këtë vit. Po me këto ritme ka vazhduar divorci edhe për vitet në vazhdim ku më i ulët ka qenë në vitin 1997. Gjatë këtij viti kemi 1,430 divorce, ndërsa martesa janë kryer 24,122. Vetëm 5.9% e martesave kanë bërë zgjidhje martesore. Një rritje e menjëherëshme e numrit të divorceve vihet re gjatë vitit 2002, e shprehur në përqindje ajo përbën 13.3% e martesave. Kjo rritje ka shënuar kulmin e saj në vitin 2006 me 19.1% ku numri total i martesave ka qenë 21,332 ndërsa ai i divorceve 4,075. Gjatë 10-vjeçarit të fundit viti 2006 shënon numrin më të lartë të divorceve krahasuar me vitet e tjera të cilat kanë një luhatje ndërmjet 3,000-3.750 divorce në vit. Përsa i përket martesave, numri i tyre ka qenë më i lartë në 10-vjeçarin e parë, pra gjatë viteve 1990-2000, krahasuar me vitet e fundit. Nëse vërejmë statistikën do të na bjerë në sy numri i lartë i divorceve që pasqyrohen në to. Në pamje të parë të duket sikur familja shqiptare po kalon në krizë si shkak i paqëndrueshmërisë dhe divorcit me të cilën shoqërohet ajo. Nga ana tjetër nëse u referohemi statistikave të martesave, ato mund të na e hedhin poshtë këtë pikëpamje, të cilën na e krijojnë divorcet për çdo vit. Numri i martesave sërish ngelet i lartë, pra mund të pohojmë se shqiptarët vazhdojnë ta respektojnë vlerën kulturore të martesës dhe të krijimit të një familjeje. Këtu mund të flasim edhe për një dukuri të re për kulturën tone, siç është ajo e bashkëjetesës e cila nuk ka ekzistuar më parë, por që kohët e fundit është bërë pjesë e jetës, si një fazë e

rëndësishmë përpara se një çift të shkojë drejt martesës. Bashkëjetesa është një bashkim fakti midis burrit dhe gruas që jetojnë në çift, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët, që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie (Kodi i Familjes Neni 163).

Bashkëjetesa asnjëherë nuk e ka zbehur rolin dhe rëndësinë e martesës, por ka shërbyer si një periudhë kohe e cila i jep më shumë mundësi çiftit për t'u njohur më mirë me njëri-tjetrin. Janë të rralla çiftet shqiptare, që lindin fëmijë gjatë bashkëjetesës dhe nuk kurorëzohen me martesë. Pesha specifike e këtyre rasteve është gati e papërfillshme në krahasim me ata që e kryejnë martesën ligjore.

Në studimin e me titull “Femra dhe Meshkuj në Shqipëri 2015”, bëhen prezente të dhëna dhe shifra konkrete lidhur me martesat dhe divorcet. Sipas studimit ka një rënie të martesave pas vitit 2011 si dhe ka një rritje të moshës së martesës. Informacioni i bazuar mbi statistikën vitale për moshën mesatare në martesë tregon një rritje të lehtë nga 27,7 në vitin 2007 në 29,5 vjeç në vitin 2014 për burrat dhe nga 22,4 në 24,0 vjeç për gratë (INSTAT, 2015, f.18). Ndërsa përsa i përket divorceve kemi një rritje të tyre nga 3.9 mijë në vitin 2001 në 4.2 mijë në vitin 2014. Sipas studimit kjo shkallë në rritje në numrin e tyre sugjeron se një pjesë më e madhe e popullsisë përfundojnë martesën e tyre me një divorc (INSTAT, 2015, f.18).

Gjatë shqyrtimit të “Evidenca statistikore për çështje civile” nga Gjykata e Rrethit Elbasan ajo që të bie menjëherë në sy është numri i lartë i divorceve për çdo vit të kryera nga kjo gjykatë. Nga ana tjetër një fakt që konstatohet gjatë analizimit të statistikave është se kërkesë-paditë për divorc të kryera nga gratë janë më të larta në numër në krahasim me kërkesat e bëra nga burrat.

Fig. 1.

Vitet	Numri i divorceve	Kërkesë nga bashkëshorti	Kërkesë nga bashkëshortja
2010	445	200	245
2011	468	212	256
2012	469	220	249
2013	483	218	265
2014	474	198	277

Burimi: Evidenca statistikore për çështje civile. Gjykata e rrethit Elbasan

2. 9. Problemet me të cilat përballen sot shumë martesë dhe familje në Shqipëri

Autorë të ndryshëm shqiptarë paraqesin problemet me të cilat përballen martesë si institucion në ditët e sotme në shoqërinë tonë. Problemet më të mëdha në martesë sipas tyre lidhen kryesisht me mentalitetin dhe temperamentin e popullit tonë. Gjithashtu autorët nuk lënë pa trajtuar edhe problemet që ka krijuar në shumë martesë emigracioni i njërit partner.

Tushi (2012, f. 94) do të shprehej se fillimi i ftohjes në komunikimet martesore ishte sinjal për fillimin e heshtjes së marrëdhënieve intime dhe sociale në martesë. Pra problemet sipas tij fillojnë me mospasjen e një komunikimi normal ndërmjet partnerëve, gjë e cila sjell pasoja negative për martesën.

Beqja dhe Sokoli në studimin e tyre bëjnë një panoramë të realizimit të martesave tradicionale para viteve 90-të në Shqipëri dhe realizimit të martesave në periudhën pas ndryshimeve politike. Tradicionalisht shqiptarët janë martuar për arsye më shumë të

karakterit praktik, për të siguruar mbijetesën. Sot çiftet martohen jo thjesht për mbijetesë por edhe për motive afektive (Beqja & Sokoli, 2000, f. 44). Sipas studiuesve kjo parakupton dashurinë, respektin e ndërsjellë, barazinë, qetësinë shpirtërore, me një fjalë mirëqenien emocionale. Pra ka ndryshuar koncepti tradicional për martesën në kohët e sotme.

Nora Malaj dhe Lekë Sokoli në librin “Problemet sociale bashkëkohore” pohojnë se: Martesa është një zotim dhe angazhim, një shkëmbim i vazhdueshëm midis një burri e një gruaje. Autorët japin edhe shpjegimin e tyre për këtë përkufizim të martesës. Termi zotim e angazhim lidhet me të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella të të martuarve, ndërsa shkëmbimi i vazhdueshëm shpreh faktin se nga martesa buron një ndërvarësi e pandërprerë midis të martuarve (Malaj, N. Sokoli, L. 2013, f. 151).

Lekë Sokoli në librin “Analiza sociologjike” na flet për një tip të ri familje të krijuar kohët e fundit si rezultat i kushteve ekonomike dhe sociale në Shqipëri. Autori e përkufizon këtë tip familje me termin “familja jotradicionale” për faktin se të detyruar nga rrethanat partnerët jetojnë të ndarë nga njëri-tjetri. Sipas autorit familja është mjaft e ndikuar sidomos nga emigracioni. Kjo nënkupton nga njëra anë një mundësi më shumë për plotësimin e nevojave ekonomike por edhe një rritje të numrit të familjeve me partnerë që jetojnë larg njëri-tjetrit. Në vetvete kjo është një premisë shpërbërje (Sokoli, L. 2006, f. 7-8). Kjo tip familje paraqitet mjaft problematike. Familja jotradicionale përfaqëson, ndoshta institucionin më të dhunshëm të shoqërisë. Eliminimi i saj përfaqëson kështu sfidën më të madhe të saj e të të gjithë shoqërisë (Sokoli, L. 2006, f. 143).

2. 9. 1. Dhuna në familje dhe divorci si pasojë e saj

Gëzim Tushi shprehet se një strukturë martesë që ngrihet mbi marrëdhënie konfliktuale është e destinuar të prishet, të dështojë. Ndërsa përsa i përket rritjes së numrit të kërkesave për divorc të bëra nga gratë autori shprehet:

“Nëse ka një rritje të numrit të grave që shkojnë në gjykatë dhe kërkojnë divorc, kjo duhet vlerësuar me kujdes dhe duhet parë në të dy anët e dikotomisë së saj. Sepse divorci në rastin e një “martese guerile” që brehet nga konflikti dhe dhuna bashkëshortore është edhe një shenjë e emancipimit të gruas, tregues i rritjes së vetdijes sociale edhe i formimit të personalitetit të saj. Por, shtimi i divorcit është tregues sintetik i faktit se janë shtuar burrat e dhunshëm në martesë, që janë mizorë me gratë, të vështirë për t’u përballur në agresivitetin e tyre, persekutorë të vërtetë” (Tusha, G. 2012, f.75).

Autori gjithashtu na paraqet edhe një tablo se si ka ndryshuar mentaliteti i shoqërisë sonë në evidentimin dhe trajtimin e dhunës në familje. Sipas tij kohë më parë studimi dhe evidentimi i dhunës, sidomos në familje ka qenë një tabu, dhuna ka qenë problem familjar i mbyllur përballë shoqërisë. Tusha bën prezente edhe ndryshimet në mentalitetin e shoqërisë sonë, të ditëve të sotme të cilat janë shumë të vogla përballë fenomenit por të paktën shoqëria ka filluar të reagojë. Edhe sot megjithë ndryshimet, statistikat sociale të këtij fenomeni janë ose aproksimative ose të pasakta (Tusha, G. 2012, f.75). Megjithatë kanë filluar të publikohen shifrat e para të këtij realiteti, pra problemi ka filluar të trajtohet. Dhe kjo flet se shoqëria shqiptare po qytetërohet dhe ka filluar të reagojë përballë cënimit të lirisë dhe të drejtave të grave si qenie sociale me attribute universalisht të barabarta me burrin (Tusha, G. 2006, f.73).

Dhuna në familje është një problem shqetësues i trajtuar edhe nga Beqja dhe Sokoli. Autorët paraqesin edhe shkaqet se përse gratë vazhdojnë “të pranojnë” të jenë të dhunuara. Një shkak sipas tyre është edhe dhuna bashkëshortore. Sipas autorëve analiza e

konfliktualitetit familjar të çon në përfundimin disi paradoksal: Familja, celula bazë e shoqërisë grupi më i zakonshëm social, arena ku shprehen ndjenjat më njerëzore dhe ku realizohet jeta intime, çuditërisht rezulton të jetë grupi social ndër më të dhunshmit, në mos më i dhunshmi (Beqja & Sokoli, 2000, f. 77). Autorët paraqesin gjithashtu arsyet se përse tolerohet dhuna nga gratë. Dhuna bashkëshortore, ushtrimi i saj nga burrat apo tolerimi nga gratë nuk lidhet thjesht me divorcin. Ajo ka një ndikim shumëpamësor e lidhet parasëgjithash me personalitetin e njeriut në kuptimin e lirive e të drejtave themelore të tij. Ajo është një tregues sistematik i shkallës së (mos) emancipimit të individëve (Beqja & Sokoli, 2000, f. 81). Ata paraqesin shkaqet se përse gratë vazhdojnë të jenë të dhunuara.

Së pari ushtrimi i dhunës bashkëshortore është deri diku reflektim apo rigjallërim i traditës sonë familjare sipas së cilës gruaja konsiderohej si një qenie thuajse pa të drejta.

Së dyti dhuna mbi bashkëshorten lidhet në një farë mënyre me kapadaillëkun, me mentalitetin për ta gjetur fajin e të keqen gjithnjë tek tjetri dhe pothuajse asnjëherë tek vetja.

Së treti në Shqipëri akoma nuk është bërë institucionalisht e mundur evitimi i dhunës bashkëshortore. Te ne mungojnë institucionet që mbrojnë gratë bashkëshorte e të tjera gra viktime të abuzimit e dhunës. (Beqja & Sokoli, 2000, f. 81-82)

Tushi i kërkon shkaqet e dhunës në familje tek gjendja e vështirë ekonomike dhe varfëria e saj. Si pasojë e varfërisë gratë ndihen inferiore sepse ose janë të papuna, ose sigurojnë më pak të ardhura se burrat. Sipas tij me siguri që varfëria e familjes është një nga shkaqet që nxit dhunë. Në familjet e varfra ka më shumë dhunë të natyrës fizike. Padyshim kjo lidhet me pozitën social-ekonomike të gruas dhe të kontributit të saj të pakët në buxhetin familjar sepse gruaja vazhdon të jetë masivisht më pak e punësuar ose tërësisht e papunë (Tushi, G. 2006, f. 74-75). Kjo situatë gjeneron inferioritet, konflikt social dhe dhunë mbi të (f. 75).

Në studimin me titull “Dhuna ndaj grave në familje në Shqipëri” (UNICEF 2003), bëhet prezente mungesa e barazisë gjinore në familjet tona po përveç saj vazhdimësisë së roleve tradicionale gjinore. Sipas studimit “...rolet tradicionale gjinore mund të shkatërrojnë marrëdhëniet e partnerëve” (UNICEF, 2003, f. 27). Gjatë studimit konkludohet se burrat abuzivë janë dominantë në procesin e marrjes së vendimeve të familjes, duke mos i përfshirë në këtë proces gratë. Nga ana tjetër grave u kërkohet që të marrin përsipër përgjegjësinë për punët e shtëpisë si dhe përkujdesjen ndaj fëmijëve duke i quajtur këto si punë të grave. Partneriteti midis burrave dhe grave për përballimin e problemeve të jetës familjare, është i panjohur për shumë çifte shqiptare (UNICEF, 2003, f. 61). Kundërshtimi i roleve dhe i pritshmërive gjinore tradicionale sjell si rezultat abuzimin fizik dhe psikologjik (po aty f. 61). Si pasojë e dhunës së ushtruar nga partneri gratë kanë parë si zgjidhje të problemit të tyre divorcin. Sipas studimit nga shumë gra të dhunuara divorci është parë si strategji aktive. Pavarësisht disa pengesave gratë përmendin përfitimet që kanë pasur nga divorci prej partnerit abuziv (UNICEF, 2003, f. 63). Përfitimet sipas studimit kanë të bëjnë kryesisht me rifitimin e dinjitetit të tyre, ndjenjën e vetëvlerësimit, dhe kontrollin personal të jetës së tyre.

Në udhëzuesin me titull “Dhuna në familje në fokusin e medias” të Aleancës Gjinore për Zhvillim (2008) paraqiten disa faktorë që kontribuojnë në shtimin e dhunës ndaj gruas. Sipas këtij studimi problemet me dhunën ndaj grave lidhen që me përkufizimin e rolit të gruas/bashkëshortes në shoqëri. Mjedisi ynë social-kulturor mbart vlera e botëkuptime patriarkale të trashëguara, si i tillë rëndon shumë pozicionin e grave, historikisht të rritura nën një traditë diskriminuese gjinore (Aleanca Gjinore për Zhvillim, 2008, f. 18). Por krahas mjedisit social-kulturor janë dhe pritshmëritë e paarsyeshme rreth rolit të gruas, si dhe vlerat kulturore që i tolerojnë sjelljet e dhunshme ndaj gruas e lehtësojnë ushtrimin e dhunës. Ndër

faktorët e tjerë që paraqet studimi janë papunësia apo stresi në punë si, dhe varësia ekonomike e gruas e cila lidhet me mentalitetin patriarkal. Ndjenja e paaftësisë: Kjo ndjenjë mund të çojë sjellje të dhunshme ndaj bashkëshortes (Aleanca Gjinore për Zhvillim, 2008, f. 18).

2. 10. Ndikimi i emigracionit në jetën bashkëshortore dhe atë familjare.

Emigracioni i shqiptarëve drejt vendeve të tjera si problem është trajtuar nga shumë studime të ndryshme të karakterit social por edhe ekonomik. Nga pikëpamja sociale janë trajtuar pasojat me të cilat shoqërohet emigrimi i njërit nga partnerët duke e lënë familjen në Shqipëri ose i të dy partnerëve duke i lënë fëmijët pranë të afërmëve të tyre. Emigrimi i shqiptarëve drejt vendeve të tjera ndodh kryesisht për arsye ekonomike, për shkak të papunësisë së lartë në vend. Emigracioni ka ndikuar pozitivisht në përmirësimin e situatës ekonomike në vend për shkak të remitancave.

Beqja dhe Sokoli në një studim të publikuar në revistën “Politika dhe Shoqëria” (2009) paraqesin ndikimin e emigracionit në dinamikën e divorceve. Sipas studimit emigracioni çon në rritjen e numrit të divorceve pasi ai ka një ndikim negativ. Sipas tyre “...lidhja martesore midis një gruaje që “pret” në qytetet apo fshatrat e Shqipërisë dhe një burri që vazhdon të punojë e të jetojë (ndoshta edhe të bashëjetojë me dike) në Itali, Greqi, Gjermani, Zvicër e gjetkë nuk mund të vazhdojë pafundësisht” (Beqja dhe Sokoli, 2009, f. 74).

Në një studim të kryen nga UNICEF (2009) me titull “Migracioni shqiptar ndikimi i tij në jetën ekonomike dhe sociale të fëmijëve të lënë pas” bëhen prezente si anët pozitive të emigracionit përse i përket rritjes së mirëqënies ekonomike dhe materiale por edhe pasojat

sociale për familjen dhe fëmijët e tyre. Megjithatë ndikimi pozitiv në mirëqenien materiale nuk ka të njëjtën efekt edhe në mirëqenien emocionale. Ka një rritje të divorceve, ndonëse nuk ka evidenca se cili është shkaku kryesor (UNICEF, 2009, f. 9). Në këtë raport përshkruhet mënyra se si emigrojnë kryesisht shqiptarët. Emigracioni ka karakter individual, në familje me fëmijë, fillimisht emigron kryetari i familjes dhe ndoshta më vonë edhe pjesa tjetër e saj (UNICEF, 2009, f. 14). Pikërisht këtu e kanë zanafillën problemet në familjet e emigrantëve pasi sipas studimit "...ka një rritje të numrit të divorceve dhe rritje të problemeve të natyrës emocionale tek fëmijët e lënë pas" (UNICEF, 2009, f. 14). Emigrimi i shqiptarëve bëhet në mënyrë individuale pasi në strategjinë e familjes për të emigruar e gjithë familja së bashku ndikojnë disa faktorë si: "...statusi civil i emigrantit (i martuar apo i pamartuar); natyra e emigrimit (legale apo jo-legale); koha e qëndrimit në emigrim (i përhershëm apo i përkohshëm) (UNICEF, 2009, f. 16). Përveç tyre një ndikim shumë të rëndësishëm kanë edhe faktorët që lidhen me "...ekzistencën e një sigurie ekonomike bazë, nga ku më të rëndësishmit janë strehimi dhe punësimi kundrejt të ardhurave të mjaftueshme për të mbajtur familjen (UNICEF, 2009, f. 16). Pamundësia për të siguruar kushtet e domosdoshme për të marrë edhe familjen me vete në emigracion bën që numri i emigrimit individual të jetë mjaft i lartë krahasuar me emigrimin familjar. Në vitin 1993 vetëm 31 përqind e emigrantëve jetonte me familjen, ndërsa në vitin 2006 kjo shifër arriti në 58 përqind (po aty, f. 16). Sigurisht që kjo mënyrë emigrimi është shoqëruar me probleme për bashkëshortet e lëna pas dhe fëmijët e tyre. Ato "...të ngarkuara me kujdesin e fëmijëve shpesh përballen me përgjegjësi të shtuara, pa pasur njëkohësisht mjetet e nevojshme për të kapërcyer sfidat e reja që shkakton emigrimi" (UNICEF 2009, f. 18). Studimi evidenton një tjetër problem mjaft shqetësues që lidhet me emigrimin e ty dy prindërve pa marrë fëmijët

me vete. Shpërbërja e familjes së zgjeruar dhe emigrimi i prindërve ka rritur riskun e abandonimit të fëmijëve apo të lënit përkohësisht nën kujdestarinë e strukturave të përkujdesjes shoqërore (UNICEF, 2009, f. 18). Shtimi i rasteve të tilla të lënies të fëmijëve pranë këtyre institucioneve relatohet edhe nga vetë këto institucione.

Studimi me titull “Legjislacioni shqiptar mbi statusin e jetimit. Analizë e nevojave për ndryshime”. (2012) publikuar në: <http://www.soskd.org.al/doc/SOS%20AL%20Statusi%20Jetimit%20Analize%20Ligjore.pdf> nga: SOS Fshatrat e Fëmijëve në Shqipëri, trajton statusit social të fëmijëve në të gjitha Institucionet e Përkundesjes Shoqërore. Në IPSH “...rreth 80 përqind janë fëmijë që vijnë nga familje me prindër të divorcuar, me probleme sociale, të burgosur, të larguar në emigracion, etj.”(SOS, 2012). Gjithashtu, rimartesa e prindërve, ka qenë problem për fëmijët të cilët nuk janë mirëpritur nga partneri i ri i prindit. Nga ana tjetër një pjesë e prindërve të larguar në emigracion, i dërgojnë fëmijët e tyre pranë këtyre institucioneve. Emigracioni nuk është i lehtë si për prindërit po ashtu edhe për fëmijët.

Në studimin e kryer nga INSTAT me titull “Migracioni në Shqipëri 2014”, jepen detaje dhe shifra reale në lidhje me emigracionin individual dhe familjar. Studimi i referohet të dhënave të marra nga AMNJ 2012. Më shumë se 60 përqind e emigrantëve i kanë me vete partnerët/et dhe fëmijët jashtë (përkatësisht, 65,5 dhe 60,1), kurse 5,6 përqind pohojnë se fëmijët e tyre qëndrojnë ende në Shqipëri (INSTAT, 2014, f. 48). Nga këto të dhëna kuptojmë se gjendja ka ardhur në përmirësim por sërish një pjesë e madhe familjesh jetojnë të ndara për shkak të emigrimit individual të kryefamiljarit. Sipas studimit “...pavarësisht nëse janë

të përfshirë ose jo fëmijët kostoja, psikologjike e këtyre situatave komplekse familjare mund të jetë e lartë e të ketë ndikim negativ mbi shëndetin e familjes (INSTAT, 2014, f. 48).

2. 10. 1. Statusi civil i emigrantëve në Greqi

Jennifer Cavounidis në studimin me titull: “Migration to Greece from the Balkans” (Migracioni në Greqi nga Ballkani) bën një panoramë krahasuese të statusit civil të emigrantëve në Greqi duke përfshinë edhe emigrantët shqiptarë. Sipas Cavounidis referuar të dhënave nga Censusi i vitit 2001 në Greqi për emigrantët shqiptarë, 58.7 përqind janë burra dhe 41.3 përqind janë gra. Grupmosha 30-44 vjeç përbën 28.8 përqind e cila është më e lartë krahasuar me grupmoshat e tjera të emigrantëve shqiptarë. Gati gjysma e meshkujve shqiptarë që kanë aplikuar për tu pajisur me dokumenta në Greqi ishin beqarë dhe pothuajse të gjitha gratë ishin të martuara (Cavounidis, J. 2004, f. 42). Nga të dhënat e vitit 1998 ndër emigrantët shqiptarë meshkuj 50.3 përqind janë të martuar 49.1 përqind janë beqarë dhe 0.4 përqind janë të divorcuar. Përsa u përket të dhënave për femrat 80.4 përqind e tyre janë të martuara, 15.3 përqind janë beqare dhe 2.8 përqind janë të divorcuara.

Në artikullin “Roli i remitancave në zhvillimin ekonomik-social të vendit” Gëdeshi dhe Uruci publikuar në http://www.bankofalbania.org/web/pub/b_15_Fjalimi_Gedeshi_Uruci_786_1.pdf, jepen të dhëna statistikore mbi emigrantët në Itali. Sipas statistikave zyrtare italiane për vitet 1992 dhe 1999 vihet re se në emigracionin legal shqiptar është rritur përqindja e grave dhe e bashkimit familjar (Gëdeshi dhe Uruci, 2003, f. 2-3). Sipas të dhënave në vitin 1999, 34 përqind e migrantëve legalë ishin femra ndër të cilat 54.5 përqind ishin të martuar. Gjithashtu,

një numër i madh migrantësh shqiptarë (18.7 për qind) kanë në familjet e tyre edhe fëmijë. Këto të dhëna tregojnë për dinamikën e ribashkimit të familjeve të migrantëve shqiptarë në Itali (Gëdeshi dhe Uruci, 2003, f. 3).

2. 11. Ndikimi i kushteve ekonomike tek divorci ose pamundësia për të bërë divorc.

Kushtet ekonomike në të cilat ndodhet familja ose bashkëshortët kanë një ndikim të dyfishtë në vazhdimësinë e një martese problematike. Duke iu referuar Beqja dhe Sokoli (2009) këto kushte mund të ndikojnë në mënyrë kontradiktore mbi divorcin. Nga njëra anë ato mund të bëhen shkas për acarim të çiftit bashkëshortor (Beqja dhe Sokoli, 2009, f. 74). Partnerët mund të kenë mosmarrëveshje pikërisht për shkak të varfërisë. Nga ana tjetër ato mbajnë peng shumë martesa të konsumuara (Beqja dhe Sokoli, 2009, f. 74). Martesa të tilla do të kishin shkuar në divorc nëse do të kishin mundësi ekonomike. Sipas studiuesve rritja ekonomike do të mundësojë edhe rritjen e divorceve. Me rritjen e nivelit të zhvillimit do të rritet mundësia e asistimit të familjeve të divorcuara posaçërisht të grave dhe fëmijeve. (Beqja dhe Sokoli, 2009, f. 74). Megjithëse kjo asistencë sipas studiuesve në kushtet e sotme është pothuajse e papërfillshme.

“Raporti për monitorimin e rregullshmërisë së proçeseve gjyqësore në gjykatën e rrethit gjyqësor Elbasan” (USAID. FGE. 2013), një program i Forumit të Gruas Elbasan paraqet problemet ekonomike me të cilat përballen kryesisht gratë e dhunuara të cilat kërkojnë ndihmë pranë kësaj qendre. Shumë gra të dhunuara kërkojnë ndihmë juridike falas pranë Forumit të Gruas Elbasan për të bërë zgjidhjen e martesës me bashkëshortin dhunues pasi nuk kanë mundësi ekonomike për ta bërë vetë një gjë të tillë. Kjo OJF. ofron asistencë

dhe ndihmë juridike falas vetëm për gratë e dhunuara. Nga këto të dhëna mund hamendësojmë se numri i martesave të konsumuara por që nuk divorcohen për shkak të pamundësisë ekonomike mund të jetë shumë më i lartë.

2. 12. Barazia gjinore në martesë

Barazisë gjinore në martesat në shoqërinë shqiptare është shumë e pakët pasi dominon patriarkalizmi. Kjo gjë mund të ndikojë në rritjen e numrit të divorceve, sipas Beqja dhe Sokoli (2009). Në rritjen e numrit të divorceve do të ketë peshë edhe inkurajimi i zbatimit të politikave të barazisë midis burrave dhe grave (f. 74). Gratë do përpiqen të kenë më tepër barazi ndërmjet tyre dhe bashkëshortëve të tyre. Në mungesë të alternativave të tjera për sigurimine barazisë së tyre reale janë gratë ato që mesa duket do të kërkojnë zgjidhjen e martesës. (Beqja dhe Sokoli, 2009, f. 74.)

KAPITULLI III: METODOLOGJIA

3.1. Përshkrim i përgjithshëm

Studimi mbi divorcin mund të realizohet me metoda të ndryshme, sasiore dhe cilësore, ose edhe duke bërë një kombinim të tyre. U pa si më e arsyeshme nga ana ime që për realizimin e këtij studimi të përdorimet metodat cilësore. Vendosa të përdor këto metoda për vetë natyrën e problematikës që trajton tema me qëllim që të mësohet më në thellësi se si kanë ndikuar faktorët e jashtëm, në rastin konkret emigracioni hapja e shoqërisë në rritjen e numrit të divorceve. Gjetjet ishin më të larmishme dhe më të kompletuara me të dhënat e duhura me përdorimin e këtyre metodave. Për realizimin e këtij studimi u përdorën të dhëna parësore, intervesta gjysmë të strukturuar të kryera me persona të divorcuar dhe të dhëna të mbledhura nga realizimi i grupeve të fokusit. Në studim u përfshinë edhe të dhëna dytësore të cilat janë mbledhur gjatë shfrytëzimit të literaturës së huaj por edhe vendase, dokumente, statistika.

Përparësia e përdorimit të metodave cilësore në realizimin e këtij studimi lidhet me faktin se ato "...merren më së shumti me histori dhe rrëfime, dhe përfshijnë kuptime subjektive, ndjenja, mendime dhe bindje (Mathewus, B. Ross, L. 2010, f. 142). Duke qënë se kemi të bëjmë me fjalë, histori, përvoja vetjake të pjesëmarrësve në studim pasi divorci është një çështje personale më karakter vetjak sepse ka të bëjë me ndarjen e dy partnerëve, këto metoda u panë si më efektive për kryerjen e tij. Në rastin e studimit të divorcit "ka nevojë të kapet realiteti ashtu siç është, pra në ndërveprim" (Papajani, A. 2011, f. 70), pasi një studim cilësor e paraqet realitetin në mënyrë më të plotë duke trajtuar konkretisht dukurinë rast pas

rasti. Për të studiuar si duhet dukuria duhet të futesh në thellësi të saj për të analizuar çdo veçori dhe specifike të saj. Dhe kjo gjë realizohet më së miri falë këtyre metodave pasi hulumtuesi është më pranë mjedisit të tij të studimit.

Të dhënat dytësore, përdorimi i tyre në këtë studim, kanë luajtur një rol të rëndësishëm sepse e kanë pasuruar atë si dhe kanë krijuar një larmishmëri me të dhëna.

Të dhënat dytësore mund të jenë mbledhur nga të tjerët për hulumtime ose qëllime të tjera (Mathewus, B. Ross, L. 2010, f. 54). Në këtë studim janë përdorur të dhëna dytësore të natyrave të ndryshme që nga studime, dokumenta, statistika etj. Të dhënat cilësore paraqiten në forma të ndryshme dhe janë relativisht të pastrukturuara (Mathewus, B. Ross, L. 2010, f. 373). Analizimi i këtyre të dhënave është realizuar duke përdorur modelin përfaqësues. Në varësi nga pyetjet e hulumtimit, ky model mund të përfshijë edhe mbledhjen e të dhënave cilësore, në rastet kur pjesëmarrësit janë zgjedhur në mënyrë të qëllimshme, që të përfshijnë një gamë të caktuar njerëzish (Mathewus, B. Ross, L. 2010, f. 122).

Në këtë studim u përdorën dy lloje të dhënash dytësore:

1-Të dhëna dytësore të përpunuara që kishin të bënin kryesisht me studime të ndryshme të kryera nga studiues si jashtë vendit por dhe brenda vendit, statistika nga INSTAT, gjithashtu studime të kryera nga institucione dhe organizata të ndryshme që veprojnë në Shqipëri.

2- Të dhëna dytësore të papërpunuara të cilat kishin të bënin me dosjet e kërkesë-padive për zgjidhje martesore të siguruara nga gjykata. Këto dosje përmbajnë një shumëllojshmëri të dhënash mbi çiftin që është divorcuar.

Në këtë studim u përdorën të dhënat dytësore të mbledhura nga literatura e huaj e cila kishte të bënte kryesisht me studime mbi divorcin në vende të ndryshme kryesisht gjatë viteve të fundit. Literatura u përzgjedh në mënyrë të tillë që të jepte mundësi për të bërë krahasime, për të parë dallimet dhe ngjashmëritë e problemit në vende dhe shoqëri të ndryshme. Shqyrtimi i literaturës më dha një ndihmë shumë të rëndësishme për të kuptuar situatën lidhur me divorcin në vend por edhe në rajon e më gjerë. Nëpërmjet saj krijova një ide të përgjithshme lidhur me shkaqet e divorcit në vende të ndryshme si dhe evoluimi dhe ndryshimi i tyre në varësi të kohës dhe rrethanave sociale, kulturore dhe ekonomike. Kjo gjë më dha një ndihmë të madhe edhe në formulimin e pyetjeve kërkimore të studimit për t'i krahasuar ato me gjetjet. Në këtë studim siç u përmend edhe më lart janë përdorur edhe të dhëna dytësore të papërpunuara. Këto të dhëna janë siguruar nga shqyrtimi dhe trajtimi, analizimi i 600 dosje të zgjidhjeve martesore në Gjykatën e rrethit Elbasan në shtrirjen kohore 2008-2014. Shqyrtimi dhe mbledhja e të dhënave nga këto dosje është bërë e mundur nga Zyra e psikologut pranë kësaj gjykate. Të dhënat nga këto dosje kanë vërtetësi dhe besueshmëri të lartë pasi kanë karakter zyrtar dhe mbi ato të dhëna është zhvilluar procesi gjyqësor i zgjidhjes së martesës.

Intervista gjysmë të strukturuar shtrihen diku midis atyre të strukturuar dhe të pastrukturuar. Niveli i strukturimit të një interviste varet nga tema e kërkimit, qëllimi, burimet, standartet metodologjike, preferencat dhe lloji i informacionit të kërkuar i cili natyrisht përcaktohet nga objektivi i kërkimit” (Papajani, A. 2011, f. 128-129). Ato lidhen me mbledhjen e të dhënave shoqërore cilësore, kur hulumtuesi është i interesuar të mësojë

për përvojat, sjellet dhe kuptimet e njerëzve, dhe si e pse e kuptojnë ata botën shoqërore në këtë mënyrë (Mathewus, B. Ross, L. 2010, f. 167).

Grupi i fokusit është një metodë për mbledhjen e të dhënave që mbështetet në dinamikën e grupit për të prodhuar të dhëna cilësore, të thelluara të pasura (Mathewus, B. Ross, L. 2010, f. 235). Në grupet e fokusit ofrohet mundësia që njerëzit të eksplorojnë dhe sfidojnë përvojat e të tjerëve ku mund të bëhen reflektime vetjake në një mjedis të organizuar dhe ku pjesa më e madhe e asaj që ndodh brenda grupit është në duart e pjesëmarrësve (f. 236). Në studim janë përfshirë edhe dy grupe fokusi të cilat janë organizuar me gra të divorcuara pranë Forumit të Gruas Elbasan.

Përdorimi i metodave cilësore në këtë studim u bë për disa arsye që lidhen më së shumti me karakteristikat dhe mundësinë që japin ato për ta trajtuar problemin më në thelb.

Divorci në vetvete është një çështje me karakter personal por dhe një problem mjaft kompleks. Si një dukuri komplekse ai nuk mund të matet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Matja e tij realizohet më së miri nëpërmjet metodave të tërthorta. Ne nuk mund të masim shkallën e ndikimit të emigracionit në divorc duke ndërtuar indekse me tregues konkretë pasi është e vështirë të gjesh tregues realë. Nga ana tjetër të dhënat që u përdorën për këtë studim ishin të pastrukturuara sepse ato vinin nga intervistat gjysmë të strukturuara dhe grupet e fokusit, dy metoda të cilat prodhojnë të dhëna të pastrukturuara. Studimi kishte të bënte më tepër me përvoja personale të pjesëmarrësve gjë e cila mund të studiohet më së miri nga metodat cilësore. Sic e përmendëm edhe më lart "...metodat cilësore të hulumtimit merren më së shumti me histori dhe rrëfime, dhe përfshijnë kuptime subjektive, ndjenja, mendime dhe

bindje” (Mathews, B. Ross, L. 2010, f. 142). Në kontekstin shqiptar ka shumë pak studime për divorcin dhe referuar Mathews dhe Ross (2010) kjo është një metodë e dobishme kur nuk ka shumë studime të mëparshme. Divorci në vetvete është i matshëm nëse u referohemi statistikave zyrtare. Por shkalla e ndikimit të emigracionit në rritjen e numrit të divorceve nuk është një fenomen me tregues të matshëm në mënyrë sasiore nëpërmjet këtyre metodave. Ndikimin e emigracionit tek divorci mund ta studiojmë nëpërmjet metodave cilësore sepse këto metoda “...kanë për qëllim të prodhojnë llojin më të mirë të të dhënave me të cilat mund të punohet sipas secilës qasje (Mathews, B. Ross, L. 2010, f. 147). Metodat cilësore kanë disa avantazhe të cilat u menduan se i bënin ato më të vlefshme dhe më rezultative në realizimin e studimit. Këto avantazhe qëndrojnë në vendosjen e kërkuesit më pranë realitetit duke i realizuar vetë intervistat me pjesëmarrësit. Kjo gjë të jep mundësi për marrjen e informacionit të plotë në përputhje me pyetjet e hulumtimit. Me këto metoda studimi i realitetit bëhet nga brenda, kanë fleksibilitet gjatë përdorimit të tyre në përshtatje me studimin. Duke qenë se të dhënat e studimit ishin të papërpunuara ishte e domosdoshme analizimi dhe interpretimi duke i përmbledhur dhe kategorizuar ato. Kjo gjë nuk mund të realizohej nëpërmjet metodave sasiore. Kufizimi i përdorimit të metodave sasiore lidhet edhe me vështirësinë për të siguruar një numër të konsiderueshëm pjesëmarrësish në studim. Vështirësia këtu lidhet me natyrën e problemit që trajton studimi. Nga konteksti mbi të cilin bazohet studimi pjesëmarrësit rrëfejnë një pjesë nga jeta e tyre personale që ka të bëjë me marrdhëniet e tyre me partnerin gjatë martesës së tyre. Pikërisht për këtë gjë në shoqërinë shqiptare me një mentalitet pak sa të prapambetur edhe si pasojë e regjimit të kaluar jo të gjithë janë të gatshëm për tu bërë pjesë e studimit. Mëgjithëse ajo që vihet re ndër brezat e

rinj është fakti së janë më të çlirët dhe më të hapur për ndarë përvojat dhe eksperiencat problematike me bashkëshortin gjatë martesës së tyre.

3.2. Popullata dhe kampionimi

3.2.1. Popullata

Siç e kam theksuar edhe më lart ky studim është kryer në qarkun e Elbasani me një popullsi prej 301,397 banorësh referuar INSTAT, (2015). Pjesa më e madhe e popullsisë është nga zonat rurale e cila përbën rreth 60.7 përqind të totalit. Në qarkun e Elbasanit bëjnë pjesë 7 bashki ku më e madhja përta i përket shtrirjes gjeografike por edhe numrit të popullsisë është e Elbasanit, Librazhdi, Prrenjasi, Gramshi, Peqini, Cërriku, Belshi. Popullata është përgjithësisht heterogjene përta i përket vendbanimit sepse janë nga qytete të ndryshme si dhe zona urbane dhe rurale.

3.2.2. Kampionimi

Gjatë përzgjedhjes së kampionit u bë kujdes për përfshirjen e pothuajse të gjithë hapësirës gjeografike e cila përbëhet nga zona fushore dhe malore. Kjo gjë u bë me qëllim për të kuptuar të gjithë problematikën me të cilën përballet familja dhe martesa sot në qytete të ndryshme si në zonat rurale dhe ato urbane, në zonat fushore dhe ato malore. Kampioni që u përzgjodh për realizimin e këtij studimi ishte jo-probabilitar dhe në këtë rast ishte i qëllimshëm. Këto qasje lidhen zakonisht me studime të thelluara në shkallë të vogël, ku modelet e hulumtimit mbështeten në zgjedhjen e të dhënave cilësore dhe fokusohen në eksplorimin dhe interpretimin e përvojave dhe perceprimeve (Mathewus, B. Ross, L. 2010, f. 167). Kjo qasje u përdor për faktin se studimi u krye në një hapësirë të kufizuar. Kampioni

i përzgjedhur ishte homogjen pasi të gjithë pjesëmarrësit kishin të njëjtën problematikë, ishin të divorcuar dhe divorci kishte ardhur pas emigrimit të njërit ose të dy partnerëve. Sipas Ritchie dhe Lewis (2003) tek kampioni homogjen të gjitha rastet i përkasin të njëjtit grup ose kanë të njëjtën karakteristikë. Kjo mundëson një hetim në thellësi dhe të detajuar të dukurive shoqërore në fjalë (shih; (Mathewus, B. Ross, L. 2010, f. 167). Kjo përzgjedhje u bë me qëllim që të studiohej më në thellësi divorci si dukuri dhe ndikimi që ka emigracioni në marrëdhëniet martesore.

3.2.3. Qasja e kampionimit të studimit

Për realizimin e këtij studimi siç e kam përmendur edhe më lart janë përdorur disa metoda cilësore. Për secilën nga këto metoda janë përdorur qasje specifike me qëllim që t'i përshtatej sa më mirë studimit dhe për të siguruar të dhënat e nevojshme.

Për intervistat e drejtpërdrejta u përdor kampionimi jo-propabilitar. U pa si më e volitshme të përdorej qasja e kampionimit të qëllimshëm. Rastet zgjidhen mbi bazën e karakteristikave apo përvojave që lidhen drejtëpërsëdrejti me fushën e interesit të studiuesit dhe pyetjet e hulumtimit dhe që i mundësojnë atij ta studiojë temën në thellësi (Mathewus, B. Ross, L. 2010, f. 167). Për gjetjen e pjesëmarrësve në studim u përdorën dy mundësi kryesore, institucioni i gjykatës dhe më konkretisht Zyra e psikologut nëpërmjet së cilës u bë e mundur kontakti dhe realizimi i pjesës më të madhe të intervistave. Ndhimesë për pjesëmarrës në studim ka dhënë edhe Forumit i Gruas Elbasan, një organizatë në mbrojtje të grave të dhunuara ku kam realizuar një pjesë intervistash. Ndërsa një pjesë tjetër intervistash

janë mundësuar nëpërmjet njohjeve personale dhe familjare me persona të divorcuar të cilët janë bërë pjesë e studimit falë këtyre njohjeve. Gjatë përzgjedhjes së kampionit u mbajt parasysh fakti që secili prej tyre të kishte lidhje me emigrimin që nënkupton se njëri nga partnerët ose të dy duhet që kishin qenë emigrantë. Informacioni për secilin rast u sigurua nga dosja e kërkesë-padisë për divorc pranë Zyrës së psikologut të gjykatës. Gjithashtu gjatë përzgjedhjes u mbajt parasysh edhe vendbanimi i secilit prej pjesëmarrësve që nënkupton zona urbane dhe rurale por edhe qytete të ndryshme për të krijuar një larmishmëri zonash të ndryshme. Në kampionin e përzgjedhur për studim u përfshinë individë me nivele të ndryshme të arsimit, nga ata që nuk e kishin mbaruar arsimin e detyrueshëm e deri tek ata me arsim të lartë, të punësuar dhe të papunësuar, për të studiuar më specifikisht problematikën që paraqet secila kategori sociale, përta i përket marrëdhënieve bashkëshortore dhe divorcit. Po të njëjtat kritere u mbajtën parasysh edhe në përzgjedhjen e kampionit pranë FGE-së por ky kampion kishte një specifikë të veçantë sepse ato ishin viktima të dhunës së bashkëshortëve të tyre. Grupi i intervistave me të njohur u përzgjodh mbi këto kritere.

Në një pjesë të vogël intervistash dolën në pah disa të dhëna që ndryshonin nga pjesa tjetër, të cilat nuk ishin parashikuar gjatë ndërtimit të udhëzuesit të intervistës. Procesi i intervistimit zgjati deri sa arriti pikën e ngopjes, pra u mor i gjithë informacioni i duhur për procesin e studimit dhe vazhdimi i tij nuk po jepte më të dhëna të reja.

Për realizimin e *grupeve të fokusit* u përzgjodh *kampion i qëllimshëm*. Ky kampion përveç faktit që ishin divorcuar, që partnerët kishin qenë në emigracion kishte edhe një specifikë të veçantë dhunën fizike dhe psikologjike të ushtruar ndaj tyre nga bashkëshorti.

Organizimi i këtyre grupeve pati si qëllim evidentimin e një problematike që lidhej drejtëpërsëdrejti me njërën nga pyetjet e studimit. Nëpërmjet tyre u mbledhën të dhëna shumë të rëndësishme dhe esenciale për studimin.

3.2.4. Të dhëna mbi pjesëmarrësit në studim.

Në intervistat gjysmë të strukturuar morën pjesë 40 të divorcuar prej të cilëve 29 ishin gra dhe 11 ishin burra.

Për mbledhjen e të dhënave të studimit u realizuan dy grupe fokusi. Grupi i parë kishte në përbërje të vet 10 pjesëmarrëse, ndërsa grupi i dytë kishte 11 pjesëmarrëse. Pra gjithësej ishin 21 pjesëmarrëse të cilat ishin të gjitha gra për vetë problematikën që u trajtua në këto grupe fokusi.

Në këtë studim u përfshinë në intervistat gjysmë të strukturuar dhe grupet e fokusit 61 persona nga të cilët 50 janë gra dhe 11 janë burra.

Ky grup mbi të cilin u krye studimi ka një shtrirje gjeografike e cila i përfshin pothuajse të gjitha zonat e qarkut nga të shtatë bashkitë e tij, zonat urbane dhe rurale.

Moshës e pjesëmarrësve në studim të intervistuarit dhe grupet e fokusit i përkasin intervalit moshor 20-55 vjeç.

Përsa i përket nivelit arsimor të pjesëmarrësve 30 prej tyre pohojnë se kanë kryer vetëm arsimin e detyrueshëm 8-vjeçar, ndërsa 26 prej tyre pohojnë se e kanë kryer arsimin e mesëm dhe 7 prej tyre kanë përfunduar arsimin e lartë. Përfshirja në studim e pjesëmarrësve

me nivel të ndryshëm arsimor u bë qëllimisht për të kuptuar se si ka ndikuar arsimi në marrëdhëniet martesore dhe jetëgjatësinë e martesës.

Ndërsa përsa i përket punësimit në studim janë përfshirë të dy kategoritë të punësuar edhe të papunësuar që përkohësisht janë të papunë por dhe një kategori të cilët nuk kanë punuar asnjëherë në jetën e tyre.

3. 3. Realizimi i studimit

Divorci ka qenë një çështje që ka nxitur kureshtjen time sidomos për shkaqet dhe arsyet që e shkaktojnë atë. Mbas një informacioni të përgjithshëm që mora nga media përsa i përket realitetit në vend, dhe më pas në rajon e më gjërë iu përkushtova akoma më tepër kësaj çështjeje duke u përqëndruar në studime të ndryshme të kryera si brenda vendit po dhe jashtë në rajon e më gjerë. Meqenëse divorcet kryhen në gjykatë dhe paraprakisht çiftet bëjnë seanca ndërmjetësimi me psikologun, unë iu drejtova pikërisht kësaj zyre për të marrë informacion specifik dhe të detajuar lidhur me çiftet që divorcohen. Zyra e psikologut më vuri në dispozicion për të marrë të dhëna të detajuara rreth 600 dosje të çifteve të divorcuara. Secila prej këtyre dosjeve përmbante informacion të detajuar që nga mosha e partnerëve, arsimi, vendlindja dhe vendbanimi, banesa dhe gjendja fizike e saj nëse ishin të punësuar apo të papunë. Një pjesë e rëndësishme me të dhëna mjaft të vlefshme për studimin ishte edhe çështja “Histori martesore” në të cilën shtjellohet në mënyrë të detajuar e gjithë historia e martesës së çiftit duke filluar që nga viti në të cilin ishte kryer martesa, si është realizuar ajo me mblesëri apo dashuri, sa fëmijë ka çifti dhe mosha e secilit prej tyre. Në këtë çështje trajtohet gjithashtu edhe historia e marrëdhënieve ndërmjet partnerëve, duke filluar që mbas

martësës, si kanë rrjedhur ato, kur kanë filluar problemet e para, si ka vazhduar marrëdhënia deri në divorc.

Për mbledhjen e këtyre të dhënave u përdor kodifikimi i tyre dhe ndërtimi i tabelave. Nëpërmjet analizës tematike u bë segmentimi, kategorizimi, përmbledhja e të dhënave dhe interpretimi i tyre.

3.3.1. Realizimi i intervistave të drejtëpërdrejta

Studimi kishte arritur në fazën e realizimit të intervistave por, për të kryer këtë gjë paraprakisht, duheshin ndërtuar disa pyetje mbi të cilat do të mbështetej puna ime si hulumtuese. Ndërtimi i këtyre pyetjeve ndihmoi në hartimin e udhëzuesit të intervistës gjysmë të strukturuar. Udhëzuesi i intervistës nuk është thjeshtë një listë pyetjesh, por më shumë një program pune i intervistës, me shënime dhe karakteristika të tjera në ndihmë të hulumtuesit (Mathewus, B. Ross, L. 2010, f. 227). Udhëzuesi i intervistës u përdor në intervistat e drejtëpërdrejta dhe në grupet e fokusit me pak ndryshime të cilat lidheshin me specifikën e qëllimit të këtyre grupeve.

Procesi i intervistimit ishte një nga fazat më të rëndësishme dhe më delikate të realizimit të studimit. Gjatë realizimit të saj u përqëndrova më tepër në disa aspekte për të cilat mendova se ishin thelbësore për realizimin me sukses të intervistës pasi çështja që trajtohej ishte paksa delikate.

Së pari, u dhashë mundësi të intervistuarve të përgjigjeshin sipas mënyrës së tyre dhe me fjalët e tyre gjatë dhënies së përgjigjes.

Së dyti, eksplorimi i çështjeve u bë bashkarisht me të intervistuarin.

Së treti, i nxita pjesëmarrësit që të shprehnin lirshëm opinionet e tyre, mendimet dhe ndjenjat.

Së katërti, intervistat ishin fleksibile në përshtatje me secilin pjesëmarrës.

Së pesti, me secilin pjesëmarrës u diskutuan të njëjtat aspekte të temës së studimit.

Në procesin e intervistimit u përfshinë 40 persona të divorcuar. Të gjitha intervistat i kam realizuar vetë në mënyrë të drejtëpërdrejtë. Një pjesë e tyre janë realizuar në Forumin të Gruas Elbasan, një pjesë tjetër pranë Zyrës së psikologut të gjykatës, një pjesë e vogël intervistash janë realizuar në bar-kafe. Disa nga intervistat u regjistruan sigurisht me dijeninë dhe miratimin e të intervistuarve, të tjerat u mbajtën shënim në mënyrë të hollësishme. Secila nga intervistat zgjati mesatarisht 45-50 minuta. Intervistat e regjistruara zgjatnin më pak në kohë krahasuar me intervistat që u realizuar duke mbajtur shënime. Me të gjithë të intervistuarit krijova marrëdhënie besueshmërie dhe konfidencialiteti më qëllim që ata të ishin të lirshëm gjatë procesit të intervistimit. Me secilin prej tyre u bë një bisedë paraprake njohjeje dhe më pas u realizua intervisa.

3.3.2. Realizimi i grupeve të fokusit

Për këtë studim u realizuan dy grupe fokusi të ndarë në dy grupmosha të ndryshme. Pjesëmarrëset e të dy grupeve ishin anëtare të Forumit të Gruas Elbasan. Përzgjedhja e tyre ishte e qëllimshme për të arritur njërin objektiv të studimit. Grupi i parë kishte në përbërje të vet gra nga mosha 30 deri në 40 vjeç, ndërsa grupi i dytë përbëhej nga gra mbi 45 vjeç deri

deri në 55 vjeç. Kriter për përzgjedhjen e këtyre dy grupeve ishte koha në të cilën ishte bërë martesa. Në grupin e parë martesa ishte bërë pas viteve 90-të ndërsa në grupin e dytë martesa ishte bërë para viteve 90-të. Në të dyja grupet pjesëmarrësit vinin nga zona të ndryshme të qarkut si dhe kishin nivele të ndryshme arsimore.

Grupi i parë kishte në përbërje të vet 11 gra të cilat vinin nga zonat rurale dhe urbane. Ato kishin nivele të ndryshme arsimore duke filluar nga ato që nuk e kishin mbaruar arsimin e detyrueshëm dhe deri tek ato që kishin kryer arsimin e lartë. Të gjitha këto gra ishin anëtare të FGE, ishin pjesë e grave të dhunuara nga bashkëshortët e tyre. Ato ishin martuar përgjatë 15 viteve të fundit.

Grupi i dytë i fokusit kishte 10 gra në përbërjen e tij. Edhe ky grup kishte larmishmëri përsa i përket nivelit arsimor por edhe zonave nga vinte secila prej tyre. Specifika e veçantë e këtij grupi ishte se martesa e tyre ishte realizuar para viteve 90-të. Edhe anëtarët e këtij grupi ishin pjesë e grave të dhunuara, pra ishin të antarësuar pranë FGE.

Të dhënat e nxjerra gjatë realizimit të grupeve të fokusit u mbajtën shënim në mënyrë shumë të kujdesshme dhe të veçanta për secilin grup.

3.4. Strategjia e përpunimit të të dhënave

3.4.1. Ndërtimi i udhëzuesit gjysmë të strukturuar

Ndërtimi i udhëzuesit të intervistës u përbë nga 7 pika kryesore dhe secila prej tyre kishte një grup pyetjesh të hapura specifike për të. Mëqenëse intervista ishte gjysmë e strukturuar dhe ecuria e saj varej nga përgjigjet e dhëna tek disa të intervistuar nuk u përdorën

të gjitha pyetjet e udhëzuesit. Në disa raste gjatë përgjigjes së pyetjes së parë ata jepnin përgjigje edhe për pyetjen në vazhdim dhe kështu nuk ishte nevoja të bëhej ajo pyetje pasi e kisha marrë përgjigjen që më duhej tashmë. Në disa raste të tjera i intervistuari përgjigjej shumë shkurt dhe më duhej të drejtoja edhe një pyetje shtesë për të marrë informacionin e nevojshëm. Pra jo në të gjitha rastet u respektua me përpikmëri udhëzuesi i intervistës që unë kisha parapërgatitur. Në udhëzuesin e intervistës të realizuar me grupet e fokusit u integrua edhe një pjesë e veçantë me pyetje të cilat kishin një specifikë të veçantë dhunën në familje dhe ndryshimin e mendësisë përsa i përket denoncimit të saj.

Të shtata pikat përbërëse të udhëzuesit kishin synimet specifike përmes të cilave u mbledh një larmishmëri të dhënash të nevojshme dhe të domosdoshme për studimin.

Në pjesën e parë u synua të merren informacione mbi moshë, vendlindjen, vendbanimin, me kë jetonte, arsimin që kishte kryer, profesionin, nëse ishte apo jo i punësuar, punën që kryente, prej sa kohësh ishte i/e divorcuar.

Në pjesën e dytë e cila kishte të bënte me të dhëna mbi martesën dhe partnerin u synua që të merreshin informacione rreth moshës së martesës për të dy partnerët, mbi mënyrën se si ishte realizuar martesa dashuri apo mblesësri, nëse kishin bashkëjetuar para martese apo jo, si kishin jetuar mbas martesës me prindërit apo të ndarë më vetë, a kishin fëmijë, ndryshimet që kishte pësuar martesa pas ardhjes në jetë të tyre.

Në pjesën e tretë qëllimi kryesor ishte të eksplorohej se si kishin filluar problemet në marrëdhëniet e çiftit, lidhja e problemeve me emigracionin, koha e qëndrimit të partnerit në emigracion, arsyet e emigrimit, arsyet e mosrealizimit të një emigrimi familjar.

Në pjesën e katërt u synua të evidentoheshin ndryshimet që kishte sjellë emigracioni në marrëdhëniet martesore në aspektin social, kulturor dhe ekonomik, si kishin ndryshuar këto marrëdhënie dhe në cilat aspekte kryesore, ndikimi që ka pasur emigracioni në këto marrëdhënie për të dy bashkëshortët.

Në pjesën e pestë u pa e arsyeshme të hulumtohej rreth shkaqeve që i nxitën këta partnerë për të bërë kërkesë-padinë për divorc, pse divorci ishte i domosdoshëm, a i kishin menduar pasojat sociale, ekonomike edhe psikologjike për vete dhe për fëmijët e tyre.

Në pjesën e gjashtë u synua marrja e informacionit lidhur me periudhën pas divorcit, si e kishin përjetuar divorcin partnerët dhe fëmijët e tyre, a ishte përmirësuar apo përkeqësuar gjendja e tyre sociale, psikologjike dhe ekonomike.

Në pjesën e shtatë u hulumtua rreth mendimit dhe gjykimit të pjesëmarrësve në lidhje me impaktin negativ të emigracionit apo të jetesës së ndarë të partnerëve për shkak të emigracionit, në ndryshimin e sjelljes së këtyre të fundit gjë e cila mund të çojë një martesë në divorc, masat që duhet të merren për të frenuar emigracionin dhe ndikimi që do të kishte ky fakt në qëndrueshmërinë e martesës për shumë çifte me partnerë në emigracion, apo mundësinë për një emigrim familjar gjë e cila do të anashkalonte shumë probleme të cilat vijnë nga jetesa e ndarë e partnerëve. Synimi kryesor i kësaj pjese kishte të bënte me evidentimin, rëndësinë e ndërmarrjes nga ana e institucioneve shtetërore, të politikave social-ekonomike mbi punësimin si mundësi për të frenuar emigracionin masiv të shqiptarëve dhe rrjedhimisht kjo gjë do të shoqërohej me më pak probleme sociale në familje dhe më pak divorce gjithashtu.

3. 4. 2. Zbardhja e të dhënave të mbledhura nga intervistat dhe fokus-grupet

Disa nga intervistat u regjistruan gjatë realizimit, po kështu u veprua edhe për grupet e fokusit. Pas regjistrimit u bë edhe zbardhja e secilës intervistë dhe grup fokusi. Çdo intervistë kërkonte rreth 3-3.5 orë për t'u zbardhur, ndërsa çdo orë e regjistruar nga grupet e fokusit kërkonte 3.5-4.5 për t'u zbardhur. Zbardhja e materialeve të regjistruara dhe informacioni i nxjerrë prej tyre u ruajt në mënyrë konfidenciale.

3. 4. 3. Përpunimi dhe analiza e të dhënave

Puna me të dhënat cilësore të marra nga intervistat dhe grupet e fokusit filloi duke bërë etiketimin dhe më pas kategorizimin e tyre. U bë shumë kujdes për sa i përket këtij procesi që me realizimin e intervistave të para. Menjëherë pas përfundimit të tyre u bë zbardhja dhe përpunimi i të dhënave nëpërmjet analizës tematike me qëllim që të kuptohej se ku çalonte puna me intervistat, apo nëse ishin marrë të gjitha informacionet e duhura, pra të dhënat e plota. Kjo u bë për të parë nëse kishte mangësi te këto intervista të korrigjoheshin në intervistat pasuese me qëllim që të dhënat e marra nga intervistat të ishin sa më të plota.

Analizimi i të dhënave sipar metodës së analizës tematike u realizua përmes stadeve të mëposhtëme

Së pari u lexuan raportet përmbledhëse të secilës interviste për të krijuar një ide të përgjithëshme lidhur me përmbajtjen e intervistave.

Së dyti u përcaktuan tematikat specifike nëpërmjet leximit të hollësishëm të raporteve të intervistave

Së treti u realizua skema e kodimit e cila përmbante kodet përkatëse për secilën tematikë, më pas nënkodet.

Së katërti kodet dhe nënkodet u shënuan afër paragrafëve të caktuar

Së pesti secila pjesë e koduar është shkëputur gjatë realizimit të raportit përfundimtar dhe është vendosur pranë kodit kryesor.

KAPITULLI IV: ANALIZA

Ashtu siç e kemi përmendur dhe më lart, në këtë studim janë trajtuar si të dhëna të papërpunuara 600 dosje të zgjidhjeve martesore të realizuara pranë gjykatës Elbasan, gjatë periudhës kohore 2008-2014. Gjatë analizimit të këtyre dosjeve u mbledhën të dhëna të bollshme dhe të larmishme lidhur me problemin e divorcit. Nga analiza e të dhënave, dolën në pah një sërë shkaqesh të cilat ndikonin në martesë, duke e çuar këtë të fundit në divorc. Më poshtë trajtohen dhe analizohen gjithashtu edhe intervistat, grupet e fokusit, që u kryen në funksion të studimit.

4.1. Shkaqet e divorceve në Shqipëri

Për të gjetur dhe analizuar shkaqet që kanë ndikuar në rritjen e numrit të divorceve në Shqipëri, u jam referuar të dhënave që kam marrë në Gjykatë pranë Zyrës së psikologut. Jo pa qëllim kam marrë të dhëna nga kjo zyrë, pasi të gjithë çiftet që bëjnë kërkesë për divorc në gjykatë, zhvillojnë seanca ndërmjetësimi me psikologun. Në këto seanca ata paraqesin historinë e tyre martesore si dhe shkaqet që i kanë nxitur për divorc. Të dhëna mbi shkaqet e divorcit janë vjelë gjithashtu nga intervistat dhe grupet e fokusit ku pjesëmarrësit i kanë paraqitur vetë ato. Këtu kemi një ndërthurje të dhënash zyrtare dhe nga pjesëmarrësit në studim.

Nga analiza e këtyre të dhënave dalin një sërë shkaqesh që ndikojnë në mosfunksionimin e një marrëdhënie në çift. Sigurisht, këto martesë nuk janë problematike si rezultat i një shkakut të vetëm, pasi një shkak i vetëm nuk e rrezikon martesën. Nëse në një martesë kemi një kombinim të disa shkaqeve, të cilat bëhen pengesë për funksionimin normal

të saj, atëherë kjo e fundit vërtet rrezikon të shkojë drejt divorcit. Vlen të theksohet që problemet në çift fillojnë me disa mosmarrëveshje të vogla të cilat kapërcehen nga partnerët në hapat e parë të martesës. Me kalimin e kohës, këto probleme fillojnë të agravohen, deri sa vjen një fazë, kur çifti gjendet përpara një situatë ku konfliktet janë të vazhdueshme.

Një situatë e tillë, bën që bashkëshortët të mos gjejnë më një gjuhë të përbashkët për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të cilat thellojnë gjithnjë e më shumë hendekun e krijuar në marrëdhëniet e tyre. Ajo që vihet re gjatë analizimit të të dhënave si nga shqyrtimi i dosjeve por edhe nga intervistat është fakti që kryesisht të dy partnerët në fillimet e martesës mundohen t'i kapërcejnë problemet që kanë ndërmjet tyre, duke i anashkaluar ato. Ndërsa në një kohë të mëvonshme, kur martesa i ka kaluar disa vjet, partnerët shprehen se nuk u kanë kushtuar rëndësi problemeve në çift, sepse kanë dashur ta ruajnë martesën, për hir të fëmijëve, për të mos u krijuar probleme dhe shqetësime atyre. Me kalimin e kohës, vjen një moment, kur partnerët nuk e durojnë më gjendjen në të cilën ndodhet marrëdhënia e tyre dhe bëjnë kërkesën për divorc. Nga të dhënat rezulton se divorci ka ardhur kryesisht mbasi njëri nga partnerët është larguar nga banesa, duke marrë fëmijët me vete ose duke ia lënë partnerit. Një situatë e tillë ka vazhduar për një periudhë disa muajore deri në dy vjet. Gjatë analizës të bie në sy është fakti që bashkëshortët nuk presin gjatë për të bërë divorc nëse bashkëshortja është larguar nga banesa. Në rastet kur është larguar bashkëshortja nga shtëpia, kryesisht mbas disa muajsh, bashkëshorti i drejtohet gjykatës për të bërë divorc. Ndërsa në rastet kur janë larguar bashkëshortët, gratë kanë pritur 1-2 vjet para se të bëjnë kërkesën për divorc. Gratë duket se janë më të duruara dhe e marrin më me vonesë vendimin për të bërë divorc. Ato shprehen se kanë pritur gjatë, me shpresën se partneri po rikthehet sërish në banesë për

të vazhduar jetën bashkëshortore. Nga rastet e studiuara asnjëherë nuk kemi të bëjmë me çifte të cilat divorcohen me probleme të momentit. Me këtë fakt nënkuptojmë që bashkëshortët nuk e dëshirojnë divorcin dhe këtë hap e ndërmarrin pasi marrëdhënia e tyre në çift nuk funksionon, edhe pse janë përpjekur për një kohë të gjatë ta ruajnë këtë martesë.

4.1.1. Ftohja e marrëdhënieve bashkëshortore si shkak për divorc.

Ashtu siç e kemi përmendur edhe më lart kemi të bëjmë me disa shkaqe të cilat të kombinuara së bashku shkatërrojnë një martesë duke e çuar në divorc. Shkaqet që ndeshen më shpesh gjatë analizës së të dhënave po i parashtrojmë në vijim.

Ftohja e marrëdhënieve bashkëshortore është një shkak që ndeshet në rreth 58 përqind e rasteve të studiuara. Ftohja ka ardhur për disa arsye ku emigracioni përmendet në pothuajse të gjitha çiftet të cilët kanë pasur njërën nga partnerët në emigracion, kryesisht burrin. Partnerët kanë pasur një jetesë të ndarë për një kohë të gjatë, si rezultat i emigracionit. Gratë kanë qëndruar me fëmijët në Shqipëri, ndërsa burrat, për shkak të kushteve të vështira ekonomike dhe papunësisë që shoqëroi tranzicionin e tejzgjatur në vend, i janë drejtuar emigracionit, si mundësia e vetme për të siguruar të ardhura. Qëndrimi për një kohë të gjatë larg njëri-tjetrit ka bërë që partnerët të mos ndiejnë më afrimetet ndërmjet tyre dhe martesa të humbë kuptimin e saj.

4.1.2. Konfliktet e vazhdueshme ndërmjet bashkëshortëve

Nga analiza e të dhënave nga dosjet konfliktet ndërmjet bashkëshortëve kanë një peshë të rëndësishme në zgjidhjen e martesës. 53 përqind e rasteve të studiuara të divorceve kanë pasur si shkak, ndër shkaqe të tjera, konfliktet e vazhdueshme brenda çiftit. Shumë çifte, që kanë konflikte në marrëdhëniet e tyre shprehen se mosmarrëveshjet kanë qenë të pranishme që në vitin e parë të martesës, por janë intensifikuar më tepër me ardhjen në jetë të fëmijëve. Ajo që të bie në sy nga analiza e të dhënave është fakti që arsyet e konflikteve të iniciuara nga burrat ndryshojnë nga arsyet e grave.

Burrat konfliktohen me gratë pasi ndihen si të lënë mbas dore prej tyre, sepse ato janë më të përkushtuara ndaj fëmijëve. Këtë gjë e pohojnë vetë disa nga burrat që kanë bërë kërkesë-padinë për divorc. Ata shprehen se gratë i kushtojnë më tepër rëndësi fëmijëve dhe nuk tregojnë interes për bashkëshortin. Në disa raste burrat ankohen se gratë janë neglizhente dhe nuk përmbushin detyrat e tyre si nëna dhe si gra.

Gratë konfliktohen me burrat e tyre kryesisht për arsye ekonomike. Konfliktet janë shtuar me lindjen e fëmijëve, sepse iu duhen më tepër para për të plotësuar nevojat familjare dhe gjendja ekonomike e familjes ka qenë e dobët. Në këtë rast janë gratë ato që bëhen nxitëse të konfliktit, pasi kërkojnë më tepër para për shpenzimet familjare.

Gjatë analizës së të dhënave del se konfliktet ndërmjet partnerëve vijnë edhe si rezultat i mospërputhjes së karakterit. Ky problem ndeshet më shpesh tek çiftet që kanë më pak se 5 vjet martesë, por që përbëjnë një numër të konsiderueshëm të të divorcuarve.

Pothuajse në të gjithë çiftet që janë divorcuar pas 2-3 vite martesë kanë si shkak kryesor të zgjidhjes martesore mospërputhjen e karakterit ndërmjet partnerëve. Ndër këto çifte, bashkëshortët akuzojnë gratë se janë të pabindura dhe nuk i respektojnë ata. Ndërsa kur kërkesa për divorc vjen nga gratë ato ankohen se bashkëshortët nuk i përfshijnë ato në vendimmarrje. Edhe kur mundohen të diskutojnë për problemet familjare shpesh nuk janë asnjëherë në një mendje gjë e cila krijon konflikte të vazhdueshme mes tyre.

4.1.3. Tradhëtia bashkëshortore dhe pasojat e saj në martesë.

Një nga shkaqet për divorc që e ndeshim shpesh gjatë analizës së të dhënave të dosjeve është dhe tradhëtia bashkëshortore. Nga të dhënat e marra gjatë analizimit të dosjeve, na rezulton se rreth 45 përqind e rasteve të studiuara të divorceve kanë paraqitur si shkak ndër të tjerë tradhëtinë bashkëshortore. Ky shkak ndeshet më shumë tek çiftet që kanë njërin nga partnerët në emigracion. Partneri që është në emigracion ka krijuar lidhje të re atje, duke i shkëputur lidhjet me familjen që ka lënë në Shqipëri. Edhe pse ka emigruar për të siguruar të ardhura për familjen, ai nuk interesohet më për të. Në njërin nga dosjet gjejmë të thëna nga një grua këto fjalë:

“Martesa jonë thuajse nuk ekziston më. Bashkëshorti im ka 6 vjet që jeton në Angli. Iku se nuk kishte punë. Atje ka punuar dhe fillimisht na sillte edhe ne para, mua dhe fëmijëve, ndërsa 2 vitet e fundit sillte gjithnjë e më pak. Ka 1 vit që nuk bëhet i gjallë, nuk flet më në telefon as me fëmijët. Edhe vetë e pashë që nuk kishte kuptim të prisja kështu gjithë jetën dhe vendosa të ndahem prej tij”.

Kemi edhe raste, kur gratë të cilat kanë qëndruar për një kohë të gjatë vetëm, kanë krijuar lidhje të reja, duke u divorcuar nga bashkëshortët e tyre. Raste të tilla janë shumë të kufizuara në numër krahasuar me burrat. Në çiftet e divorcuara për shkak të tradhëtisë bashkëshortore ka edhe raste kur të dy bashkëshortët kanë qenë në emigracion, siç ka edhe raste kur të dy bashkëshortët kanë qenë në Shqipëri. Shkak i tradhëtisë bashkëshortore jo domosdoshmërisht është i lidhur me emigracionin. Në disa nga dosjet problemi i tradhëtisë bashkëshortore mundohet të “maskohet” paksa duke mos u shprehur haptazi sidomos kur tradhëtia është kryer nga gratë. Burrat në këto raste shprehen se gratë nuk janë korrekte me ta, ose nuk i respektojnë ata si bashkëshortë duke lënë të nënkuptohet se i kanë tradhëtuar.

Nga intervistat dalin të dhëna më të hollësishme rreth ndikimit të tradhëtisë bashkëshortore në jetëgjatësinë e martesës. Gjatë intervistave konstatohet se ajo është e përhapur tek të dyja palët por gratë janë më tepër tolerante dhe nuk bëjnë divorc vetëm për këtë problem. Ndërsa përsa u përket burrave, ata janë më të ndjeshëm në këtë pikë dhe nuk e tolerojnë. Të njëjtën gjë ka konstatuar edhe Beqja dhe Sokoli, (2000, f. 72). Edhe pse studimi i tyre është kryer para një dekade e gjysmë në shoqërinë tonë tradhëtia e burrave përgjithësisht tolerohet nga gratë ndërsa tradhëtia e grave nuk tolerohet nga burrat. Për të bërë divorc gratë kërkojnë më shumë se një shkak përveç tradhëtisë, ndërsa burrat nuk presin për shkaqe të tjera. Në momentin që e konstatojnë përgjithësisht ata kërkojnë divorc. Në një pjesë të madhe të intervistave me gratë e konstatojmë tradhëtinë e bashkëshortit ndërsa në intervistat e realizuara me burrat në katër raste është konstatuar ky shkak.

Ja se se çfarë pohon H. V. 44 vjeç njëri nga burrat e intervistuar me arsim të lartë, por që kishte 10 vjet që jetonte e punonte në Itali.

“Kisha vënë re që diçka nuk shkonte mirë në marrëdhënien tonë. Unë sapo kisha ardhur nga Italia ku kisha qëndruar për një vit dhe ish-gruaja ime më nxiste të ikja prapë me pretendimin se mos humbas vendin e punës. Shpesh mbyllej në banjo dhe fliste në telefon. Kjo gjë më bëri të dyshoj. Në mes të natës i erdhi një mesazh po mua më tha se kishin ngatërruar numër. Kur e lexova, kuptohej qartë që kishte lidhje intime me dikë tjetër. Vazhduan të vijnë edhe disa mesazhe të tjera nga po i njëjti numër telefoni. E pyeta se kush ishte por nuk më dha asnjë shpjegim. Nuk e durova këtë gjë dhe i dhashë fund martesës”.

Ndërsa B. L. 34 vjeç me arsim 8-vjeçar nga një fshat i Librazhdit, i papunë por që emigronte shpesh në Maqedoni, gjatë intervistës ka treguar se:

“Ish-gruaja ime nuk donte të jetonte me prindërit e mi dhe unë mora një shtëpi me qera, edhe pse ishim dobët nga ekonomia. Një i afërm më tha se kur unë isha në Maqedoni për të punuar në shtëpi vinte një burrë. Në fillim s’e besova, thashë do jetë ngatërruar me kunatin. Mbete pa punë dhe u ktheva më herët nga Maqedonia kur po ngjisja shkallët e pallatit, nga shtëpia ime del një burrë që s’e njihja. Kur e pyeta gruan më sajoi lloj-lloj historish për të më mbushur mendjen që e kishte kushëri të largët. E kuptova që më tradhëtonte me të dhe kur ia thashë këtë gjë pa e hapur fare gojën mori vajzën dhe u largua nga shtëpia. Kështu u ndava prej saj edhe pse më vinte keq për vajzën”.

Ndërsa I. H. 50 vjeç me arsim 8-vjeçar, emigrant prej 20 vitesh në Greqi tregon gjatë intervistës se shkak për të bërë divorcin ka qenë tradhëtia e bashkëshortes.

“Nëse do më kishin thënë të tjerët se gruaja më tradhëton, nuk do t’i kisha besuar pasi dhe kur e pashë vetë më sytë e mi nuk më besohej. U trondita shumë, se si një nënë e katër djemve të rritur, kishte arritur deri në atë pikë. Ne ishim bërë gjyshër, ajo nuk ishte ndonjë vajzë e re, dhe mund t’i prishej mendja. Jo unë që s’e falja dot, por as djemtë nuk ia falën për atë që kishte bërë. E ndava, edhe pse kisha 25 vjet që isha martuar me të, nuk mund ta toleroja. Gjithçka tjetër mund ta falja, por atë gjë jo. Tani s’e duan as djemtë, por duhet t’i kishte menduar mirë pasojat, para se ta bënte atë veprim”.

Në intervistën e realizuar me një emigrant në Itali, ai na tregon se si e kishte konstatuar tradhëtinë e bashkëshortes së tij nëpërmjet një dedektive private italiane. Gjithashtu ai tregon dhe arsyen se përse e kishte bërë një gjë të tillë.

“Dyshoja se ish-gruaja po më tradhëtonte pasi ishte shumë e ftohtë ndaj meje sikur unë të mos ekzistoj fare në atë shtëpi. Nuk i thashë asgjë për dyshimet sepse mendoja se mos e kisha gabim. Kontaktova me një dedektive private dhe ajo me solli fotot të cilat vërtetuan dyshimet e mia. Kur ia tregova, ajo u mundua të mohojë gjithçka por unë ndërkohë kisha filluar procedurat për divorc”.

Gjatë këtyre intervistave me burra vërejmë se ata kanë pasur tradhëtinë si shkak të vetëm për të bërë divorc. Ndërsa në intervistat me gratë përveç tradhëtisë së bashkëshortit ato paraqesin edhe pasojat që ka sjellë tradhëtia si në marrëdhëniet e çiftit por edhe në ekonominë e familjes. Përgjithësisht tradhëtia e bashkëshortit është shoqëruar me ftohje të marrëdhënieve në çift, dhunë ndaj bashkëshortes. Gjatë intervistës së realizuar me M. A. 27 vjeç me arsim të mesëm nga Gramshi prej saj është pohuar se:

“Mbas martesës emigruam në Greqi ku qëndruam për 3 vjet. Pastaj ish-bashkëshorti mua dhe vajzën na solli në Shqipëri ndërsa vetë qëndroi atje. Na la për të jetuar tek prindërit e mi pasi nuk kishim shtëpi tonën dhe as para për të paguar qeranë. Gjatë kësaj kohe na sillte para sa për t’u ushqyer, shumë pak. Kështu për rreth 2 vjet nuk erdhi asnjëherë të na takonte. Kur i kërkoja të kthehej e të na merrte me vete, ma mbyllte telefonin duke mos më kthyer asnjë përgjigje. Kohët e fundit, sa herë që flisja në telefon, do të ziheshim me të për këtë gjë derisa një ditë më tha që do bënte divorcin sepse nuk më donte më, prandaj më kishte sjellë këtu. Më vonë mora vesh se ai na kishte sjellë në Shqipëri pasi kishte pasur një lidhje tjetër atje”.

Një problem tjetër që ka shkaktuar tradhëtia është edhe varfëria në familje pasi burrat nuk kontribonin më ekonomikisht në familjet e tyre. Ky ka qënë një problem mjaft i ndjeshëm për gratë e intervistuarat. Ja se si shprehet L. D. nga Cërriku, një grua 40 vjeçare nënë e dy fëmijëve akoma minorenë, për gjendjen që ishte krijuar në familjen e saj para se të merrte vendimin për divorc.

“Ish-burri punonte si mekanik, fitonte shumë nga puna po të gjitha paratë shkonin tek dikush tjetër se në shtëpi sillte sa për të ngrënë. Kur i thosha se ku i ke paratë e punës me hakërrehej se nuk më jepte llogari mua. Kështu niste sherri mes nesh që në fillim ishte vetëm me fjalë, por më pas edhe më dhunonte fizikisht. Filloi të mos kthehej çdo natë në shtëpi por edhe kur kthehej sillej shumë keq me mua. Më pas një farë kohe nuk erdhi fare dhe as të na jepte më para për ushqim. Mora vesh se bashkëjetonte me një grua tjetër. Shkova e takova te puna dhe i thashë të kthehej në shtëpi se e prisnin fëmijët por ai m’u përgjigj se donte të ndahej prej meje dhe kështu vendosa të bëj divorcin, për çfarë ta prisja më”.

Ndërsa E. L. një grua 32 vjeç nga një fshat pranë Elbasanit gjatë intervistës tregon se si tradhëtia e bashkëshortit kishte shkatërruar martesën e saj edhe pse ajo ishte realizuar me dashuri.

“U martuam me dashuri por, me sa u duk, dashuria e tij për mua zgjati shumë pak sepse shumë shpejt u lidh me një tjetër, edhe pse ishim të martuar. Në fillim nuk doja ta besoja, më pas bëja sikur nuk e kuptoja, edhe pse në fakt e kisha parë me sytë e mi. Shpresoja se do ndahej prej saj. Një ditë e pashë ta zbriste nga makina, nuk durova më dhe bëra sherr me të dy. Që nga ajo ditë debatet ishin të shpeshta mes nesh. Kohët e fundit thuajse nuk komunikonim fare me njëri-tjetrin. Marrëdhënia jonë ishte ftohur

dhe nuk kishte kuptim të vazhdonim më kështu. I thashë se do ndahesha prej tij, por atij nuk i bëri fare përshtypje kjo gjë, mesa duket mezi po priste”.

Ndërsa Genta 30 vjeç nga një fshat i vogël pranë Elbasanit gjatë intervistës na tregon se si tradhëtia e kryer nga bashkëshorti kishte krijuar konflikte të vazhdueshme ndërmjet partnerëve të cilat shoqëroheshin me dhunë fizike të ushtruar nga bashkëshorti ndaj saj. Ja se çfarë pohon ajo për situatën e krijuar mes partnerit dhe saj para divorcit:

“Jetonim familjarisht në Greqi. Ai (ish-bashkëshorti) kishte 2 vjet që nuk interesohej fare për familjen. Edhe pse punonte nuk sillte asnjë lek në shtëpi. Kur i kërkoja llogari se ku i çonte paratë më shante, ofendonte madje kishte gati një vit që ushtronte dhe dhunë fizike ndaj meje. Gjendja ekonomike e familjes ishte shumë e keqe por akoma më keq ishin marrëdhëniet tona, saqë kohët e fundit thuajse nuk komunikonim fare më njëri-tjetrin. Një mbrëmje i mblodhi të gjitha rrobat dhe sendet e tij dhe u largua pa thënë asnjë fjalë. Më vonë mora vesh se po bashkëjetonte me një grua tjetër dhe atëherë e kuptova shkakun se përse nuk sillte para në shtëpi. Pastaj bëra divorcin sepse nuk kishte më kuptim të prisja se mbase një ditë do të kthehej në shtëpi”.

4.1.5. Veset e këqija dhe ështëirësitë ekonomike që kanë sjellë ato në familje

Gjendja e vështirë ekonomike është një shkak i ndeshur në një numër të konsiderueshëm rastesh. Të shprehura në përqindje mund të themi se 32 përqind e rasteve të

studiara të divorceve kanë si shkak ndër të tjerë vështirësitë ekonomike. Ky shkak nuk vjen vetëm nga papunësia dhe kushtet e vështira ekonomike në të cilat ndodhet ekonomia e vendit tonë, por lidhet edhe me probleme të tjera sociale. Probleme të rënda ekonomike në familje shkaktohen nga vese të tilla si lojërat e fatit, bixhozi, alkooli etj., të cilat jo vetëm rëndojnë ekonominë e familjes por shpesh bëhen shkas për divorcin e çiftit. Veset e këqija si shkak për divorc janë konstatuar gjithashtu dhe nga Amato & Priveti, (2003 f. 622). Gratë ankohen se bashkëshortët e tyre i shpërdorojnë të ardhurat e familjes në lojëra fati duke e lënë këtë të fundit në kushte të mjerueshme. Raste të tilla ndeshen shpesh gjatë studimit jo vetëm me burra që nuk punojnë, por edhe me burra që punojnë, por që të ardhurat e tyre i shpërdorojnë në bixhoz duke mos kontribuar ekonomikisht në familjet e tyre.

Ajo që konstatohet nga intervistat është se burrat shfaqin vese të këqija, ndërsa gratë ankohen për veset e burrave të tyre dhe pasojat me të cilat shoqërohen ato. Gratë e divorcuara kanë përmendur gjatë intervistës disa vese të bashkëshortëve të tyre. Përdorimi i alkoolit nga bashkëshorti është përmendur më shumë në intervistat e zhvilluara si dhe në grupet e fokusit. Po mjaft herë është përmendur edhe bixhozi si një ves që ka dëmtuar rëndë ekonominë e familjes. Në vetëm dy nga intervistat është përmendur përdorimi i substancave narkotike nga bashkëshorti. Përveçse shfaqin vese të këqija persona të tillë, sipas të intervistuarve kryesisht gra, janë edhe të dhunshëm në familje. Këto gra i janë drejtuar gjykatës për divorc pasi kanë qenë të detyruara nga rrethanat e vështira në të cilat ndodheshin. Në intervistat e mëposhtme janë trajtuar disa nga pasojat që kanë sjellë në jetën bashkëshortore dhe familjare shfaqja e veseve të këqija nga bashkëshortët.

M. B., 45 vjeç nga Gramshi me profesion mësuese është divorcuar mbas 8 vite martesë pasi ish-bashkëshorti luante bixhoz me rrogën e saj. Këtë ves, pohon ajo, e kishte shfaqur qëkur ishte kthyer nga Greqia sepse kishte mbetur pa punë. Ja si shprehet ajo për këtë gjë:

“Llotot e sportit i ishin bërë fiksim saqë unë mendoj se nuk ishte më në rregull nga mendja. Justifikohej se nuk gjente dot punë dhe gjithë ditën e kalonte duke vendosur skedina, e duke parë ndeshjet. Këtë gjë e bënte me paratë nga rroga ime. Kështu i shpenzonte pothuajse të gjitha paratë dhe pastaj për të ngrënë më duhej të merrja borxh tek prindërit e mi. Nuk donte të dinte se me çfarë do hanim e si do jetonim. Nëse nuk ia jepja rrogën, ma merrte me force dhe dhunë. Kohët e fundit ishte bërë shumë i dhunshëm edhe më fëmijët. Kështu nuk vazhdohet më, i thashë vetes, dhe iu drejtova gjykatës për të bërë divorcin. Shpëtuam prej tij, si unë edhe fëmijët e mi”.

Në intervistën e realizuar me A. C. një gra 40 vjeç nga Elbasani konstatova se veset e këqija si përdorimi i pijeve alkoolike dhe lojërat e fatit kishin shkatërruar biznesin, ekonominë e tyre familjare e më pas edhe martesën e çiftit. Gjatë intervistës ajo ka pohuar se:

“Kishim një biznes të vogël, me të cilin ishim punësuar të dy, e siguronim fitim. Me paratë që nxirrnim nga biznesi, blemë shtëpi të re dhe e pajisëm më tërë orënditë. Por ish-bashkëshorti filloi pijen, e më pas luante dhe bixhoz, ku linte gjithë paratë e fituara. Edhe pse i flisja se e kishte gabim, nuk donte t’ai dinte. Kështu biznesi

falimentoi, dhe ne ngelëm pa një lek. Ngaqë nuk kishte para, filloi të sillej shumë keq me mua. Vinte i dehur në shtëpi dhe më ofendonte me fjalë të rënda të cilat shpesh i dëgjonin dhe fëmijët. Vitin e fundit patëm shumë konflikte, pasi të dy ishim pa punë, dhe nga ekonomia ishim shumë dobët. Gjatë konflikteve filloi të vinte dorë mbi mua, dhe nuk donte të dinte se ishin dhe fëmijët të pranishëm. Fëmijët qanin të frikësuar, sa herë ndodhte kjo gjë. Për këtë arsye, unë u largova nga shtëpia dhe u vendosa bashkë me fëmijët në një shtëpi tjetër më qera, e më pas bëra divorcin”.

4.1.4. Bashkëshortë përdorues alkooli

Nga analiza e të dhënave na rezulton se në 90 përqind e rasteve të divorcit që kanë ardhur nga kërkesa e grave, akuzojnë burrat e tyre se janë përdorues alkooli. Bashkëshortët që janë përdorues alkooli, janë përgjithësisht të papunë. Në këtë kategori përfshihen ata që e kanë hunbur punën, sepse kanë qenë të varur ndaj pijes si dhe ata që nuk mund të gjejnë punë. Shumica e tyre shpërdorojnë të ardhurat e grave, pasi vetë nuk sigurojnë gjë. Bashkëshortë të tillë janë konfliktualë dhe të dhunshëm në familje. Në një gjendje të tillë në familje janë gratë ato që i vuajnë më shumë pasojat. Sipas pohimeve të tyre jetesa dhe marrëdhëniet ndërmjet partnerëve bëhen të padurueshme. Situata të tilla i detyrojnë shumë prej grave të bëjnë zgjidhje të martesës.

“Sa herë që burri kthehej i dehur në shtëpi fëmijët rrinin të strukur nga frika se po niste sherrin me mua” shprehet një nga paditëset. Ajo që të bie në sy është fakti se përdoruesit e alkoolit i dhunojnë bashkëshortet edhe në prani të fëmijëve të tyre. Nga analiza e të dhënave evidentohet dhuna në familje, dhuna ndaj gruas nga bashkëshorti i alkoolizuar. Ky është problemi më madhor që është evident pothuajse në të gjitha çiftet që kanë qenë pjesë e studimit. Bashkëshortët shqiptarë vazhdojnë të jenë të dhunshëm ndaj grave të tyre. Mbizotëron dhuna fizike por edhe në rastet ku nuk ka dhunë fizike gratë dhunohen psikologjikisht duke iu bërë presion në forma të ndryshme.

4.1.5. Dhuna fizike dhe psikologjike ndaj bashkëshortes

Në 99 përqind e rasteve të studiuara, gratë pohojnë se janë dhunuar fizikisht dhe psikologjikisht nga bashkëshortët e tyre. Dhuna përbën vërtet një problem shqetësues për shoqërinë shqiptare. Ajo është gjerësisht e përhapur në marrëdhëniet bashkëshortore dhe shpesh bëhet shkak për divorc, sidomos kur kombinohet me problem të tjera. Pothuajse të gjitha shkaqet e divorcit të përmendura më lart kombinohen edhe me dhunë. Konfliktet në marrëdhëniet e çiftit përgjithësisht shoqërohen me dhunë të burrit ndaj gruas. Po kështu ndodh edhe në rastet e tradhëtisë bashkëshortore, kur burrat dhunojnë fizikisht gratë e tyre duke i akuzuar për tradhëti bashkëshortore. Në rastet kur gratë akuzojnë burrat për tradhëti, ata bëhen agresivë dhe dhunojnë gratë.

“Për çdo mosmarrëveshje që kisha me burrin ai do të më dhunonte, edhe kur i kërkoja të shkoja tek prindërit e mi do bënte njëherë sherr postaj do shkoja” shprehet një grua nga një zonë e thellë rurale.

Në 600 raste të trajtuara vetëm në 2 prej tyre burrat akuzojnë gruan se ka ushtruar dhunë ndaj tyre të ndihmuar edhe nga të afërmit. Nga intervistat me burrat nuk na rezulton asnjë rast i tillë. Pra përgjithësisht bashkëshortet janë viktimat të dhunës së ushtruar nga burrat.

4.1.6. Ndërhyrjet e prindërve të bashkëshortëve në marrëdhëniet e çiftit

Një shkak tjetër, i cili ndeshet më rrallë në krahasim me të parët është ndërhyrjet e prindërve të bashkëshortëve në marrëdhëniet brenda çiftit. Këto ndërhyrje shoqërohen në të shumtën e rasteve me konflikte si me prindërit po ashtu edhe ndërmjet partnerëve. Gjatë analizës së të dhënave rezulton se në 29 përqind e rasteve të përfshira në studim kanë pasur shkak për divorc, ndër shkaqe të tjera, konfliktet dhe mosmarrëveshjet që kanë kryesisht me vjehrrën. Rastet e konflikteve nuse-vjehrrë janë më të shumta se konfliktet dhëndër-vjehrrë. Konfliktet nuse-vjehrrë përbëjnë rreth 78 përqind të rasteve, ndërsa dhëndër-vjehrrë përbëjnë rreth 22 përqind të tyre. Këto ndërhyrje janë nxitëse për të krijuar konflikt ndërmjet bashkëshortëve. Nëse bëjmë një krahasim, prindërit e burrit, duke qenë më pranë çiftit, (kryesisht janë raste kur të dy palët jetojnë në një banesë) ndërhyjnë më tepër në jetën e tij në krahasim me prindërit e gruas. Ndërhyrje të tilla kanë qenë fatale për këto martesë, duke

i çuar ato drejt divorcit. Edhe pse nuk e kanë pasur një qëllim të tillë këto ndërhyrje dhe konfliktet që kanë ardhur si pasojë e tyre kanë qenë shkatërruese për çiftin.

Marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve ndikohen më së shumti edhe nga mjedisi familjar, marrëdhëniet që kanë anëtarët e tjerë të familjes (vjehera, vjeherri) me të cilët jetojnë. Përgjithësisht marrëdhëniet nuse-vjehrrë ndonjëherë janë kontradiktore, por sërish ato e gjejnë gjuhën e përbashkët. Në disa raste këto marrëdhënie janë aq problematike saqë ndikojnë edhe në marrëdhëniet e çiftit. Në disa nga intervistat me gra është pohuar se problemet në martesë kanë filluar pikërisht nga mosmarrëveshjet që kanë pasur me vjehrrën. Kryesisht këto çifte kanë jetuar me prindërit dhe ndërhyrja e tyre në marrëdhëniet e bashkëshortëve ka ndikuar në prishje të martesës. Ndërhyrjet e vjehrrës kanë krijuar konflikte jo vetëm ndërmjet saj dhe nuses, por edhe ndërmjet dy bashkëshortëve. Si pasojë e tyre janë ftohur marrëdhëniet në çift deri në atë pikë sa martesë është konsumuar dhe e ka humbur kuptimin e saj. Në intervistën e kryer me A. V. 35 vjeç, me arsim 8-vjeçar, nga një fshat i Gramshit, ajo tregon me detaje se përse kishte kërkuar të ndahej nga bashkëshorti me të cili kishte tre fëmijë. Në kohën që është realizuar intervista ajo sapo kishte përfunduar gjyqin e zgjidhjes së martesës. Ishte paksa konfuze kur jepte përgjigjet saqë herë-herë dukej sikur ishte penduar që kishte bërë kërkesën për divorc. Ja çfarë tregon ajo se përse u detyrua të ndahet nga bashkëshorti i saj.

“Asnjë ditë nuk isha e qetë prej vjehrrës, sepse ajo do ta gjente patjetët një shkak për të bërë sherr me mua. Unë e duroja në fillim, se më vinte zor nga burri po pastaj më humbi durimi sepse ai filloi të mbante anën e saj. Kështu sa herë zihesha me vjehrrën, zihesha edhe me burrin. Kjo gjë vazhdoi për disa vjet derisa unë nuk i fola më asaj.

Por nga ana tjetër marrëdhëniet me burrin nuk ishin më si më parë. Kishim konflikte të vazhdueshme pasi vjehrra i fliste keq për mua dhe ia dëgjonte shumë fjalën asaj. Gjendja u bë e padurueshme dhe një ditë mora fëmijët dhe u vendosa në shtëpinë e prindërve të mi. Ish-bashkëshorti m'u lut të kthehesha por nuk e bëra pasi nuk mund të jetoja më me atë që ma kishte nxirë jetën për 10 vjet duke dëgjuar nënën”.

Një tjetër e sapo divorcuar 26 vjeç me arsim të lartë, punonjëse në bankë, nga Elbasani nënë e një fëmije 2 vjeç gjatë intervistës ka pohuar se:

“Sa herë që kisha mosmarrëveshje me burrin, ndërhynte edhe vjehrra, për t'i mbajtur anën atij, megjithëse e dinte shumë mirë që unë kisha të drejtë. Kjo gjë më acaronte jashtë mase. Një ditë, në debat e sipër, i thashë të mbante vendin që i takonte, dhe të mos ndërhynte më në punët tona. Për këto fjalë më nxorrën të dy jashtë nga shtëpia. Unë mora vajzën dhe shkova tek prindërit e mi. Mbas disa ditësh, ish-bashkëshorti erdhi dhe më kërkoi të kthehesha në shtëpi, me kusht që t'i kërkoja të falur vjehrrës. Nuk mu duk e drejtë, se nuk kisha bërë ndonjë faj, kështu që nuk pranova. Përkundrazi do të kthehesha vetëm nëse vjehrra nuk do të jetonte me ne. Ai këtë gjë nuk e pranoi dhe kështu u ndamë”.

Ndërsa Engjëllushja një grua 36 vjeç, tregon se si ardhja e prindërve të bashkëshortëve për të jetuar së bashku nxiti konflikte mes bashkëshortëve pasi ndërhynin në marrëdhëniet e tyre. Ja se çfarë pohon Engjëllushja për këtë gjë:

“Sapo u martuam shkuam në Itali sepse ish-burri kishte 5 vjet që punonte dhe jetonte atje. Për gati 4 vjet shkonim shumë mirë me njëri-tjetrin. Martesa jonë u bë edhe më e lumtur kur lindën fëmijët por kur erdhën prindërit e tij për të jetuar me ne gjithçka ndryshoi. Ata filluan të ndërhynin në çdo gjë deri dhe në marrëdhëniet tona. Kjo gjë bëri që të lindnin debate e më pas konflikte të vazhdueshme mes nesh pasi dhe ai (ish-bashkëshorti) ua dëgjonte fjalën dhe mbante gjithmonë anën e tyre. Ne nuk po bënim më jetën e qetë që kishim deri në kohën kur erdhën prindërit në shtëpinë tonë dhe për këtë iu luta ish-burrit t’u gjenim një shtëpi tjetër atyre veç nesh, por ai nuk pranoi. Kështu u detyrova të marr fëmijët dhe të largohem prej tyre pasi nuk mund të jetoja më me ta”.

Njëri nga të intervistuarit burra na tregon se shkak për ftohje të marrëdhënieve bashkëshortore kanë qenë pikërisht ndërhyrjet e prindërve të ish-bashkëshortes. Si shkak i tyre çifti kishte mosmarrëveshje dhe konflikte të vazhdueshme të cilat kanë çuar në veçimin fizik të tyre e më pas në divorc. Gjatë intervistës N. C. ka pohuar se:

“Nuk na lanë të bënim jetë të qetë. Do të ndërhynin në gjithçka deri në atë pikë sa nuk mund të vendosja për asnjë gjë në lidhje me çështje të familjes pa i pyetur dhe ata. Nëse nuk i pyesja duhej të përgatitesha se do të kisha debat më vonë. Po më dukej vetja si i huaj në shtëpinë time pasi dhe ish-gruaja nuk tregonte asnjë shenjë respekti ndaj meje. Fjala e prindërve të saj ishte ligj për të. E pashë që nuk kishte kuptim të qëndroja më me të dhe bëra ndarjen”.

Valbona një grua 30 vjeç me arsim të lartë, punon si ekonomiste në një firmë private, e divorcuar para dy vjetësh gjatë intervistës tregon se si ndërhyrjet e prindërve të bashkëshortit në jetën e çiftit kishin krijuar mosmarrëveshje, konflikte të cilat më pas kishin qenë të dhunshme dhe këto kishin çuar në ftohje të marrëdhënieve ndërmjet bashkëshortëve. Ajo ka pohuar se:

“Prindërit e ish-bashkëshortit ndërhyjnë shumë në çështjet tona dhe ai vendoste për gjithçka që ata i sugjeronin pa më pyetur fare mua. Unë nuk e duroja dot këtë gjë dhe kështu lindën mosmarrëveshjet të cilat fillimisht ishin vetëm me fjalë, por më vonë u kthyen në konflikte të vazhdueshme. Vitin e fundit marrëdhëniet tona ishin ftohur dhe për këtë gjë unë i kërkoja të ndaheshim prej tyre dhe të përpiqeshim të dy për t'i rregulluar ato. Megjithatë iu luta shumë nuk pranoi e kështu unë mora djalin e ika nga shtëpia”.

4.2. Ekonomia një faktor kyç në rritjen e divorceve.

Edhe pse në pamje të parë duket paksa paradoksale, ekonomia e ulët e vendit ndikon në mënyrë të tërthortë, pra jo të drejtpërdrejtë në rritjen e divorcit. Ekonomia e dobët shfaq dukurinë e emigracionit ekonomik, për shkak të papunësisë, i cili nga ana tjetër shfaq probleme sociale që ndikojnë drejtëpërsëdrejti në rritjen e numrit të divorceve. Një ekonomi e dobët shfaq më së shumti probleme sociale, të cilat ndikojnë negativisht në marrëdhëniet ndërmjet partnerëve.

Dh. M. një grua 37 vjeçare, nga Elbasani, me arsim të mesëm, punonte si pastruese shtëpish. Ajo është nënë e dy vajzave të mitura dhe ishte divorcuar para 5 vjetësh nga bashkëshorti i saj me të cilin kishte qënë e martuar për 7 vjet. Divorci i saj ka ardhur si pasojë e papunësisë dhe gjendjes së vështirë ekonomike. Gjatë intervistës së saj ajo ka pohuar se:

“Unë e lashë punën se po merresha me rritjen e vajzës së vogël. Atij nuk i pëlqeu kjo gjë. Më pas nuk kishte qejf të shkonte në Greqi edhe pse pronari e merrte çdo ditë në telefon. Kur e pyeta se pse nuk nisej më tha se vetëm ai po punonte dhe unë rrija kot. Këtu nisën dhe problemet me ish-burrin. U grindëm gjatë atë ditë më e pas u nis për në Greqi. Gjatë kohës që ishte atje mori shumë rrallë në telefon. Kur u kthye pas disa muajsh kishte ndryshuar shumë. Marrëdhëniet tona nuk ishin si më parë, debatet dhe konfliktet ishin pothuajse të pranishme çdo ditë. Sa herë që i kërkoja para për nevoja të familjes thoshte se pse nuk punoja, se nuk më mbante ai mua dhe vajzat, por unë nuk pata më mundësi të gjeja punë, edhe pse kërkoja. Kjo situatë vazhdoi për 3 vjet derisa një ditë u largua për Greqi dhe nuk u kthye më në shtëpi. Unë bërë kërkesën për divorc, por ai nuk u paraqit asnjëherë në gjykatë”.

Po kështu shkak për konflikte ndërmjet partnerëve ka qënë gjendja e mjerueshme në të cilën ndodhej familja e P. C. nga Labinoti, një fshat pranë Elbasanit. Gjatë intervistës ajo ka treguar se si rezultat i gjendjes së vështirë ekonomike ish-bashkëshorti emigronte për disa muaj në Maqedoni por sillte shumë pak para dhe ato nuk mjaftonin as për ushqim sipas saj.

“Edhe pse shkonte në Maqedoni për të punuar ai nuk sillte para të mjaftueshme për të mbajtur familjen. Për këtë gjë kishim konflikte sepse fëmijët donin të hanin ndërsa ai me sa dukej nuk e kishte qejf punën. Shokët me të cilët punonte sillnin shumë para, ndërtuan edhe shtëpi, ndërsa ato që sillte ai nuk dilnin as për të ngrënë. Fillova të punoj tokën se nuk kishte zgjidhje tjetër. Pas kësaj ai priste që ta mbaja unë familjen me ato që prodhoja e shisja nga toka sepse ai as që mendohej të më ndihmonte dhe në Maqedoni nuk po shkonte më me preteksin që nuk gjente punë. Kështu përveç fëmijëve duhej të mbaja dhe burrin që ishte dembel e nuk punonte. Mirë fëmijët e kisha për detyrë, po burrin përse ta mbaja kur ishte mirë si kokrra e mollës dhe flinte gjumë gjithë ditën? Ai po jetonte si parazit në kurrizin tim. Kështu vendosa dhe u ndava prej tij”.

Mirela nga një fshat i Gramshit tregon për gjendjen e vështirë në të cilën kishte jetuar ajo së bashku me vajzën gjatë martsës si pasojë e varfërisë dhe mungesës së një banese të përshtatshme. Ja çfarë pohon ajo gjatë intervistës:

“Jetonin në një dhomë të vogël e cila për nga pamja i ngjante një kasolleje të vërtetë. Dhoma ishte e ftohtë dhe me lagështi dhe për këtë arsye vajza që ishte akoma bebe më shumë rrinte në spital se në shtëpi, ngaqë sëmurej shpesh. Ish-bashkëshorti iku në Greqi se nuk kishte punë por asnjëherë nuk solli para prej andej. Sa herë që i kërkoja para në telefon për t’i blerë ilaçe vajzës, më thoshte se nuk kishte pasi nuk gjente punë. Në këto rrethana prindërit më kërkuan të shkoja të jetoja me ta për t’u kujdesur

më mirë për vajzën. Dhe unë kështu bëra, por me sa duket ish-bashkëshortit nuk i pëlqeu kjo gjë dhe që prej asaj kohe nuk më mori më në telefon dhe as nuk u kthye më. Unë e prita për 2 vjet e më pas bëra divorcin”.

Shkaqe pothuajse të ngjashme për divorc paraqet edhe R. K. një burrë 40 vjeç më arsim 8-vjeçar nga Belshi. Gjatë intervistes së tij ai shprehet:

“Ajo (ish-bashkëshortja) kërkonte kushte shumë të mira për jetesë por unë nuk kisha mundësi t’i realizoja se isha pa punë. Kur shkoja në Greqi nuk është se gjeja punë gjithmonë se nuk kam një zanat por punoj punë të ndryshme ku të më dalë. Për këtë gjë ne kishim konflikte pasi ajo kërkonte para prej meje por vetë nuk e merrte mundimin të punonte. U largua nga shtëpia bashkë me fëmijët dhe u vendosën në shtëpinë e prindërve të saj. Edhe pse iu luta për disa muaj me radhë që të kthehej në shtëpi ajo nuk u kthye më. Unë bëra divorcin pastaj, se ajo nuk pranoi të jetonte më me mua”.

4. 2. 1. Gjendja ekonomike e çifteve para dhe pas divorcit

Divorci është një dukuri e të gjitha shoqërive, qofshin këto të pasura apo të varfra. Ai ndodh tek një çift si rezultat i kombinimit të faktorëve emocionalë, socialë dhe ekonomikë. Nga analiza e të dhënave të mbledhura nga intervistat dhe dosjet e zgjidhjeve të martesës

janë një mori faktorësh socialë, që e shkaktojnë divorcin, ku secili prej tyre ka ndikimin e tij. Krahas tyre, janë gjithashtu edhe disa faktorë ekonomikë, të cilët e vështirësojnë jetesën në çift. Vështirësitë ekonomike, mospasja e kushteve minimale për jetesë, krijojnë probleme në marrëdhëniet e partnerëve, sidomos kur çifti ka edhe fëmijë. Këtë gjë e vërejmë edhe në realitetin shqiptar. Gjendja e vështirë ekonomike në të cilën ndodhet vendi ynë, reflektohet më së miri në gjendjen ekonomike të familjeve tona. Nga të dhënat del se familjet shqiptare përballen më vështirësi të shumta ekonomike, të cilat i detyrojnë shumë prej tyre të emigrojnë në vende të tjera, për të pasur një jetesë më të mirë. Emigrimi i njërit partner apo i gjithë familjes, shpesh herë shoqërohet me probleme për këta të fundit. Probleme të tilla janë vendimtare për jetëgjatësinë e martesës, sepse kanë një ndikim shumë të madh në marrëdhëniet ndërmjet partnerëve. Vështirësitë ekonomike bëhen më të mëdha me lindjen e fëmijëve, pasi edhe kërkesat janë më të mëdha. Shumë çifte kalojnë krizë në marrëdhëniet e tyre, pikërisht gjatë kësaj faze, pasi fillojnë të mendojnë më seriozisht për mirëritjen e fëmijëve të tyre, gjë për të cilën kërkojnë një zgjidhje.

Shumica e prindërve mundohen duke bërë përpjekje maksimale për të siguruar një jetesë normale për fëmijët. Nga analiza e të dhënave qoftë nga intervistat por edhe nga dosjet del se ekziston edhe një kategori prindërisht, kryesisht burra, të cilët sillen në mënyrë të papërgjegjshme duke shpërdoruar të ardhurat ekonomike të familjes, duke e lënë këtë të fundit në gjendje të mjerueshme. Gratë të detyruara nga rrethanat kërkojnë divorc.

4.2.2. Gjendja ekonomike e çiftit pas martesës, gjatë periudhës që janë bërë më fëmijë, si dhe para divorcit.

Nga analiza e detajuar e të dhënave nga shqyrtimi i dosjeve të çifteve që kanë bërë divorc gjatë periudhës kohore 2008-2014 vërehen tri faza të rëndësishme gjatë martesës.

Faza e parë - Periudha pas martesës, viti i parë i saj.

Faza e dytë - Çifti është bërë me fëmijë dhe ata janë në rritje e sipër. Kërkesat përsa i përket anës financiare janë rritur së tepërmi gjatë kësaj faze.

Faza e tretë - Martesa e ka kaluar 10-vjeçarin e parë të saj.

Nga të dhënat del se gjatë *fazës së parë* të gjithë partnerët kanë qenë të lumtur. Ata e kanë ndjerë dashurinë dhe ngrohtësinë, në marrëdhëniet me partnerin. Asnjëri nga bashkëshortët, nuk tregon se ka përjetuar vështirësi ekonomike përgjatë kësaj periudhe. Gjatë kësaj faze, ata gëzojnë një respekt reciprok për njëri-tjetrin dhe harmoni ndërmjet tyre. Pjesa më e madhe e rasteve të studiuara, jetojnë me prindërit e bashkëshortit. Kështu problemet ekonomike zgjidhen kryesisht nga prindërit e tij, dhe në asnjë rast ata nuk përballen drejtpërdrejt me këtë çështje. Përgjithësisht marrëdhëniet në çift nuk kanë asnjë lloj problemi gjatë kësaj faze, sipas pohimeve të tyre. Problemet dalin në pah më vonë.

Gjatë *fazës së dytë*, sipas të dhënave jetesa në çift fillon të pësojë ndryshime të rëndësishme. Lindja e fëmijëve shënon një kthesë në jetën e çiftit. Nëse deri tani bashkëshortët ishin kujdesur për veten dhe njëri-tjetrin, gjatë kësaj faze u duhet të kujdesen

për pasardhësit e tyre, të cilët shpesh konsiderohen si më të rëndësishëm se partneri. Kjo gjë nxit pakënaqësi tek partneri tjetër. Ardhja në jetë e tyre, shton edhe kërkesat ndaj prindërve të rinj. Ata fillojnë të mendojnë për një banesë të përshtatshme, për t'u krijuar kushte sa më të mira jetese fëmijëve të tyre. Kjo gjë nuk i kishte shqetësuar deri tani. Jo të gjitha çiftet e reja i kanë mundësitë për t'i realizuar ato. Një faktori kyç i cili ndikon drejtëpërsëdrejti në realizimin e kërkesave të këtyre familjeve, është gjendja ekonomike në të cilën ndodhen ato.

Pjesë e krizës ekonomike që po përjeton rajoni është edhe vendi ynë. Shkalla e varfërisë në vend është e lartë, si shkak i papunësisë, e cila si dukuri prek kryesisht të rinjtë, pjesa më e madhe e të cilëve sapo kanë krijuar familjet e tyre. Si rezultat i kësaj gjendjeje ekonomike, shumë familje shohin emigracionin si mundësi për të siguruar jetesën e tyre. Nga të dhënat e INSTAT janë burrat ata që priren më tepër për të emigruar, por sipas piramidës së emigracionit 2001-2011 diferenca ndërmjet tyre dhe grave nuk është shumë e madhe (INSTAT, 2015). Emigracioni nuk është një rrugë e lehtë. Emigrantët shprehen se përballen me mjaft vështirësi për të siguruar punë, në këtë periudhë krize. Kështu përballë nevojave të mëdha që ka familja është gjendja e mjeruar ekonomike. Analiza e të dhënave tregon se nga mospasja, varfëria, partnerët fillojnë të kenë mosmarrëveshje me njëri-tjetrin, të cilat bëhen shkak për konflikte. Konfliktet e herëpashërëshme çojnë në ftohjen e marrëdhënieve në çift, duke e çuar këtë të fundit drejt divorcit. Të dhënave nga dosjet e divorcit, tregojnë se numri më i madh i divorceve ndodh pikërisht gjatë kësaj faze. Një gërshetim i problemeve ekonomike me ato sociale, bëhen shkak për dhënien fund të martesës. Kjo është faza më kritike në të cilën përpara partnerëve dalin shumë probleme për t'u zgjidhur, ku ato ekonomike zënë vendin kryesor. Sipas të dhënave familjet që kanë më pak stabilitet

ekonomik janë më të ekspozuara dhe më të rrezikuara ndaj divorcit. Këtë fakt e ka konstatuar edhe B. Jalovaara në studimin e saj mbi divorcin ku si për burrat po ashtu edhe për gratë veçorite socio-ekonomike kanë ndikim të rëndësishëm në stabilitetin e martesës. (Jalovaara, M. 2003, f.77).

Pjesa më e madhe e partnerëve janë të interesuar dhe përpiqen që të sigurojnë sa më shumë të ardhura për familjen e tyre. Gjithashtu ekziston edhe një kategori partnerësh të cilët nuk janë të prirur për ta bërë një gjë të tillë. Në shumë nga kërkesë-paditë për divorc të bëra nga gratë parashtrohet ndër shkaqe të tjera për divorc edhe papërgjegjshmëria në sjelljen e partnerit përsa i përket shpërdorimit të parave. Shpërdorimi i të ardhurave të familjes në lojëra fati është një fenomen i cili ndeshet shpesh dhe kryesisht janë burrat që e bëjnë këtë gjë. Nuk janë të pakta rastet kur mosmarrëveshjet dhe konfliktet që degjenerojnë deri në dhunë ndërmjet partnerëve e kanë zanafillën pikërisht nga ky problem. Një problem i tillë ka bërë që shumë martesa të shkojnë drejt divorcit.

“Jetesa u bë e papërballueshme, thuajse të gjitha paratë nga rroga e tij përfundonin në lloto, i është bërë ves dhe nuk pyet fare për ne të tjerët”. Këto fjalë i gjejmë në kërkesën për divorc të bërë nga M.L. nga Elbasani.

4.2.3. Gjendja ekonomike e çifteve që kanë shkuar në divorc.

Divorci është një dukuri që shkakton pasoja sociale, por edhe pasoja ekonomike. Nëse pasojat sociale i përjetojmë, me pasojat ekonomike përballemi çdo ditë. Ato janë më jetike dhe nuk mund të anashkalohen. Nuk është e lehtë t'i rrisësh fëmijët në ditët e sotme, edhe nëse të dy prindërit janë të punësuar dhe kontribuojnë të dy ekonomikisht për mirërritjen e tyre. Akoma më e vështirë është për prindërit e divorcuar, që janë të detyruar ta bëjnë të vetëm një detyrë të tillë. Nga të dhënat e mbledhura si nëpërmjet dosjeve por dhe nga intervistat, është shumë e vështirë për këtë kategori t'u sigurojnë kushte të mira për jetesë fëmijëve, sidomos kur nuk kanë një banesë për të jetuar, kur janë të papunë, apo kur prindi tjetër nuk kontribuon ekonomikisht. Shpesh janë prindërit e të divorcuarve, që u ofrojnë strehim dhe ndihmë, por kjo nuk mjafton. Shumë prindër të divorcuar zgjedhin një vend tjetër për t'u siguruar kushte më të mira jetese fëmijëve të tyre, pasi një gjë të tillë nuk e realizojnë në Shqipëri si pasojë e vështirësisë për t'u punësuar. Janë disa raste ndër dosjet e analizuara ku gratë pas ndarjes nga bashkëshorti kanë emigruar së bashku me fëmijët e tyre. Ato kryesisht janë ndihmuar nga të afërmit që janë emigrantë në atë vend për të gjetur një banesë të përshtatshme dhe punë.

Sipas të dhënave nga problemet që kanë me bashkëshortët e tyre shumë gra vendosin t'i japin fund martesës. Por sapo kryejnë divorcin para tyre dalin një sërë vështirësish të tjera të cilat kryesisht kanë lidhje me ekonominë. Një problem mjaft shqetësues është siguri i një banese të përshtatshme për veten dhe fëmijët, pasi pothuajse të gjitha gratë që kanë bërë

vetë kërkesën për divorc kanë marrë edhe fëmijët me vete. Në përmbajtje të dosjes ato tregojnë se ku janë duke jetuar mbas largimit nga banesa e bashkëshortit. Nuk janë të pakta rastet kur gratë pasi janë divorcuar nga bashkëshortët, janë rikthyer pranë prindërve të tyre, duke marrë me vete edhe fëmijët, pavarësisht kushteve ekonomike. Numrin më të madh të këtyre rasteve e përbëjnë gratë nga zonat rurale, ndërsa më të pakta janë rastet që vijnë nga zonat urbane. Nga analiza e të dhënave të dosjeve të studiuara del se 48 përqind grave mbas divorcit, rikthehen për të jetuar në banesën e prindërve të tyre, pasi nuk ka mundësi tjetër. Këto gra janë kryesisht të papuna ose marrin një pagë minimale, e cila nuk u jep mundësi për të paguar qeranë e shtëpisë. Ato shprehen se shtëpia ka hapësirë të mjaftueshme për të jetuar së bashku me fëmijët pasi kryesisht aty jetojnë vetëm prindërit e tyre.

Referuar analizës së të dhënave na rezulton se 44 përqind banojnë në shtëpi me qera. Përgjithësisht në këtë grup janë të përfshira gra të punësuara të cilat kanë të ardhura mesatare ose mbi mesatare. Kjo gjë u jep mundësi atyre për të paguar qeranë e shtëpisë, si dhe për të pasur jetesë normale. Vetëm 8 përqind e grave të divorcuara kanë një banesë në pronësi të tyre.

Duke iu referuar të dhënave për burrat në studim vëmë re se është më i ulët numri i tyre që jetojnë në banesën e prindërve të tyre. Këtu përfshihen ata që kanë jetuar gjithmonë me prindërit si dhe ata që mbas divorcit kanë shkuar të jetojnë me prindërit pasi kanë qenë të papunë dhe nuk kanë pasur mundësi të paguajnë qeranë e shtëpisë. Gjatë analizës së të dhënave na rezulton se 38 përqind jetojnë në banesën e prindërve të tyre pas divorcit. Pjesa më e madhe e tyre kanë jetuar me prindërit edhe para divorcit pasi nuk kanë një shtëpi në pronësi të tyre. Ndërsa 35 përqind mbas divorcit jetojnë në shtëpi me qera. Këtu përfshihen

ata që jetojnë në Shqipëri dhe ata që jetojnë në emigracion. Vetëm 27 përqind kanë në pronësi shtëpinë në të cilën jetojnë aktualisht. Nëse bëjmë një llogari të thjeshtë 35 përqind e të divorcuarve kanë në pronësi një shtëpi, ndërsa 65 përqind e çifteve para se të divorcoheshin nuk e kanë pasur një mundësi të tillë.


Të dhënat e mësipërme janë pasqyruar në tabelë dhe grafik.

Tab. 2.

Kategoria	Jetojnë në banesën e prindërve pas divorcit	Jetojnë në banesë me qera pas divorcit	Jetojnë në banesën e tyre pas divorcit
Gra	48%	44%	8%
Burra	38%	35%	27%

Të dhënat nga dosjet e divorceve 2011-2014. Gjykata Elbasan, Zyra e psikologut

Fig. 1.



Pothuajse të njëjtën problematikë ekonomike e konstatojmë edhe gjatë analizimit të të dhënave nga intervistat. Kur u pyetën pjesëmarrësit lidhur me gjendjen ekonomike që kishin pasur pas divorcit u pa se përgjigjet ndryshonin në varësi të shkaqeve që kishin çuar martesën në divorc. Në rastet kur divorci kishte ardhur si pasojë e shpërdorimit të parave nga bashkëshortët e varur nga pija, bixhozi, lëndët narkotike, të intervistuarit pohuan se ekonomia e tyre ishte përmirësuar. Në rastet e tjera ata pohuan se ekonomia familjare kishte pësuar rënie sidomos kur divorci kishte ardhur për shkak të konflikteve, gjë e cila kishte ndikuar dhe në mospagesën e pensionit që i kishte caktuar gjykata ish-bashkëshortit për rrijten e fëmijëve. Kështu barra i kishte rënë vetëm nënës. Në intervistat e realizuara me emigrantë nuk evidentohen probleme ekonomike pasi ata janë përgjithësisht të punësuar në vendet ku kanë emigruar. Probleme shumë të rënda ekonomike kanë gratë e papuna të cilat kryesisht jetojnë

me prindërit e tyre pas divorcit pasi nuk kanë mundësi të përballojnë jetesën dhe të paguajnë qeranë e shtëpisë. Këtë gjë e konstatojmë edhe gjatë intervistave.

Vera një e intervistuar të cilën e kemi përmendur dhe më lart përsa i përket këtij problemi do të shprehej:

“Mbas divorcit, unë dhe dy fëmijët u vendosëm tek shtëpia e prindërve të mi. Unë kam qenë gjithmonë e papunë, pasi s’kam mundur të gjej, por për fatin tonë të mirë prindërit janë në pension, dhe me të ardhurat e tyre po jetojmë dhe ne. Ish-bashkëshorti nuk u interesua më pas divorcit se si dhe me çfarë po jetojnë fëmijët e tij. Nuk paguan as pensionin që i caktoi gjykata për rritjen e tyre”.

Ndërsa Mirela për këtë çështje do të shprehej:

“Që pasi u largova nga ajo dhomë e shkatërruar që nuk kishte asnjë nga kushtet më minimale për jetesë kam jetuar tek shtëpia e prindërve. Ata kanë shumë tokë e po i ndihmoj dhe unë për ta punuar. Ne po mbahemi me prodhimet që shesim prej saj. Nuk është se nxjerrim ndonjë fitim të madh, por të paktën po bëjmë një jetë normale”.

Ndërsa A. V. me arsim 8-vjeçar, nga një fshat i Belshit tregon se ishte vendosur në shtëpinë e prindërve të saj pasi nuk kishte mundësi për të gjetur një shtëpi me qera. Në fshat është pothuajse e pamundur për të gjetur një të tillë. Ja se si shprehet ajo për këtë gjë:

“Tek prindërit po jetoj, edhe pse jemi pak ngushte, se aty jeton edhe vëllai me familjen e tij, po nuk kisha zgjidhje tjetër. Nuk jam e punësuar, por punoj tokën, dhe me ato që nxjerr prej saj, mbuloj shpenzimet e mia dhe të fëmijëve në atë shtëpi. Kam 5 dynymë të miat, se kur u nda toka, isha pa martuar dhe prandaj përfitova. Ish-burri nuk është intersuar ndonjëherë se me çfarë po jetojnë fëmijët”.

Në intervistën e realizuar me një emigrante të divorcuar para një viti doli në pah se mbas divorcit gjendja e saj ekonomike ishte përmirësuar. Më parë ish-bashkëshorti bixhozxi, siç e quan ajo, shpërdoronte pothuajse gjithë të ardhurat e familjes në lojëra fati. Ja se si shprehet ajo gjatë intervistës:

“Pas divorcit u rrit mirëqenia jonë, pasi të gjitha paratë nga puna që bëj i shpenzoj për vete e fëmijët, dhe jo në bixhoz. Si të them po ia ndiej lezetin, se dhe në punë shkoj me dëshirë tani. Në fund të fundit, po lodhem për vete e fëmijët”.

Ndërsa O. D. që e kemi përmendur dhe më lart për gjendjen ekonomike do të përgjigjej:

“Nuk mund të them as se është përmirësuar dhe as që është keqësuar. Që nga koha që iku në Gjermani çdo muaj sjell para për fëmijët se e di që unë jam pa punë. Për fëmijët ka menduar gjithmonë, s’kam ç’të them”.

Ndërsa O. L. nga Belshi për gjendjen ekonomike pas divorcit shprehet se:

“Pothuajse nuk ka ndryshuar asgjë në të ardhurat që marrim. Ne me ndihmë ekonomike kemi jetuar dhe po jetojme gjatë gjithë kohës. Ai (ish-bashkëshorti) asnjëherë nuk mendon për fëmijët dhe pse e di që unë jam e papunë”.

Njëra nga gratë e grupit të fokusit shprehet se bashkëshorti nuk komunikon me të as për çështje që kanë të bëjnë me fëmijët edhe pse ka të ardhura të mira. Sipas saj e mban mëri për denoncimin e dhunës së ushtruar prej tij në polici dhe për këtë gjë nuk interesohet as për fëmijët e tij. Për çështjen e ekonomisë pas divorcit ajo do të përgjigjej:

“Gjendja ekonomike pas divorcit u keqësua, se unë e kam rrogën të ulët, ndërsa ish-bashkëshorti nuk paguan pensionin që u caktoi gjykata fëmijëve. Më ndihmojnë prindërit e mi, se ndryshe nuk ia dal dot të paguaj qeranë e shtëpisë”.

Ndërsa një tjetër nga gratë e grupit të fokusit pohon se:

“Ish-bashkëshorti po vuan dënimin në burgun e Peqinit, prandaj nuk pres të paguajë gjë për rritjen e fëmijëve. I kam marrë parasysh vetë, po punoj, dhe po ia dal për bukuri”.

Përsa i përket gjendjes ekonomike pas divorcit L. V. të cilën e kemi përmendur edhe më lart shprehet se:

“Gjendja ekonomike është përmirësuar pasi paratë e rrogës i shpenzoj për vete e fëmijët dhe jo për të pirë, siç ndodhte me ish-bashkëshortin gjatë kohës që ishim të martuar”.

Një nga gratë gjatë grupit të fokusit për gjendjen ekonomike pas divorcit do të shprehej:

“Gjendja ekonomike është më e mirë se tani paratë e rrogës sime i kam vetë dhe nuk i harxhoj në lojëra fati siç bënte ish-bashkëshorti. Po bëjmë jetë normale me fëmijët”.

Pyetjes për gjendjen ekonomike pas divorcit Gerta të cilën e kemi cituar dhe më lart i është përgjigjur:

“Thuajse nuk ka ndryshuar asgjë ne (ajo bashkë me fëmijët) në kushte të mjerueshme ishim por dhe tani nuk mund të them që jemi mirë se me ndihmë ekonomike po jetojmë.”

Për këtë çështje M. A. nga Gramshi tregon se që nga koha që është kthyer nga Greqia ish-bashkëshorti nuk ka dhënë asnjë kontribut ekonomik për rritjen e vajzës edhe pse gjykata i ka caktuar të paguajë një pension çdo muaj. Sipas saj ai ka shkëputur çdo marrëdhënie me të dhe nuk është interesuar më as për vajzën.

Përsa i përket gjendjes ekonomike pas divorcit Teuta të cilën e kemi përmendur dhe më lart pohon se është më e ulët sepse vetëm ajo punon dhe se bashkëshorti nuk paguan për djemtë se nuk janë më minorenë. Ajo thotë se po bën një jetë të qetë me djemtë e saj gjë që i intereson më shumë se çdo gjë tjetër.

Ndërsa A. C. të cilën e kemi përmendur edhe më lart përsa i përket ekonomisë pas divorcit do të shprehej se:

“Ekonomia e familjes u përkeqësua që nga momenti që biznesi falimentoi, tani po jetojmë me para nga ndihma sociale. Janë shumë pak por s’kam çfarë të bëj. Jam duke kërkuar punë por është shumë e vështirë për të gjetur”.

Përgjithësisht gjatë intervistave vihet re se gratë e divorcuara nga fshati që kanë tokë në pronësi janë punësuar në bujqësi pasi merren me punimin dhe mbjelljen e saj. Ndërsa të tjerat jetojnë kryesisht me ndihmë ekonomike nga shteti.

Kur u është drejtuar burrave pyetja mbi gjendjen ekonomike pas divorcit ata përgjithësisht janë përgjigjur se nuk ka pasur ndonjë ndryshim. Pra për ta gjendja ekonomike ka vijuar të jetë e njëjtë si para dhe pas divorcit, ndryshe nga gratë një pjesë e madhe e të cilave kishin pasur probleme ekonomike sidomos ato që ishin të papunësuar.

4.2.4. Gjendja e punësimit ndër çiftet e divorcuara.

Duke iu referuar analizës së të dhënave 51 përqind e grave që kanë bërë divorc, rezultojnë të punësuar në sektorë të ndryshëm sipas shkallës së arsimimit dhe profesionit që ato kanë. 46 përqind e tyre janë të papuna. Në këtë kategori përfshihen gra të cilat nuk kanë një profesion të caktuar, si dhe gra të cilat nuk kanë punuar asnjëherë në jetën e tyre, pasi janë marrë me rritjen e fëmijëve, ose nuk kanë pasur mundësi për të gjetur një punë. Kjo gjë krijon një varësi ekonomike të këtyre grave ndaj burrave të tyre. Varësia ekonomike kthehet në një thikë me dy presa për faktin se kjo varësi bëhet shkas për ushtrim dhune nga partneri, dhe në të njëjtën kohë e pengon atë të rebelohet apo të largohet kur ushtrohet dhunë e vazhdueshme mbi të (Aleanca Gjimore për Zhvillim, 2008). Vetëm 3 përqind e tyre trajtohen me asistencë ose me pension invalidi. Gratë e punësuar janë më të prirura për të kërkuar

divorc nëse kanë probleme me partnerin e tyre, pasi ndihen më të pavarura. Pavarësia ekonomike i bën ato më të vendosura, për të marrë një vendim të tillë. Të njëjtin fakt kanë konstatuar edhe Vignoli & Ferro në studimin e tyre të kryer në Itali (Vignoli & Ferro. 2009, f. 27). Numri i kërkesave për divorc të bëra nga gratë, është më i lartë se i burrave. Nga të dhënat e dosjeve rezulton se pjesa më e madhe e këtyre grave janë të punësuar, prandaj rezulton një përqindje më e lartë e grave të punësuar. Këtu mund të sqarojmë se realisht në Shqipëri numri i grave të punësuar është më i ulët krahasuar me numrin e burrave. Pra, këto shifra nuk tregojnë gjendjen reale të punësimit në vend të grave. Sipas staistikave të INSTAT për vitin 2014 shkalla e punësimit të femrave është 43.4 përqind ndërsa ajo e meshkujve është 58 përqind (INSTAT, 2015).


Nga të dhënat e dosjeve të çifteve që kanë kërkuar divorc, burra të punësuar rezultojnë 45 përqind ku pjesa më e madhe janë emigrantë, pra janë të punësuar në një vend tjetër. Një numër i kufizuar burrash rezultojnë të punësuar në vend, ku pjesën kryesore e përbëjnë të punësuarit në ndërtim. Vetëpunësimi në biznesin e tyre vjen i dyti në radhë pas ndërtimit dhe një pjesë e vogël janë të punësuar në sektorë të tjerë. Burra të papunë janë 48 përqind. Pjesa më e madhe e tyre janë emigrantë sezonalë të cilët emigrojnë gjatë sezonit të verës, pasi vetëm gjatë kësaj periudhe ka mundësi të gjejnë punë. Në këtë kategori përfshihen persona të cilët nuk kanë një profesion të caktuar, pasi nuk janë të arsimuar. Ata punojnë kryesisht në bujqësi. Vetëm 7 përqind trajtohen me ndihmë ekonomike nga shteti ose pension invalidi.

Tab. 3.

Kategoria	Të punësuar	Të papunë	Asistensë/pens.invalidi
Gra	51%	46%	3%
Burra	45%	48%	7%

Të dhënat nga dosjet e divorceve 2008-2014. Gjykata Elbasan. Zyra e psikologut

Fig. 2.



Faza e tretë është periudha kur martesë e ka kaluar 10-vjeçarët e saj. Numri i divorcesve gjatë kësaj periudhe është më i ulët krahasuar me 10-vjeçarët e parë. Çiftet u kanë dhënë zgjidhje disa problemeve imediate, që kanë të bëjnë kryesisht me banesën dhe punësimin. Partnerët që janë punësuar në vend e kanë ndërtuar jetën e tyre dhe të familjes së tyre këtu, ndërsa ata që nuk e kanë pasur një mundësi të tillë kanë emigruar. Jetesa në emigracion nuk ka qenë e lehtë për këto çiftet. Ato janë përballur me një sërë problemesh, përfshirë këtu edhe jetesën larg partnerit. Çiftet me partner në emigracion, i kanë zgjidhur në një farë mënyre problemet ekonomike. Ato kanë më tepër probleme sociale, të karakterit ftohje të marrëdhënieve në çift, apo tradhëti bashkëshortore, të cilat lidhen kryesisht me mënyrën e jetesës së tyre. Numrin më të madh të divorcesve gjatë kësaj faze të martesës, e përbëjnë kryesisht ato kategori çiftesh, ku njëri nga partnerët, përgjithësisht burri ka emigruar për arsye ekonomike dhe ka qëndruar për shume vjet larg partnerit dhe familjes. Nga të dhënat e studimit, në shumë çiftet që kanë bërë kërkesën për divorc, problemet kanë filluar kur partneri në emigracion ka bërë bashkim familjar, duke tërhequr edhe familjen. Jetesa e ndarë për një kohë të gjatë, ka bërë që partnerët të shfaqin vështirësi si dhe mosmarrëveshje në marrëdhëniet e tyre gjatë bashkimit. Secili prej tyre është mësuar me mënyrën e tij të jetesës, e cila krijon vështirësi në përshtatje, sidomos për çiftet në të cilat burri ka qëndruar gjatë gjithë kohës së martesës në emigracion dhe është kthyer pranë familjes vetëm në raste festash. Shumë gra të këtij grupi social janë rikthyer në Shqipëri, duke bërë kërkesën për divorc, pasi marrëdhëniet e tyre bashkëshortore nuk ka funksionuar.

4.3. Divorci në Shqipëri dhe problematika që mbart ai.

Divorci një problem sa aktual po edhe aq shqetësues për shoqërinë tonë. Themi se divorci është aktual pasi raste të reja të tij ndeshim çdo ditë në realitetin, shqiptar të cilit i përkasim. Shumë çifte të reja shkojnë drejt divorcit, por jo vetëm, sepse edhe çifte që kanë disa vjet martesë, e përfetojnë një situatë të tillë. Referuar të dhënave nga studimi i dosjeve por edhe nga intervistat, grupet e fokusit divorci vjen nga problemet që ka pasur çifti në marrëdhëniet e tyre. Këto probleme shkaktohen nga faktorë të jashtëm, që veprojnë në mënyre indirekte në marrëdhëniet e çiftit, këtu mund të përmendim diferenca në moshën e partnerëve, niveli arsimor, janë pjesë e zonave urbane apo rurale, kushtet sociale dhe ekonomike të çiftit, jetesë më vete e çiftit apo me prindërit e tyre. Ndërsa përsa u përket faktorë të brendshëm, kanë të bëjnë me mënyrën se si është kryer martesë, me dashuri apo mblesëri, a ka qenë e mjaftueshme shkalla e njohjes që ata kanë pasur për njëri-tjetrin para se të martoheshin, gjendja emocionale të tyre me ndjenjat afeksioni që kanë ata për njëri-tjetrin, jetesa që ka pasur çifti gjatë martesës.

Divorci është një dukuri me ndikim negativ në shoqëri, i cili godet në ditët e sotme shumë familje shqiptare. Numri i divorceve ka ardhur në rritje, dhe këtë gjë mund ta shpjegojmë si një emancipim të shoqërisë, apo si një krisje të familjes. Rritja e numrit të divorceve, gjithashtu reflekton se shoqëria shqiptare ka probleme. Si një shoqëri post komuniste me një tranzicion të tejzgatur, e varfër ekonomikisht dhe papunësi të lartë, problemet sociale në vend janë shtuar. Si pasojë e tyre, janë shtuar edhe problemet në familje, si pjesë e shoqërisë e cila nuk mund të shihet si e shkëputur prej saj. Në këtë krizë të cilën po përfeton familja shqiptare, kanë pasur ndikim të veçantë, si faktorë jashtë saj por edhe faktorë

brenda saj. Një kombinim i tillë, e bën familjen që të përjetojë situatë krize të pakëndshme. Kjo gjë nuk është e mirë për asnjë nga anëtarët e saj. Në kërkesë-padinë për divorc, secili partner është i pakënaqur nga partneri tjetër, duke e akuzuar si shkaktar të gjendjes në të cilën ndodhet marrëdhënia e tyre.

Divorci nuk mund të ndodhë si një rrufe në qiell të hapur. Sigurisht, marrëdhënia ndërmjet partnerëve në një çift ka kaluar në disa faza, derisa një ditë ata kanë vendosur të ndahen. Askush nuk i drejtohet gjykatës për të bërë divorc pa pasur arsye shumë të forta, sidomos kur gjatë martesës ka edhe pasardhës. Fëmijët janë ata që e përjetojnë më tepër divorcin, prandaj partnerët prindër e mendojnë më së miri para se të ndërmarrin një hap të tillë. Edhe në rastet kur partneri ka braktisur strehën familjare, ai nuk i ka ndërprerë lidhjet me fëmijët e tij, pavarësisht se ata kanë qëndruar me prindin tjetër. Ekziston edhe një kategori bashkëshortësh, të cilët mbasi janë veçuar nga partneret e tyre, nuk kanë treguar me interes për fëmijët.

4.3.1. Faktorë që kanë ndikuar në divorc.

Faktorët mund t'i klasifikojmë si faktorë të jashtëm dhe faktore të brendshëm.

Gjatë analizimit të të dhënave të marra nga dosjet e partnerëve që e kanë bërë vetë kërkesën për divorc, konstatova këto gjetje të cilat po i parashtoj më poshtë.

Kur dy persona krijojnë një lidhje me njëri-tjetrin, diferenca moshore, ndryshimet përsa i përket nivelit arsimor nuk merren parasysh, ashtu siç nuk merret parasysh edhe kushtet sociale dhe ekonomike në të cilat ndodhen. Gjithashtu ata nuk marrin parasysh nëse partneri është nga zonat rurale apo urbane. Nëse ata e pëlqejnë njëri-tjetrin, ka afeksion ndërmjet tyre, kjo lidhje kurorëzohet me martesë. Në vitet e para martesa shkon shumë mire, partnerët shprehen se ishin shumë të lumtur në marrëdhënien e tyre. Me kalimin e kohës fillojnë të dalin edhe problemet e para, sidomos me ardhjen në jetë të fëmijëve. Gjatë kësaj periudhe, bashkëshortët ndihen si të lënë mbas dore, sepse bashkëshortja, si nënë e re, duhet të përkujdeset më tepër për fëmijën. Nga ana tjetër, kur një anëtar i ri është shtuar, familjes i nevojitet më tepër para për të plotësuar nevojat e saj. Kjo gjë nuk përbën problem për bashkëshortët që janë të punësuar, por nëse janë të papunë, atëherë kemi të bëjmë me një problem vërtet serioz, sidomos për vendin tonë me një ekonomi të dobët dhe me papunësi të lartë. Vështirësia për të gjetur një punë, shtohet më tepër nëse partnerët nuk e kanë kryer arsimin e mesëm. Këtu fillojnë edhe problemet në marrëdhëniet e partnerëve. Vështirësitë ekonomike me të cilat përballlet familja, reflektohen edhe në marrëdhëniet e çiftit. Fillojnë të lindin mosmarrëveshjet e para, kontadikta ndërmjet partnerëve. E ndodhur në një situatë të tillë, ku nevojat janë shtuar dhe të ardhura nuk ka, kjo tip familje, sheh si mundësi të vetme, për të zgjidhur problemet e saj ekonomike, emigracionin. Në të shumtën e rasteve janë burrat ata që emigrojnë, por nuk janë të pakta rastet kur emigron e gjithë familja. Në rastet kur emigron vetëm burri, vërtet problemet ekonomike zgjidhen pasi ai tani punon dhe siguron të ardhura, por nga ana tjetër çifti detyrohet të bëjë një jetë të ndarë. Jetesa larg njëri-tjetrit bën që afriteti ndërmjet partnerëve të zbehet, marrëdhëniet e tyre fillon të ftohet dhe me kalimin e kohës, ata fillojnë të ndihen si të huaj për njëri-tjetrin. Kështu partnerët fillojnë të krijojnë

lidhje të reja, qoftë ata në emigracion, apo edhe ata në Shqipëri. Kështu pas disa viteve martesës i vjen fundi. Bashkëshortët i drejtohen gjykatës për të bërë divorcin.


Gjatë analizës së të dhënave nga dosjet e divorcit del se martesë është më e rrezikuar në 10-vjeçarin e parë të saj. Rreth 56 përqind e rasteve të studiuara të divorcit kanë pasur një martesë që ka zgjatur 1-10 vjet. 23 përqind e rasteve të studiuara kanë qenë të martuar prej 11-15 vjet. 21 përqind e rasteve të studiuara i janë drejtuar gjykatës për divorc mbas më tepër se 16 vjet martesë. Këto të dhëna janë paraqitur më poshtë në tabelë dhe më pas grafikisht.

Tab. 4.

Vjet martese	1-5	6-10	11-15	Mbi 16
% e divorceve	10%	46%	23%	21%

Dosjet e zgjidhjeve martesore 2008-2014. Zyra e psikologut. Gjykata Elbasan.

Fig. 3.



4. 3. 2. Shkalla e arsimimit tek partnerët e divorcuar dhe diferenca moshore

Gjatë mbjedhje së të dhënave nga dosjet e kërkesë-padive u mbajt shënim niveli arsimor i secilit partner. Në studim u përfshinë të dhëna mbi nivelin arsimor të të divorcuarve si dhe moshën e partnerëve për të parë diferencën moshore ndërmjet tyre. Gjithashtu janë marrë të dhëna demografike për të parë shpërndarjen e dukurisë së divorcit në zonat urbane

dhe ato rurale. Synimi kryesor këtu ishte për të parë ndikimin e arsimit tek mundësia për të bërë divorc. Një qëllim tjetër ishte për të krahasuar diferencat në nivelin arsimor ndërmjet partnerëve dhe ndikimin që kanë ato në martesë. Në analizën e të dhënave vërejmë se numrin më të lartë të të divorcuarve e përbëjnë partnerët të cilët kanë kryer ose jo vetëm arsimin e detyrueshëm 8-vjeçar. Ndërsa partnerët që kanë kryer arsimin e lartë janë më të pakët në numër krahasuar me ata që kanë kryer arsimin 8-vjeçar dhe të mesëm. Të njëjtin fakt kanë konstatuar edhe Salvini & Vignoli të cituar në kapitullin II. Sipas tyre arsimi i lartë mund të çojë në një marrëdhënie më të qëndrueshme për shkak të përputhjes së suksesshme të partnerëve (Salvini & Vignoli, 2011, f.164).

Gjatë analizimit të të dhënave del se rreth 60 përqind e të divorcuarve nuk e kanë kryer arsimin e mesëm. Kategoria e këtyre personave përbën pjesën më të madhe të të divorcuarve. Ky grup social, ka më tepër probleme ekonomike, për faktin se ka vështirësi për të siguruar punë. Mospasja e një profesioni të caktuar zvogëlon mundësinë për të siguruar një punë të qëndrueshme. Pjesa më e madhe e tyre janë emigrantë, këtu përfshihen si rastet kur ka emigruar vetëm partneri, edhe rastet kur ka emigruar e gjithë familja.

Nga të dhënat del se 36 përqind e të divorcuarve e kanë kryer arsimin e mesëm. Pjesa dërrmuese e tyre e kanë një punë të qëndrueshme nëpërmjet së cilës sigurojnë të ardhura të mjaftueshme për jetesë. Vetëm 6 përqind e të divorcuarve kanë kryer arsimin e lartë. Pjesëtarët e këtij grupi rezultojnë të gjithë të punësuar dhe një pjesë e vogël e tyre janë emigrantë sipas të dhënave. Kjo tregon se arsimi i lartë i kryer nga partnerët rrit stabilitetin në martesë, referuar numrit të ulët të divorceve të kryer nga kjo kategori çiftesh.

Në një krahasim që u është bërë të dhënave për arsimin ndërmjet partnerëve vërejmë se rreth 80 përqind e të divorcuarve kanë të njëjtën shkallë arsimimi me partnerin, dhe vetëm 20 përqind e të divorcuarve partnerët kanë diferenca në shkallën e arsimimit.


Të dhënat mbi arsimin e partnerëve që kanë bërë divorc janë paraqitur në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm.

Tab. 5.

Arsimi	Pa arsim të mesëm	Me arsim të mesëm	Me arsim të lartë
Të dhëna %	60%	36%	6%

Dosjet e zgjidhjeve martesore 2008-2014. Zyra e psikologut. Gjykata Elbasan.

Fig. 4.



Nëse do të krahasojmë ndryshimet moshore ndërmjet partnerëve ajo që të bie në sy është fakti se çiftet kanë një diferencë moshe mesatarisht prej 5 vjetësh me një luhatje +2,-2. Martesat janë kryer përgjithësisht me arfërsi moshore ndërmjet partnerëve. Janë shumë të pakta rastet gati të papërfillshme kur çiftet kanë diferenca shumë të mëdha moshe ndërmjet tyre mbi 10 vjet. Këto raste janë kryesisht partnerë që kanë pasur martesë tjetër më parë. Kjo diferencë nuk përbën problem për martesën sepse partnerët janë në shumicë pothuajse moshatarë. Në asnjërin nga rastet e divorcit të marra në shqyrtim nuk është përmendur diferenca moshore si shkaktare të problemeve në marrëdhëniet e bashkëshortëve.

4.3.3. Zona në të cilat divorcet janë më të shpeshta

Gjatë analizës së të dhënave u vu re që divorcet kanë një përhapje më të gjërë në zonat urbane në krahasim me ato rurale. Në një krahasim të të dhënave nga zonat rurale me ato urbane, vura re se rreth 64 përqind e të divorcuarve i përkasin zonave urbane dhe rreth 36 përqind e të divorcuarve i përkasin zonave rurale edhe pse pjesa më e madhe e popullsisë së qarkut të Elbasanit rreth 67 përqind e saj sipas (INSTAT 2015) jeton në këto zona. Të divorcuarit nga zonat rurale janë më të paktë në numër. Pjesa më e madhe e të divorcuarve të cilët nuk e kanë kryer arsimin e mesëm i përket kësaj kategorie. Edhe këto çifte shfaqin të njëjtën problematikë në marrëdhëniet e tyre ku dominojnë konflikti, dhuna dhe ftohja e marrëdhënieve. Numri i grave që kanë bërë kërkesën për divorc nga zonat rurale është më i ulët në krahasim me burrat. Shumica e grave në zonat rurale janë shtëpiake. Ato kujdesen për pronat e tyre familjare dhe punojnë kryesisht në bujqësi. Nga kjo punë ato sigurojnë shumë pak të ardhura. Burrat janë kryesisht emigrantë pasi në zonat rurale është puthuajse e pamundur për të siguruar një punë. Rrjedhimisht edhe problemet që kanë çuar në divorc këto çifte, janë të lidhura kryesisht me emigracionin.

4.4. Faktorët e brendshëm që ndikojnë në divorc

Çdo martesë mund të jetë e rrezikuar nga divorci përgjatë kohës që ajo është ekzistente. Rreziku për divorc mund të lidhet me shumë faktorë të cilët e gërryejnë martesën nga brenda por dhe nga jashtë. Një martesë ishte e rrezikuar nga faktorë të

brendshëm që lidheshin në mënyrë të drejtëpërdrejtë me partnerët dhe faktorët e jashtëm të cilët ishin jo të drejtëpërdrejtë por nuk ishin më pak të rëndësishëm për sa i përket impaktit të tyre në jetëgjatësinë e martesës.

Së pari mbarëvajtja e një martese lidhet më së shumti me mënyrën se si janë të ndërtuara marrëdhëniet ndërmjet partnerëve. Referuar analizës së të dhënave, nëse këto marrëdhënie karakterizohen nga sinqeriteti reciprok afeksioni dhe dashuria ndërmjet tyre atëherë mund të themi se martesa është konsoliduar dhe jetëgjatësia e saj është e sigurtë. Në rastet kur kemi mungesë të këtyre elementëve në një martesë, jetëgjatësia e saj nuk është e sigurtë.

Së dyti jetëgjatësia e martesës lidhet dhe me mundësitë ekonomike të saj, kushtet në të cilat jetojnë partnerët dhe familja e tyre. Sioas të dhënave nëse ato janë normale (me këtë gjë nënkuptojmë sigurimin e kushteve normale për jetesë) martesa do vazhdojë të ekzistojë. Në rastet kur mungojnë kushtet më minimale për jetesë si pasojë e mospërpjekjeve nga ana e partnerëve për t'i siguruar ato, jetëgjatësia e saj vihet në pikëpyetje. Këtë gjë e kemi konstatuar edhe në intervistat me partnerë të divorcuar. Gjatë realizimit të intervistave dalin në pah problemet që ka pasur martesa e tyre. Këto probleme janë të ndikuara nga faktorë brenda dhe jashtë saj. Për të analizuar saktë këta faktorë janë marrë të dhëna nëse ka qenë e mjaftueshme shkalla e njohjes që kanë pasur partnerët për njëri-tjetrin para se të martoheshin. Po kështu janë mbledhur të dhëna mbi gjendjen emocionale të tyre, me ndjenjat, afeksionin që kanë ata për njëri-tjetrin, si dhe jeta që ka pasur çifti gjatë martesës. Në marrëdhëniet ndërmjet partnerëve një rol të rëndësishëm luajnë dhe sinqeriteti ndërmjet e tyre dhe

besimi që kanë ata tek partneri. Mosbesimi tek partneri shumë herë nxit mosmarrëveshje dhe konflikte ndërmjet tyre. Si rezultat i xhelozisë marrëdhënia në çift bëhet e padurueshme shprehen disa nga të intervistuarit. Rasti më tipik ishte ai i M. V. 25 vjeçe nga një fshat i Librazhdit që sapo ishte divorcuar kur u zhvillua intervista. Ajo ishte martuar para tre vjetësh me një djalë që e kishte njohur vetë. Por për shkak të mosbesimit që kishte bashkëshorti ndaj saj çifti kishte pasur një martesë problematike. Më poshtë trajtohen dhe analizohen intervistat e kryera në funksion të studimit.

Ja se si e tregon marrëdhënien me partnerin M. V. gjatë intervistës së realizuar me të:

“Në fejesë ai bëhej ndonjëherë xheloz dhe mua më pëlqente se më dukej se më donte shumë. Mbasi u martuam ai çdo ditë po bëhej më shumë xheloz. Në fillin më pyeste për gjithëçka, ku isha, çfarë bëra, më kë fola, pastaj fillonte më kërkonte llogari për gjithëçka kisha bërë, dhe për gjërat që nuk i pëlqenin më ofendonte. Shumë shpesh debatonim pasi unë nuk guxoja të dilja nga shtëpia vetëm, edhe nëse më duhej të blija ndonjë gjë te dyqani i lagjes. Nëse e merrte vesh se kisha dalë pa i thënë, ai do bënte sherr. U bë shumë xheloz dhe i dhunshëm. Çdo ditë po më dukej vetja si e burgosur. Nuk guxoja të kërkoja asgjë nga frika se mund të më rrihte. Nuk po duroja dot më. Mora djalin dhe ika në shtëpinë e prindërve. U thashë se si e kisha hallin dhe se do ndahesha prej tij. Prindërit më mbështetën dhe e bëra divorcin. Nuk them se jam e lumtur tani se halle kam boll, po të paktën nuk rroj me frikë”.

Gjatë realizimit të grupeve të fokusit me gratë e dhunuara kam konstatuar xhelozinë dhe mosbesimin nga bashkëshorti si shkak për të ushtruar dhunë ndaj bashkëshortes, gjë e cila më pas ka sjellë dhe divorcin e partnerëve. Ja se çfarë pohon njëra nga gratë gjatë grupit të fokusit:

“Asnjëherë nuk pati besim tek unë. Ishte shumë xheloz dhe për këtë arsye thuajse nuk dilja fare nga shtëpia. Edhe kur dilja me të gjatë gjithë kohës do grindeshim pasi ai bëhej xheloz pa shkak. Kohët e fundit si pasojë e xhelozisë u bë i dhunshëm dhe nëse më parë bënim vetëm fjalë tani kishim konflikte gjatë së cilave ushtronte dhunë fizike ndaj meje. Konflikte të tilla ishin shumë të shpeshta dhe prandaj vendosa t’i jap fund martesës”.

Edhe një tjetër grua gjatë grupit të fokusit ka përmendur xhelozinë e bashkëshortit si shkak për dhunimin e saj fillimisht psikologjikisht e më pas edhe fizikisht.

“Bëhej xheloz për gjëra pa vlerë e më pas nuk më fliste për ditë të tëra edhe pse unë tentoja t’ia argumentoja se e kishte gabim. Me kalimin e kohës kjo po i bëhej si sëmundje pasi ishte gjithnjë e më tepër xheloz dhe kjo gjë po më shqetësonte jashtë mase, nuk ndihesha e qetë as në punë e as në shtëpi. Fillova të reagoj pasi ndihesha e fyer nga akuzat e pavërteta që më bëheshin dhe kështu krijoheshin konflikte që po bëheshin edhe të dhunshme. Ai po më dhunonte fizikisht sa herë që unë kundërshtoja

për ato që thoshte ai. Kështu marrëdhëniet tona u ftohën si rezultat i mosbesimit nga ana e tij deri në atë pikë sa që martesat nuk kishte më kuptim”.

4.4.1. Si janë realizuar martesat që kanë shkuar në divorc?

Nga analiza e të dhënave të studimit të dosjeve vërejmë se martesat e realizuara me mblesëri, apo njohja nëpërmjet një personi të tretë, janë në një numër më të lartë krahasuar me martesat e kryera me dashuri. Rreth 52 përqind e këtyre martesave, janë kryer me mblesëri, pra bashkëshortët janë njohur nëpërmjet një pale të tretë, dhe 48 përqind të tyre janë bërë me dashuri, pra me pëlqimin reciprok të partnerëve. Në rastet kur martesat është bërë me mblesëri, çifti ka pasur një periudhë njohjeje, e cila ka qenë e mjaftueshme, sipas pohimeve të partnerëve. Në asnjë rast nuk rezulton të thuhet nga partnerët se martesat ka qenë e menjëherëshme. Kurorëzimi ka ardhur mbas pëlqimit dhe miratimit të tyre. Nuk konstatohet asnjë rast kur bashkëshortët të jenë martuar pa dëshirën e tyre. Në rastet e martesave me dashuri, kurorëzimi ka ardhur si rezultat i dashurisë dhe afeksionit që kanë pasur partnerët për njëri-tjetrin. Pra në të dyja rastet martesat janë kryer në mënyrë krejt normale ku primare ka qenë pëlqimi reciprok i partnerëve për njëri-tjetrin. Në të dyja rastet martesat ka pasur një rrjedhë normale vitet e para. Problemet ndërmjet partnerëve kanë lindur gradualisht me kalimin e viteve për shkaqe dhe arsye të ndryshme të cilat më pas i kanë detyruar ata t'i japin fund martesës.

4.5. Ndikimi i emigracionit në marrëdhëniet bashkëshortore

Emigracioni u pa si mundësia e vetme për të siguruar jetesën e tyre nga shumë shqiptarë. Vështirësitë ekonomike kanë bërë që shumë partnerë të emigrojnë dhe kështu të jetojnë larg njeri-tjetrit. Gjatë analizës së të dhënave nga dosjet gratë me bashkëshortë emigrantë tregojnë arsyet se përse nuk kanë emigruar dhe ato me bashkëshortin e tyre. Sipas tyre fillimisht bashkëshortët emigronin në mënyre ilegale si pasojë e mungesës së lejeve të qëndrimit. Ata, duke emigruar ilegalisht, nuk kishin mundësi të merrnin me vete familjet e tyre. Kështu bashkëshortja dhe fëmijët qëndronin në Shqipëri. Mungesa e lejeve të qëndrimit në vendet ku kishin emigruar i detyronte këta partnerë të qëndronin për një kohë shumë të gjatë pa u kthyer. Ata vinin pranë familjeve të tyre në Shqipëri vetëm në raste festash dhe qëndronin pak ditë. Ky qëndrim kaq i shkurtër pranë familjes ndodhte për faktin se ishin të punësuar në vendet ku kishin emigruar dhe rrezikonin të humbisnin vendet e punës nëse nuk ktheheshin në kohë atje. Por nga ana tjetër kjo mungesë e tejzgjatur e partnerit emigrant, e shoqëruar edhe me problem të tjera familjare të cilat i mbeteshin për t'i zgjidhur përgjithësisht gruas, ka çuar në thellimin e ftohjes së marrëdhënieve ndërmjet partnerëve. Këto largesa janë shoqëruar edhe me probleme të cilat kanë lindur dhe janë agravuar së tepërmi ndërmjet këtyre partnerëve. Problemet në çift janë shoqëruar me divorc.

Ftohja reflektohet si nga bashkëshortët emigrantë, po ashtu edhe nga gratë që kanë qëndruar vetëm për shumë vite. Kjo gjë bën që martesë për këta partnerë të humbasë kuptimin e saj.

Në intervistën e kryer me Bukurien, një grua 40 vjeçe nga Peqini, ajo shprehet se i kaloi rinia vetëm sepse sapo ishte martuar, burri kishte emigruar në Itali dhe atje kishte qëndruar thujse gjatë gjithë kohës.

“Nga gjendja ekonomike ishim mirë po mua nuk më kënaqte asgjë pasi ndihesha vetëm edhe pse jetoja me prindërit e burrit dhe djemtë e mi. Një ditë i kërkova ish-bashkëshortit të na merrte dhe ne me vete në Itali por ai nxorri preteksin se nuk mund t’i linim prindërit e tij të jetonin vetëm prandaj nuk mund të na merrte. Kur e dëgjova këtë gjë kuptova se sa shumë rëndësi kishin prindërit për të dhe sa pak kishim unë e fëmijët që po rriteshin pa praninë e babait. Pra marrëdhëniet tona ishin ftohur gjatë kohës që kishim jetuar larg njëri-tjetrit. Kjo gjë më shqetësoi dhe fillova t’i kërkoj vazhdimisht të na merrte por ai nuk pranonte. Një ditë e kërcënova duke i thënë se do ndahesha prej tij nëse nuk na merrte por, mesa pashë, atij nuk i bëri fare përshtypje kjo gjë. Ne pothuajse të ndarë ishim se ai njëherë në vit vinte me pushime kohën tjetër e kalonte në Itali”.

Gjatë intervistës me O. L. një grua 37 vjeç nga Belshi dalin në pah disa probleme të lidhura me emigrimin e bashkëshortit ndër të cilat spikatin tradhëtia bashkëshortore dhe ftohja e marrëdhënieve. E intervistuar ka pohuar se:

“Ai emigronte në Greqi ku rrinte për disa muaj deri në një vit. Kur kthehej sillte para për familjen por dy vitet e fundit nuk erdhi fare. Flisnim rrallë në telefon se na kishte thënë që në ishull nuk ka valë prandaj celulari del i fikur. Nga fundi i vitit të dytë sa herë që i telefonomin na përgjigjej një grua. Kur e pyeta më tha se ishte pronarja e shtëpisë po në fakt ajo kishte qënë bashkëjetuesja e tij. Kur u kthye nga Greqia më tha se nuk më donte më dhe se kishte një lidhje tjetër. Unë bëra divorcin po në fakt ai më kishte lënë shumë kohë më parë”.

Jeta më vete në emigracion ka bërë që shumë partnerë të shfaqin vese të këqija të cilat nuk i kishin para se të emigronin. Në pesë nga intervistat pohohet nga bashkëshortet se burrat e tyre kanë pasur një jetë të qetë dhe pa vese gjatë kohës kur ishin në Shqipëri por në emigracion kanë ndryshuar shumë. Të intervistuarat shprehen se kur janë kthyer nga emigrimi ata kanë shfaqur vese të tilla si përdorues alkooli, luajnë bixhoz, ndërsa dy nga të intervistuarat pohojnë se bashkëshortët e tyre në emigracion janë bërë përdorues të substancave narkotike. Gjatë intervistave gratë kanë pohuar se veset e këqija i kanë bërë ata të dhunshëm ndaj tyre. Veset kanë bërë që marrëdhëniet ndërmjet tyre të jenë konfliktuale dhe të shoqëruara me dhunë. Ja se çfarë pohon J. M. me origjinë nga Gramshi por që

aktualisht jeton në një shtëpi me qera në Elbasan, sepse është punësuar në një rrobaqepsi, në intervistën e kryer me të:

“E njihja shumë mirë ish-burrin tim, pasi jemi rritur në një lagje dhe nuk ka pasur asnjë ves të keq. Por iku në Greqi për punë se nuk po gjente këtu, me sa duket u bë përdorues droge. Nuk e di se si ka ndodhur, por kur u kthye nuk ishte më i pari. Përveç se drogohej, dhe na shkatërroi nga ekonomia, ai ishte dhe shumë i dhunshëm. Dy herë kam përfunduar në spital me kokë të çarë, pasi më kërkonte para për drogë, e unë nuk i jepja. Nuk pashë zgjidhje tjetër veç divorcit, për t’i shpëtuar dhunës së tij”.

Ndërsa Vera me të cilën jam njohur pranë Forumit të Gruas Elbasan përgjatë intervistës së saj na tregon se si kishte ndryshuar jeta e bashkëshortit të saj dhe më pas e gjithë familjes me emigrimin e bashkëshortit. Gjatë intervistës së saj ajo shprehet se:

“Familja ime ishte e lumtur për sa kohë bashkëshorti, që tani është bërë “ish”, nuk kishte shkuar në emigracion. Emigracioni e ndryshoi atë si njeri, dhe më pas na shkatërroi familjen, me veset që kishte marrë andej. Mbas debateve të vazhdueshme për të hequr dorë nga veset, u erdhi radha konflikteve dhe dhunës ndaj meje dhe fëmijëve. U munduam shumë, unë e fëmijët, ta largonim nga pija e bixhozi, por si shkëmbim na nxorri nga shtëpia, pasi sipas tij nuk po e linim rehat të bënte jetën që i pëlqente. E detyruar nga rrethanat u ndava prej tij”.

Suzana 38 vjeç me arsin të mesëm nga një fshat i Elbasanit tregon përgjatë intervistës së realizuar me të se si kishin qenë marrëdhëniet gjatë kohës që çifti ishte në Shqipëri dhe si ndryshuan pasi emigruan në Greqi. Ajo pohon se bashkëshorti kishte ndryshuar shumë në sjellje duke shfaqur vese të cilat nuk i kishte pasur më parë. Nëse në Shqipëri kishin pasur marrëdhënie normale, pas emigrimit gjithçka kishte ndryshuar dhe me kalimin e kohës martesë e tyre nuk funksiononte më. Ja se si shprehet ajo:

“Gjatë dy viteve të para të martesës kishim marrëdhënie shumë të mira me njëri-tjetrin por kur shkuam në Greqi gjithçka ndryshoi. Nga viti i trete i emigrimit nuk po tregonte më interes për mua dhe fëmijët, herë sillte para nga puna e herë jo. Kuptova që kishte një lidhje tjetër por nuk i thashë gjë për këtë. Më pas filloi pijen dhe pothuajse çdo natë kthehej i dehur në shtëpi dhe më rrihte. Një natë vajza e madhe erdhi ta ndalonte por ai e rrahu dhe atë. Të nesërmen të dyja ishim me shenja të nxira nga të rrahurat dhe kështu shkuam në polici dhe e denoncuam. Kisha frikë se ndonjë ditë edhe mund të na vriste sepse ai ishte i papërgjegjshëm kur pinte prandaj e bëra këtë gjë. Mbas denoncimit ai u largua në Shqipëri dhe bëri divorcin”.

L. V. një grua 35 vjeç me profesion mësuese, nga një fshat i Librazhdit me origjinë, por që jeton në qytet në një shtëpi me qera pas divorcit. Ish-bashkëshorti i saj ka qenë emigrant në Greqi për disa vjet por me krizën ekonomike që pësoi Greqia mbeti pa punë e u kthye. Ajo tregon gjatë intervistës se:

“Për sa kohë që ai ishte në emigracion, marrëdhëniet tona ishin në rregull. Ai vinte tri herë në vit dhe rrinte 2-3 javë, por pothuajse gjithë ditën rrinte me shokët dhe kur kthehej në darkë ishte i dehur. Asnjëherë nuk e kisha menduar se ai ishte i bërë i varur nga alkooli, por kur u kthye përgjithmonë nga emigrimi e vura re këtë gjë, sepse po i ndieja çdo ditë e më tepër pasojat. Si i papunë që ishte shpenzonte paratë e rrogës sime për të pirë gjithë ditën. Nëse i bëja llafe se përse pinte plaste sherri. Kohët e fundit u bë i padurueshëm për shkak të pijes, dhe nuk e kontrollonte veten fare. Më shante me fjalë të pista edhe në prani të fëmijëve, gjë të cilën nuk mund ta toleroja, e kështu i dhashë fund martesës me të”.

Një familje nuk bën jetë të qetë nëse kryefamiljari i saj shfaq vese të këqija edhe nëse gjëndja ekonomike e saj është e mirë. Gjatë intervistës me një grua që jetonte në Itali prej 15 vitesh na tregon se përse u divorcua nga bashkëshorti i saj. B. R. ka pohuar se:

“Të dy punonim në punë me pagesë të lartë. Nuk na mungonte asgjë, nga ana ekonomike i kishim plotësuar të gjitha kushtet për jetesë normale, për vete dhe fëmijët. Atij i pëlqente të pinte nga një gotë raki ose verë në darkë, por me kalimin e kohës po dehej çdo natë. Pijen e kishte me sherr, sepse sa herë që dehej do na rrihte me radhë, mua dhe fëmijët. Kur i thosha në mëngjes se çfarë kishte bërë, më kthente përgjigje se nuk mbante mend asgjë. Një natë më rrahu keq, sa mendova se do vdisja, por fëmijët njoftuan policinë dhe mendoj se falë saj jam gjallë sot. Po mendoja të

ndahesha prej tij, por kur ma kërkuan edhe fëmijët, nuk ngurova më. Pse të jetojmë me frikë, se mos po na vret ndonjë ditë?- më thanë ata”.

Pothjuajse të njëjtat pajoja nga veset e bashkëshortëve pohojnë edhe gratë e tjera të intervistuar. Veset e këqija jo vetëm kanë tjetërsuar personin që i shfaq por kanë pasur një ndikim negativ edhe në jetën e familjarëve të tyre gjë e cila ka çuar në shkatërrimin e familjes. Edhe pse përpjekjet e bashëshortes dhe fëmijëve për t’i larguar nga këto vese kanë qenë të mëdha, kjo gjë ka rezultuar e pamundur. Këtë gjë na e pohon Zana nga Elbasani, nënë e dy djemve të rritur me arsim të mesëm, një grua rreth të 50-tave e cila kishte 3 vjet që ishte divorcuar nga bashkëshorti. Gjatë intervistës së saj ajo pohon se:

“Gjatë kohës që kemi jetuar në Greqi ish-burri pononte dhe nuk e kishte mendjen tek pija, po kur erdhëm në Shqipëri, se mbetëm pa punë andej (në Greqi), s’kishte ç’të bënte dhe pinte gjithë ditën. Mirë se pinte se dëm vetes së vet i bënte po zihej me çunat, sa herë që ata i thonin mos pi. I thoja çdo mëngjes para se të shkoja në punë të mos pinte por kur kthehesha e gjeja të dehur. Kjo gjendje vazhdoi për shumë kohë po ashtu dhe debatet me mua dhe çunat, derisa një ditë na nxorri të tre jashtë nga shtëpia. U munduam t’i flisnim, unë dhe çunat, me shpresë se do pajtoheshim, por nuk pranoi. Pas disa muajsh mora vesh se po bashkëjetonte me një grua tjetër, dhe kështu bëra kërkesën për divorc”.

4. 5. 1. Marrëdhëniet bashkëshortore gjatë ribashkimit të çiftit në emigracion.

Nuk janë të pakta rastet kur të dy partnerët kanë qenë në emigracion dhe njëri nga partnerët është kthyer në Shqipëri për të bërë kërkesën për divorc. Gjatë analizës dalin në pah të dhënat që janë specifike për çiftet që janë në emigracion. Kryesisht janë bashkëshortët të cilët kanë emigruar vetë fillimisht dhe mbasi kanë siguruar leje qëndrimi kanë bërë bashkim familjar duke i marrë në emigracion edhe gratë e tyre me fëmijët. Bashkëshortet shprehen se gjatë periudhës që kanë qëndruar larg njëri-tjetrit ata kanë pasur një martesë normale pa shfaqur probleme të rëndësishme. Mosmarrëveshjet dhe kontraditat ndërmjet partnerëve kanë filluar kryesisht mbasi janë bashkuar në emigracion. Përgjithësisht gratë në emigracion janë më të prirura për të bërë kërkesën për divorc nëse kanë probleme në çift. Ato shprehen se gjatë qëndrimit larg njëri-tjetrit nuk kanë vënë re te bashkëshortët e tyre disa vese dhe sjellje të cilat ata kanë shfaqur mbasi janë bashkuar në emigracion. Gratë pohojnë se qëndrimi për një kohë të gjatë vetëm ka ndikuar negativisht tek bashkëshortët e tyre. Ata janë bërë njerëz me vese të cilat nuk i kanë pasur më pare, shprehen në disa raste gratë që kanë bërë kërkesën për divorc. Nga këto të dhëna duket qartë se emigracioni ka ndikuar në ndryshimin e sjelljes dhe shtimin e problemeve familjare e sociale.

Ribashkimi në emigracion nuk ka qenë i lehtë jo vetëm në aspektin e vështirësive në akomodimin e familjes, por edhe në përshtatjen e mënyrës së jetesës në një vend të huaj. Siç pohohet edhe nga bashkëshortet të cilat kanë emigruar për t'u bashkuar me bashkëshortin në

emigracion, secili nga partnerët kishte pasur mënyrën e tij të jetesës si pasojë e jetës duke jetuar të ndarë për një kohë të gjatë. Burrat emigrantë kanë qenë të shkëputur nga problemet familjare të cilat zgjidheshin kryesisht nga gratë. Gjatë bashkimit ata janë gjendur të papërgatitur përpara një situatë të tillë ku dhe ata duhet të merrnin pjesë në zgjidhjen e këtyre problemeve.

Manushaqja, një nga gratë që është kthyer nga emigrimi pasi kishte 2 vjet që kishte bërë bashkim familjar shprehet në kërkesë-padinë e saj për divorc se ishte e pamundur për të bërë një jetë normale me bashkëshortin pasi kishin kaluar një periudhë 10-vjeçare larg njëri-tjetrit. Bashkëshorti ishte i shkëputur totalisht nga problemet e familjes dhe as që e mori mundimin të bëhej pjesëmarrës në zgjidhjen e tyre. Ai ishte mësuar me jetën e tij larg halleve dhe problemeve të fëmijëve dhe familjes dhe po të njëjtën gjë bëri edhe kur familja po jetonte e gjithë bashkë. “Mbas pune vazhdonte të frekuentonte lokalet dhe vonë kthehej në shtëpi në gjendje të dehur”, pohon Manushaqja. Ndërsa në një dosje tjetër gjejmë të shprehura këto fjalë nga një grua e cila mbas bashkimit familjar në emigracion e kishte kuptuar se martesë nuk mund të funksiononte si rezultat i jetesës së ndarë që kishin bërë bashkëshortët për një kohë të gjatë dhe ftohjes së marrëdhënieve.

“Nuk guxoja t’i kërkoja llogari për asgjë sepse e dija që do të më shante, ofendonte, madje edhe mund të më godiste sidomos kur kishte konsumuar alkool. Shumë shpejt pasi shkuam në Greqi së bashku me fëmijët e kuptova që marrëdhëniet tona ishin ftohur pikërisht nga sjellja e bashkëshortit i cili ishte si një i huaj për ne. Këtë situatë e durova për dy vjet me shpresë se po përmirësohen marrëdhëniet tona. Ato jo vetëm që nuk u përmirësuan, por konfliktet dhe mosmarrëveshjet u bënë më të shpeshta sa që qëndrimi me të u bë i pamundur dhe kështu vendosa të kthehem për të bërë divorcin. Të afërmit e mi të cilët punonin me të, më thanë që ai kishte një lidhje jashtëmartesore me një romune dhe sapo isha larguar unë e kishte sjellë në shtëpi dhe bashkëjetonte me të. Mesa duket ky paska qenë shkaku që ai sillej ashtu me mua dhe fëmijët”.

Në përmbajtje të shumë dosjeve të partnerët që kanë bërë kërkesën për divorc mbasi janë kthyer nga emigracioni, del në pah vështirësia që kanë ata për të ribërë jetën në çift mbas një periudhë të gjatë ndarjeje. Jetesa e ndarë ka krijuar një ftohje të marrëdhënieve ndërmjet partnerëve edhe pse martesë e tyre vazhdon të ekzistonte. Shumica e martesave ndër emigrantë kanë pasur një histori të tillë, mbas kurorizimit bashkëshorti është larguar në emigracion dhe ka qëndruar atje thuajse gjatë gjithë kohës. Siç e kam përmendur dhe më lart, gjatë kësaj periudhe njëri nga partnerët është marrë me rritjen e fëmijëve, ndërsa partneri tjetër ka siguruar të ardhura në emigracion për familjen. Deri në këtë fazë gjithçka shkon mirë përse i përket martesës dhe marrëdhënieve të tyre. Problemet e çiftit dalin në pah me bashkimin e tyre në emigracion. Gjatë bashkimit ata e kanë kuptuar se martesë ka probleme të cilat nuk i kishin vërejtur më parë, por që shtoheshin me kalimin e kohës. Mosmarrëveshjet u kanë lënë radhën konflikteve të cilat e shtojnë akoma më tepër ftohjen e marrëdhënieve ndërmjet partnerëve. Bashkëshortët ia vënë fajin njëri-tjetrit për gjendjen në të cilën ndodhet martesë e tyre. Ata shpesh justifikohen me faktin se nuk e kanë njohur mirë partnerin para se të martoheshin, apo se kanë mospërputhje karakteri. Këto probleme dalin në pah mbas disa vitesh martesë, ku pjesën më të madhe të kohës, partnerët kanë jetuar të ndarë. Kështu martesës i vjen fundi, edhe pse partnerët nuk e kanë menduar më parë një gjë të tillë.

4. 6. Ndryshimet në mënyrën e jetesës së çiftit me ndryshimin e sistemit politik në Shqipëri

Ashtu siç dhe e kemi përmendur më lart me ndryshimin e sistemit politik, me apo pa dashje, ndryshoi dhe mënyra e jetës në çift për shumë prej tyre. Themi me apo pa dashje sepse shumë prej tyre emigruan me dëshirën e tyre por kjo nuk do të thotë se ata dëshironin të bënin një jetë larg familjes. Ata zgjodhën rrugën e emigrimit si pasojë e varfërisë në vend por nga ana tjetër pamundësia për të marrë familjen me vete i detyroi të jetonin larg saj. Edhe pse një gjë e tillë nuk kishte ndodhur më parë, çiftet shqiptare me partner emigrant u mësuan me këtë mënyrë të re jetese. Në intervistat me çifte të martuar para viteve 90-të del në pah ndryshimi që ka pësuar jeta e tyre me ndryshimin e sistemit politik në vend.

Në intervistën e realizuar me L. M. një grua 55 vjeç e cila kishte rreth 7 vjet që ishte divorcuar bëhen prezente ndryshimet që kishte pësuar marrëdhënia e saj bashkëshortore me ndryshimin e sistemit politik në Shqipëri. Ajo ishte martuar në vitin 1985 dhe gjatë intervistës flet me nostalgji për marrëdhëniet që kishte pasur me bashkëshortin para 90-tës.

“Mbas martesë, jetonim me prindërit e burrit, se nuk kishim shtëpi tonën, por me njëri-tjetrin shkonim shumë mirë, komunikonim për çdo gjë. Ajo ishte periudha më e lumtur e martesës, se më pas ai emigroi në Greqi, dhe unë qëndrova këtu, dhe si të thuash jeta jonë u nda. Largësia e bëri punën e vet, sadoqë përpiqesha të afrohesha kur vinte me pushime marrëdhëniet tona po ftoheshin, dhe me kalimin e kohës,

martesa e humbi kuptimin e saj. Kohët e fundit, po vinte gjithnjë e më rrallë nga Greqia, dhe kur vinte rrinte si i huaj në shtëpi. Më tha se donte të ndahej pa më dhënë asnjë arsye. Më vonë mora vesh se kishte pasur një lidhje tjetër që prej 10 vjetësh me një greke, me të cilën kishte edhe fëmijë”.

Ndërsa në intervisten e realizuar me O. D. një grua 48 vjeç nga një fshat i Librazhdit shohim se si divorci nga bashkëshorti është kryer me preteksin për të siguruar leje qëndrimi në Gjermani por që realisht ka qenë i vërtetë pasi ish-bashkëshortët nuk janë ribashkuar më. Gjatë intervistës ajo ka pohuar se:

“Fillimisht martesa jonë ka qenë e qetë dhe pa probleme të rëndësishme. Por kur lindën fëmijët na nevojiteshin më shumë para dhe për këtë arsye ish-burri shkoi në Gjermani, se ishte pa punë, dhe nga toka që kishim, nuk nxirrnim ndonjë fitim përveç bukës. Pas gati dy vjetësh, më solli një letër, ku më sqaronte se duhej të martohej sa për letra me një gjermane, se ndryshe nuk mund të punonte atje, dhe për këtë unë duhej të bëja divorcin, meqë ai nuk vinte dot. Më thoshte në letër, se sapo të merrte letrat, do ndahej prej saj, dhe do na tërhiqte me vete mua dhe djemtë. Unë pranova dhe e bëra divorcin, por ai dhe pse tha se do ndahej prapë prej saj nuk e bëri më”.

Një grua gjatë grupit të fokusit të organizuar me gratë e martuara para viteve 90-të tregon se si ka qenë martesë e saj para se bashkëshorti të emigronte. Ajo ka pohuar se:

“Kishim një martesë normale me hallet e problemet e përditëshme të punës e të rritjes së fëmijëve por me njëri-tjetrin shkonim shumë mirë. Kur ish-burri mbeti pa punë shkoi në Itali se një shok i premtoi se do t’i gjente punë. Shkoi dhe qëndroi atje për 5 vjet pa ardhur se nuk kishte letra qëndrimi dhe nëse vinte nuk mund të ikte prapë. Pasi mori letrat erdhi dhe na mori edhe ne në Itali. Gjatë qëndrimit atje vura re se ai nuk ishte më si më parë. Ishte bërë një njeri tjetër përse i përket mënyrës se si sillej me mua dhe fëmijët. Ishte shumë agresiv, acarohet për gjëra të vogla dhe me kalimin e kohës kishim shumë konflikte të cilat fillimisht ishin me fjalë por më pas ai u bë i dhunshëm ndaj meje. Më fyente, ofendinte dhe më pas edhe më rrihte në prani të fëmijëve. Për pak kohë që ishim në Itali qëndrimi u bë i padurueshëm dhe unë mora fëmijët dhe u ktheva sërish në Shqipëri”.

4.6.1. Ndërhyrja e shtetit për uljen e shkallës së emigracionit

Çiftet që kanë partnerë në emigracion, janë më të rrezikuar nga divorci, referuar të dhënave që dalin nga studimi i dosjeve të kërkesë-padive për zgjidhje martesë. Kjo gjë lidhet jo vetëm me mënyrën e jetësës që bëjnë këta partnerë, por edhe me problemet me të cilat

përballen ata. Për asnjërin nga partnerët nuk është e lehtë jeta, si për ata që ndodhen në emigracion dhe jetojnë të shkëputur nga familja, po ashtu edhe për partnerin tjetër që duhet t'i përballojë vetëm problemet e familjes. Sigurisht familjet që kanë njërin nga partnerët në emigracion kanë kushte më të mira jetese, janë në gjendje më të mirë ekonomike, krahasuar me familjet që nuk kanë emigrantë. Një konstatim i tillë nuk do të thotë se problemet e tyre janë zgjidhur. Problemet sociale që mbart emigracioni, reflektohen më së shumti tek ky grup social, krahasuar me grupin tjetër. Kjo gjë vihet re edhe te numri më i lartë i divorceve të kryera prej tyre. Emigracioni është një faktor që ndikon fort në rritjen e numrit të divorceve. Kjo gjë konstatohet nga analiza e të dhënave. Nga dosjet del se 65 përqind e rasteve të divorceve që janë përfshirë në studim kanë pasur njërin nga partnerët ose të dy në emigracion. Për të mënjeluar këtë dukuri si dhe për të ulur sa më shumë numrin e divorceve që shkaktohen si rezultat i emigracionit, ndërhyrja e shtetit është vendimtare. Ndërmarrja dhe realizimi i politikave ekonomike dhe sociale, do të kishte një ndikim shumë pozitiv përse i përket uljes së shkallës së emigrimit të shqiptarëve drejt vendeve të tjera. Rrjedhimisht bashkëshortët do të bënin një jetë më të konsoliduar, po kështu edhe familja do të shfaqte më pak probleme sociale, dhe si pasojë edhe divorcet do të ishin më të paktë në numër.

Gjatë intervistave me të divorcuar që kanë pasur partnerët në emigracion të bie në sy fakti që marrëdhëniet martesore para emigrimit kanë qenë të mira, normale, të qeta. Shumë nga të intervistuarit e lidhin nisjen e problemeve me partnerin që me largimin e tij në emigracion. Ata paraqesin si shkaktar të problemeve që më pas ka çuar në divorc pikërisht emigrimin për arsye ekonomike të partnerit. Disa nga të intervistuarit me partner emigrantë pohojnë se duhen marrë masa për të frenuar emigrimin. Një ndër këto masa sipas tyre është

rritja e punësimit. Nëse shqiptarët do të kenë mundësi të punësohen në vend ata nuk do të emigrojnë. Ulja e shkallës së emigrimit nga ana tjetër do të shfaqte më pak probleme në çift pasi partnerët jetojnë pranë njëri-tjetrit dhe jo të ndarë.

Ja se si shprehen disa nga të intervistuarit për këtë çështje:

J. M. pohon se nëse ish- bashkëshorti do të kishte mundësi të punësohej në vend nuk do kishte emigruar sipas saj.

“Ai iku sepse ne ishim keq nga ekonomia por jo se kishte dëshirë. Por nëse do të kishte gjetur punë këtu zor se do t’i kishte shkuar ndërmend të emigronte. Po të mos ishte larguar nga ne ndoshta akoma do të ishim bashkë edhe sot”.

O. L. për shkakun e emigrimit të ish-bashkëshortit të saj pohon se:

“U shkurtua vendi i punës dhe pasi ngeli pa punë iku në Greqi. Gjatë dy viteve të para, interesohej se mos po hapej prapë ndonjë vend tjetër dhe fliste shpesh në telefon me shokët që kishte pasur në punë, por nuk u bë gjë. Më pas u mësua me jetën andej dhe nuk i bënte më përshtypje”.

Vera tregon gjatë intervistës se ish-bashkëshorti i saj iku në emigracion pasi paguhej shumë pak dhe ato para nuk mjaftonin për të mbajtur familjen.

“Ish-bashkëshorti paguhej 100 mij lekë të vjetra në muaj. Ato ishin shumë pak për 4 vetë pasi unë nuk kam punuar asnjëherë, nuk na dlinin dhe prandaj ai u largua në Greqi. Nëse do të kishte pagë më të mirë jo vetëm ai që s’do kishte dëshirë të largohej, po as unë nuk do ta lejoja”.

Ndërsa Zana pohon se papunësia e bëri ish-bashkëshortin e saj njeri me vese. Ja se çfarë thotë ajo për këtë gjë:

“Papunësia e bëri ish-bashkëshortin njeri me vese dhe të dhunshëm. Përsa kohë ishte i punësuar nuk kishte ndonjë ves por kur mbeti pa punë ndoshta dhe nga mërzia filloi pijen më pas nga pija u bë dhe i dhunshëm. Po të vazhdonte të punonte nuk do të kishte kohë për të pirë lokaleve”.

Po kështu njëra nga gratë e grupit të fokusit për këtë çështje u shpreh se vështirësitë ekonomike nga papunësia i detyruan të dy të emigronin në Itali.

“Nëse do të ishim të punësuar këtu nuk mendoj se do shkonim në Itali sepse asnjëri prej nesh nuk iku me dëshirë por na detyruan kushtet ekonomike në të cilat ndodheshim pasi të dy ishim të papunë dhe pa shtëpi”.

4.6.2. Masat që ka ndërmarrë shteti për të frenuar emigracionin dhe rritur punësimin

Fluksi më i madh i emigrantëve vjen nga zonat rurale dhe shumica e tyre janë të rinj (Fletorja Zytare 2014/ Nr 169). Këta të rinj nëse do të ishin në Shqipëri do të punonin në bujqësi. Kjo referuar gjendjes aktuale të zonave rurale të cilat janë të mbështetura kryesisht në sektorin bujqësor përse i përket punësimit. Emigrimi i tyre bën që të ulet disponueshmëria për punë në këto zona. Kjo ndikon negativisht në zhvillimin bujqësor dhe rural. Kriza ekonomike në vendet ku kanë emigruar shqiptarët i ka detyruar shumë prej tyre të kthehen. Për të zbutur papunësinë është parë me prioritet nga institucionet shtetërore zhvillimi i sektorit të bujqësisë (Fletorja Zytare 2014/ Nr 169) pasi 52 përqind e të punësuarve me kohë të plotë në vend i përkasin këtij sektori. (INSTAT 2013) Në bujqësi janë punësuar numri më i madh i grave, duke zvogëluar hendekun e pabarazisë në punësim ndërmjet burrave dhe grave. (Fletorja Zytare 2014/ Nr 169). Investimet dhe në këtë sektor si dhe zhvillimi i tij mund të ndikojë pozitivisht në uljen e emigracionit pasi një pjesë e madhe e emigrantëve do të kenë mundësi punësimi. Ata nuk do të jenë të interesuar për të emigruar nëse punësimi në këtë sektor do të jetë fitimprurës për ta. Ulja e shkallës së emigrimit rrjedhimisht do të ndikojë në zbutjen e problemeve sociale si dhe në uljen e divorceve të shkatuara nga ky i fundit.

4. 7. Vështirësitë në aspektin psikologjik të përballimit të situatës pas divorcit si nga partnerët po ashtu edhe nga fëmijët e tyre.

Periudha pas divorcit ka qenë e ngarkuar emocionalisht, si për partnerët, po ashtu edhe për fëmijët e tyre. Po të njëjtën gjë na e konfirmojnë edhe dy psikologët e gjykatës Elbasan. Në një bisedë të zhvilluar me to ato deklarojnë se nuk është e lehtë për fëmijët t'i shohin prindërit të ndahen. Shumë fëmijë e përjetojnë rëndë ndarjen e prindërve të tyre. Disa prej tyre e kanë të vështirë të vendosin se me kë prind do vazhdojnë të qëndrojnë, gjatë

seancave të realizuara me psikologjen. Divorci i prindërve, krijon probleme psikologjike dhe emocionale tek këta fëmijë. Ajo që vihet re përgjithësisht është fakti se, në shumicën e divorceve fëmijët qëndrojnë me nënat e tyre dhe janë shumë të pakta rastet kur fëmijët qëndrojnë me baballarët. Këto raste ndeshen atëherë, kur nënat nuk kanë asnjë mundësi për t'u siguruar një jetesë normale fëmijëve. Duhet vlerësuar edhe fakti që përgjithësisht fëmijët e çifteve që bëjnë divorc janë minorenë, ose në fëmijërinë e hershme dhe është e domosdoshme prania e nënës gjatë rritjes, pasi ata janë më të atashuar me nënën. Në shumë prej çifteve që bëjnë divorc, edhe pse partnerët kanë jetën e tyre vazhdojnë të kenë komunikim me fëmijët, kur ata jetojnë me prindin tjetër. Gjithashtu ish-partnerët komunikojnë ndërmjet tyre për interes të fëmijës pavarësisht se janë ndarë. Ndër divorcet e realizuara ka dhe raste ekstreme kur prindërit për shkak të konflikteve që kanë pasur nuk komunikojnë më as për interes të fëmijës por këto janë shumë të pakta.

Në intervistat e zhvilluara pjesëmarrësit kanë dhënë përgjigje të ndryshme përsa i përket pyetjes se si janë ndjerë pas divorcit. Ajo që të bie në sy gjatë është fakti se pavarësisht se e kanë bërë vetë kërkesën për divorc periudha pas tij është shoqëruar me probleme emocionale dhe psikologjike tek të intervistuarit të cilat i kanë kapërcyer me kalimin e kohës. Pas një periudhe të caktuar kohe gjithçka është kthyer në normalitet. Nuk duhet të harrojmë se martesat e tyre kanë qenë problematike dhe për këtë nuk kanë pasur jetë normale gjatë saj. Nga ana tjetër një pjesë e mirë e grave të intervistuarat kanë qenë viktimat të dhunës së ish-bashkëshortëve gjë e cila ka lënë gjurmë për një kohë të gjatë tek ato. Në intervistën e realizuar me G. H. , një nga gratë e dhunuara, është pohuar se:

“Nuk mund të them se divorci ishte gjë e lehtë si për mua po ashtu edhe për fëmijët, por pas ndarjes jeta ime dhe e tyre ishte më e qetë. Kur kthehesha nga puna nuk gjeja më në shtëpi një njeri të dehur që vetëm bënte sherr. Me kalimin e kohës u mësuan dhe fëmijët dhe askujt nuk i bënte më përshtypje mungesa e ish-bashkëshortit”.

Ndërsa gjatë intervistës së realizuar me Eminenë, një grua bashkëshorti i të cilës kishte qëndruar pothuajse gjatë gjithë kohës në emigracion, del në pah se largësia e kishte krijuar gjendjen e të qëniet si e divorcuar më herët se të realizohej ai. Ajo shprehet se:

“Nuk është se e përjetova shumë keq divorcin pasi unë isha pothuajse e divorcuar qëkur bashkëshorti shkoi në Greqi dhe nuk u kthye më. Po kështu dhe fëmijët flasin në telefon njëllor si më parë dhe për ata nuk ka ndryshur thujse asgjë”.

Mimoza njëra nga gratë e grupit të fokusit e cila sapo ishte divorcuar dukej se po e përjetonte rëndë këtë periudhe pasi gjatë intervistës ishte e ngarkuar shumë emocionalisht. Gjendja e saj e humorit ndryshonte në varësi të pyetjeve që drejtoja. Kujtonte me nostalgji periudhën kur martesë nuk kishte pasur probleme dhe nga mënyra se si e tregonte dukej se kishte qenë e lumtur gjatë asaj kohe. Më pas kur fliste për kohët e fundit të martesës dhe vështirësitë që kishte pasur me partnerin qante herë pas here. Nga gjendja e saj kuptova se ajo e kishte përjetuar keq si emocionalisht dhe psikologjikisht divorcin me ish-bashkëshortin.

Mbas përfundimit të grupit të fokusit kur ishim duke pirë kafe më tregoi që po kurohej pasi vuante nga depresioni.

“Stresi më filloi që nga problemet e martesës sherret, konfliktet dhe vështirësitë ekonomike që kishim në familje. Po prisja të isha më e qetë mbas divorcit por gjendja ime u rëndua më shumë dhe doktoresha më tha që duhet të kurohem. Po marr qetësues tani, kam disa muaj dhe sikur jam më mirë”.

Edhe një grua tjetër gjatë grupit të fokusit ka pohuar se nga dhuna që ka ushtruar ish-bashkëshorti ndaj saj dhe fakti që ishte vetëm me të në emigracion dhe nuk kishte dikë tjetër për të folur për problemet që kishte pasur, vuante nga depresioni. Ja se çfarë pohon ajo gjatë bisedës:

“E vuaja shumë shpirtërisht çdo konflikt që kisha me ish-bashkëshortin, ndoshta dhe për faktin se nuk kisha dikë që të flisja për problemet që kisha. Isha pothuajse gjithmonë e stresuar gjatë dy viteve të fundit të martesës por nuk bëra asnjëherë vizitë tek mjeku. Mbas divorcit u bëra akoma më keq dhe vëllai më detyroi të bëja vizitë se unë nuk kisha guxim të shkoja vetë. Kam një vit që po pi ilaçe dhe po ndihem më e qetë”.

4.8. Familja gjatë regjimit komunist

Si një vend post-komunist, mund të themi se kishim një mungesë të kulturës së divorcit. Kjo lidhet edhe me faktin se numri i divorceve gjatë regjimit, ka qenë i ulët. Për këtë dukuri, kanë ndikuar arsye të ndryshme, ku një rol të rëndësishëm ka luajtur edhe politika bashkë me mentalitetin për familjen. Divorci stigmatizohej (konsiderohej turp) nga opinioni (Beqja dhe Sokoli, 2000), forca e të cilit ishte shumë e madhe. Sigurisht kjo ka anët e saj pozitive, sepse një familje e konsoliduar mund të shfaqë më pak probleme sociale, ose mund t'i kapërcejë më lehtë ato, nëse janë të pranishme. Këtu kemi parasysh jo vetëm marrëdhëniet e çiftit, por edhe lidhjen prind-fëmijë. Në një familje normale, të gjithë anëtarët bashkëpunojnë për të mirën e saj, ku secili anëtar jep ndihmesën e tij, për ta bërë sa më të lehtë jetesën. Fëmijëve u sigurohen nga prindërit, jo vetëm kushtet e domosdoshme për mirëritjen e tyre, por edhe ngrohtësi e mbështetje morale. Një familje në kushte të tilla, edhe problemet i përballon më lehtë.

Çdo marrëdhënie në çift ka problemet e saj, në çdo kohë, sepse çdo periudhë kohore, shoqërohet me problematikën e saj. Problemet në çift nuk janë vetëm të brendëshme, por ato lidhen edhe me faktorë të jashtëm. Kushtet ekonomike, soial-kulturore e politike janë faktorë ndikues në këto marrëdhënie. Në sajë të tyre problemet familjare shtohen ose pakësohen. Ato ndikojnë duke e bërë jetën më të lehtë ose më të vështirë. Jetesa bashkë e partnerëve në një banesë në një farë mënyre ndikonte në tejkalimin e problemeve familjare. Nga ana tjetër, edhe politika ka pasur një ndikim të madh në ruajtjen dhe forcimin e familjes, duke e

konsideruar atë të shenjtë. Propaganda e saj për ruajtjen e familjes, ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në konsolidimin e saj. Këtu nuk ngelet pas edhe formimi psiko-kulturor i shqiptarëve. Është në mentalitetin e popullit tonë që një person i rritur duhet të martohet dhe të krijojë një familje. Kjo vihet re edhe në numrin e lartë të martesave që vazhdojnë të jenë të tilla edhe sot.

Mentaliteti dhe opinionin publik kanë pasur edhe një tjetër ndikim në marrëdhëniet e partnerëve. Forca e opinionit ka bërë që problemet e çiftit të fshiheshin, të mos deklaroheshin për të mos u bërë publike duke paraqitur një realitet i cili nuk ishte i tillë. Këtë gjë e kanë konstatuar edhe Beqja & Sokoli, (2000, f.46). Nga të dhënat e dosjeve të çifteve që kanë bërë martesë para ndryshimit të sistemit pohohet një fakt i tillë sidomos nga gratë. Ato shprehen se problemet që kanë pasur me bashkëshortin nuk ia kanë treguar askujt me frikën se do të paragjykoreshin. Përballë këtij fakti, ku problemet fshiheshin për të mos u paragjykuar nga opinion, familja na paraqitej e fortë por në fakt realiteti tregon diçka tjetër. Shumë çifte të asaj periudhe pohojnë se kanë pasur probleme, madje edhe shumë të rënda ,por nuk kanë shkuar drejt divorcit për shkak të mentalitetit dhe me shpresën se do t'i kapërcenin ato. Gjatë analizës së të dhënave të mbledhura nga kjo kategori del në pah shkalla e ulët e emancipimit të grave përse i përket respektimit të të drejtave të tyre dhe vendit që i takon në familje.

Këto janë disa fakte konkrete, që tregojnë mungesën e një *kulture të divorcit* në vendin tonë. Mungesa e një kulture të tillë reflektohet në fshehjen e problemeve, maskimin e tyre për të treguar në publik një dukje të ndryshme nga realiteti.

4. 9. Ndikimi i emigracionit në ndryshimin e mentalitetit dhe pikëpamjeve për jetën bashkëshortore.

Nga analiza e të dhënave gjatë studimit të dosjeve del se është rritur shkalla e ndërgjegjësimit të grave për të drejtat dhe liritë e tyre. Nëse para viteve 90-të gratë ishin të bindura dhe gati të përulura para bashkëshortëve të tyre sot vihet re një ndryshim përsa i përket kësaj dukurie. Këtë gjë e konstatojmë edhe Tushi, G. (2006, f. 81) të cilin e kemi cituar në kapitulli II. Mund të themi se shkalla e emancipimit të gruas është rritur. Kjo refletohet edhe në numrin e lartë të kërkesë-padive të bëra nga gratë në krahasim me burrat. Për ato nuk përbën më rëndësi opinion i shoqërisë në marrjen e vendimit për të bërë divorc. Për këtë gjë ka pasur një ndikim të rëndësishëm hapja e shoqërisë e cila u dha mundësi njerëzve të njihen me kultura të shoqërive të tjera. Një rol të rëndësishëm këtu ka edhe emigrimi. Ai ka bërë që shumë shqiptarë të punojnë dhe jetojnë në shumë vende të botës. Sigurisht që emigrimi nuk ka qënë i lehtë për asnjërin prej tyre. Ata kanë kapërcyer një sërë vështirësish.

Nga regjimi i kaluar ne trashëguam një familje tejet patriarkale në të cilën thuajse nuk njiheshin të drejtat e grave. Ajo që vihet re kohët e fundit është fakti që ndryshimet socio-kulturore kanë përfshirë edhe marrëdhëniet martesore duke e zbutur paksa klimën e patriarkalitetit e cila ka mbisunduar në to. Beqja dhe Sokoli në studimin e tyre shprehen se:

“Në familje, fryma e lartë e emancipimit nuk mund të arrihet pa u çliruar nga ndikimet e patriartalizmit e të konservatorizmit të zakoneve të vjetëruara prapanike, të patërnizmit të prepotencës mashkullore, të liberalizmit të tejskajshëm, çoroditës e të çdo lloj meskiniteti e shpirtvogëlsie, pa materializuar në jetë barazinë midis burrit dhe gruas” (Beqja dhe Sokoli, 2000, f. 213-2014).

Në shoqërinë e sotme nuk mund të themi se kemi arritur barazinë ndërmjet burrit dhe gruas por diçka është bërë në këtë drejtim. Gratë kanë filluar të reagojnë ndaj shkeljes së të drejtave të tyre. Është rritur shkalla e emancipimit të tyre në drejtimin e njohjes së të drejtave dhe lirive të tyre në familje e shoqëri. Nuk mund të themi se respektohen më shumë të drejtat e tyre por të paktën ato reagojnë kur u mohohen të drejtat më elementare. Reagimin e tyre e vërejmë në rritjen e numrit të divorceve me kërkesë të grave.

4.9.1. Numri i kërkesë-padive të bëra nga gratë është më i lartë se i burrave

Gjatë shqyrtimit të statistikave vjetore të divorceve të realizuara pranë Gjykatës së rrethit Elbasan të bie në sy fakti që kërkesat për divorc të bëra nga gratë janë më të larta se kërkesat e bëra nga burrat. Ndërsa nga analiza e dosjeve të tyre konstatohet se të gjitha këto gra janë nëna me fëmijë. Gratë janë më të pakënaqura nga bashkëshortët e tyre. Ato në kërkesë-paditë e tyre parashtrojnë një sërë shkaqesh të cilat i detyrojnë të kërkojnë divorcin. Një rol të rëndësishëm këtu luan edhe emigracioni, si rezultat i të cilit, shumë gra i kanë

përballuar të vetme problemet e familjes për vite të tëra, pasi bashkëshortet e tyre kanë emigruar. Emigracioni për arsye ekonomike iu ka siguruar të ardhura për jetesë këtyre familjeve, por, nga ana tjetër, është shoqëruar edhe me një sërë problemesh sociale, të cilat kanë bërë që shumë çifte të përjetojnë krizë në marrëdhëniet e tyre. Të detyruara nga rrethanat e krijuara, këto gra i janë drejtuar gjykatës për të bërë zgjidhje të martesë, duke e parë këtë si mundësinë e vetme për t'u dhënë fund problemet e tyre.

Nëse do t'i referohemi teorisë së Hackstaff, K. (1999) me kulturë divorci kuptojmë rritjen e shkallës së barazisë ndërmjet burrit dhe gruas në një martesë. Për realitetin shqiptar nuk mund ta themi një gjë të tillë pasi nuk mund të flasim akoma për barazi ndërmjet partnerëve në çiftet shqiptare. Gjithsesi diçka pozitive po ndodh në shoqërinë tonë, kjo referuar numrit të lartë të kërkesave për divorc të bëra nga gratë krahasuar me kërkesat e bëra nga burrat. Nëse kulturën e divorcit në shoqëritë e tjera e shohim në barazinë burrë-grua në shoqërinë tonë e shohim në rritjen e kërkesave për divorc nga gratë e pakënaqura nga martesat. Kjo nuk do të thotë se në martesat që kanë përfunduar në divorc burrat kanë qenë të kënaqur pasi në fund të fundit askujt nuk i pëlqejnë problemet me partnerin. Në shumicën e rasteve të trajtuara vihet re se janë ata shkaktarë të këtyre problemeve që e kanë shkatërruar martesën duke mos i respektuar gratë, duke u shkelur të drejtat e ku ekstremi arrin me përdorimin e dhunës ndaj tyre.

Rritja e numrit të divorceve të kërkuara nga gratë nga ana tjetër tregon se ato janë bërë më të ndërgjegjshme për të drejtat e tyre ndërsa në rastin e grave emigrante gjatë intervistave shohim se kanë më tepër mundësi ekonomike për ta përballuar jetën krahasuar me gratë në Shqipëri. Pikërisht me këtë gjë mund të kuptojmë dhe reagimin më të shpejtë me

divorc nëse martesë është problematike tek këto gra krahasuar me gratë në vend. Ndryshimin e mentalitetit të vetë grave përse i përket respektimit të të drejtave të tyre si dhe reagimin me kërkesë për divorc nëse iu shkelen të drejtat dhe dhunohen duhet ta kuptojmë si fillimin e krijimit të kulturës së divorcit në Shqipëri.

Nëse marrëdhëniet martesore paraqesin probleme të pakapërcyeshme gratë kërkojnë divorcin nga bashkëshortët problematikë gjë të cilën nuk e kanë bërë më herët edhe pse janë ndodhur në të njëjtën situatë. Këtë fakt e kemi konstatuar në dy fokus-grupet e realizuara me gratë e dhunuara nga bashkëshortët pranë FGE Elbasan.

Në grupin e fokusit me gra që kanë kryer martesë para viteve 90-të konstatojmë se bashkëshortët e tyre kanë qënë të dhunshëm që në vitet e para të martesës së tyre. Edhe pse dhunoheshin prej tyre, ato kanë nguruar të kërkojnë divorc pasi kanë pasur frikë se mos do të paragjykoreshin nga shoqëria. Në disa raste nuk i ka mbështetur familja, përkundrazi u kanë imponuar përluljen para bashkëshortit edhe pse dhunoheshin sistematikisht prej tij. Ajo që më ka bërë më tepër përshtypje është fakti që në këtë grup bëjnë pjesë përveç grave me arsim 8-vjeçar e të mesëm edhe gra intelektuale me arsim të lartë. Edhe ato kishin qënë viktima të dhunës të cilën e kishin toleruar si pasojë e opinionit dhe paragjytimeve nga shoqëria. Ndërsa me ndryshimet shoqërore dhe ato ishin më të përgjegjshme përse i përket të drejtave dhe lirive të tyre në familje e shoqëri. Ja se si shprehet R. E. një grua me arsim të lartë 53 vjeç gjatë intervistës së saj lidhur me frikën e opinionit dhe paragjytimeve për të bërë divorc.

“Ish-bashkëshorti im ishte shumë xheloz, dhe për këtë shkak, ne kishim konflikte të vazhdueshme. Në debat e sipër fillonte të më gjuante, fillimisht me shuplaka dhe më pas me grushta. Ia tregova nënës këtë gjë dhe i thashë se do divorcohesha, por ajo më ndaloi, duke më thënë se nuk do gjeja burrë më të mirë se ai, ose do mbetesh beqare se do më paragjykonin, se kushedi si kisha qenë. E njëjta situatë vazhdoi për disa vjet derisa i thashë vetes mjaft më. Kisha duruar dhunën, fyerjet, sharjet, në fund të fundit kisha çuar dëm 10 vjet nga jeta ime, nga frika se çfarë do të thonë të tjerët për mua. Kur bëra divorcin e kuptova sa gabim kisha bërë që kisha duruar aq shumë”.

Ndërsa një grua tjetër me arsim të lartë e cila m'u lut të mos publikoj as inicialet e saj pasi nuk u kishte treguar të afërmeve që kishte qenë viktimë e dhunës së bashkëshortit të saj gjatë grupit të fokusit ka pohuar se:

“E duroja dhunën e ish-bashkëshortit pa ia treguar askujt sepse më vinte zor nga të tjerët. Po vitet e fundit kjo gjë u bë e padurueshme pasi shpesh kisha të nxira nga fytyra të cilat vështirë t'i fshihja. Shoqja ime e ngushtë nguli këmbë njëherë për të mësuar të vërtetën se pse i kisha ato shenja, unë s'u përmbajta më dhe ia tregova. Ajo më solli këtu tek forumi dhe më pas bëra kërkesën për divorc. Nuk ia fal vetes që qëndrova aq gjatë me një njeri të dhunshëm”

Një tjetër e grua K. M. 49 vjeç me arsim të mesëm, ishte me origjinë nga një fshat i Librazhdit por jetonte në Elbasan pasi aty kishte qenë e martuar, gjatë fokus-grupit tregon për ndikimin që kishin pasur fjalët e nënës në tolerimin e dhunës të bashkëshortit ndaj saj. Nëna para se të martohej i kishte thënë se me burrin jo gjithçka shkonte vaj, do kishte dhe zënka, dhe debate, mund edhe ta qëllonte, por ajo duhet ta duronte se ai ishte burri, ishte në shtëpinë e vet, dhe se ajo kishte shkuar në shtëpinë e tij.

“Më porositi nëna, dhe unë u besova fjalëve të saj, sepse isha 18 vjeç kur u martova, dhe nuk mendoja gjatë. Prej fjalëve të saj, kam duruar për 15 vjet ish-burrin tim të më dhunonte, sa herë që atij nuk i pëlqente ndonjë gjë. Kohët e fundit kishte filluar dhe pijen e ishte bërë akoma më i dhunshën, si ndaj meje po ashtu edhe ndaj fëmijëve, sa herë që ata më dilnin në mbrojtje. Vendosa të ndahem jo vetëm për vete por edhe për fëmijë se dhe ata po dhunoheshin njësoj si unë”.

Teuta 40 vjeç tregon se është dhunuar sistematikisht fizikisht për 8 vjet nga ish-bashkëshorti i saj. Ajo shprehet se e ka duruar dhunën sepse nuk donte të prishte familjen, që djemtë të mos rriteshin pa babanë pranë, por kur babai filloi të dhunonte dhe djemtë ajo nuk duroi më dhe bëri divorcin. Ja se çfarë pohon ajo gjatë grupit të fokusit:

“Më rrihte sa herë kishim mosmarrëveshje apo nuk i pëlqente ndonjë gjë edhe pse djemtë ishin të pranishëm. Por kur u rritën, ata filluan të më dilnin në mbrojtje dhe

nuk e lejonin të më godiste, ai filloi të rrihte dhe ata. Këtë nuk mund ta toleroja dhe u largova bashkë më djemtë nga shtëpia”.

4. 9. 2. Ndikimi i emigracionit në rritjen emancipimit të grave

Ndryshimet politike sollën edhe ndryshim rrënjësor në jetën e shqiptarëve në të gjitha aspektet e saj edhe në mënyrën e të menduarit. Nga një shoqëri e mbyllur, kaluam në një shoqëri të hapur, dukuria e parë e të cilës ishte emigracioni. Emigracioni ndryshoi mënyrën e konceptimit të jetës familjare dhe asaj bashkëshortore. Tani kemi kalimin nga një jetesë e përbashkët, në një jetesë të ndarë për shkak të emigrimit, gjë e cila më parë as që mund të mendohej. Pra ndryshoi koncepti për jetesën në çift, me apo pa dashje. Këtë gjë e konstatojmë edhe tek Sokoli, L. (2006, f. 7-8) të cilin e kemi përmendur edhe më lart. Nga ana tjetër kemi një vetëndërgjegjësim të partnerëve, për të bërë divorc, për t'i dhënë fund një martese e cila nuk funksionon më, gjë të cilën nuk do ta kishin bërë nëse do të kishin qëndruar në Shqipëri. Vendi ku kanë emigruar, ka ndikuar shumë në ndryshimin e mentalitetit për martesën dhe divorcin. Marrëdhënia e shqiptarëve me popullsinë vendase në të gjitha aspektet, vihet re edhe në kulturën e divorcit. Bashkëjetesa ndërmjet tyre, duke dhënë e duke marrë prej kulturës së njëri-tjetrit, bëri të mundur krijimin e kulturës së divorcit. Përshtatja me kulturën vendase, ka ndikuar edhe në ndryshimin e mentalitetit tek çiftet shqiptare, duke ndarë të drejtat dhe përgjegjësitë ndërmjet partnerëve, sidomos në rastet kur të dy ishin të punësuar

dhe kontibonin ekonomikisht në familje. Referuar të dhënave nga studimi, gra të cilat para emigracionit, mendonin të vetësakrifikonin për të ruajtur marrëdhënien me partnerin, duke duruar gjithçka prej bashkëshortëve të tyre, kanë ndryshuar mendim gjatë periudhës së emigrimit. Emigrimi për to, ka qënë si një dritare për të parë përtej mureve rrethues të shoqërisë sonë të prapambetur. Shumë prej tyre shprehen se janë vetëndërgjegjësuar, për të kuptuar përgjegjësitë që ato kanë në familje, por edhe të drejtat e tyre. Nëse më parë ato e kishin toleruar dhunën fizike apo psikologjike që ushtronte bashkëshorti ndaj tyre për hir të fëmijëve, gjatë emigrimit ato kishin ndryshuar mendim. Sipas tyre pre e dhunës ishin edhe fëmijët të cilët ishin të pranishëm kur ndaj tyre ushtrohej dhunë, gjë e cila kishte një impakt shumë negative edhe tek ata. Kështu ato vendosnin t'i jepnin fund martesës e cila nuk funksiononte, për t'u kujdesur vetë për fëmijët e tyre dhe për t'i mbajtur ata larg pranisë së dhunës. Nga analiza e të dhënave del në pah se gra të moshave të ndryshme, të cilat për shumë vite me radhë kanë qenë pre e dhunës dhe e kanë toleruar, gjatë kohës së emigrimit kanë ndryshuar mendim dhe nuk e kanë duruar më duke kërkuar ndarjen nga bashkëshorti dhunues. Një rol të rëndësishëm për këtë gjë kanë luajtur marrëdhëniet, komunikimi, bisedat e këtyre grave me gratë e vendeve ku kanë emigruar. Të gjitha këto kanë rritur shkallën e ndërgjegjësimit për të drejtat e tyre, si dhe kanë ndryshuar mentalitetin për marrëdhëniet në çift. Vlen të përmendet këtu edhe fakti që në këtë kategori bëjnë pjesë edhe gra intelektuale, të cilat edhe pse dhunoheshin nuk e kishin ndërmarrë vendimin për divorc gjatë periudhës që kishin jetuar në Shqipëri. Për këtë kishte luajtur një rol edhe mentaliteti në shoqërinë tonë, trysnia e së cilës i kishte frenuar për ta hedhur këtë hap me frikën se do të paragjykohehin. Ballafaqimi me kulturën e vendit ku emigruan, bëri që të përfitojnë prej saj ato aspekte, të cilat vërtet i kishin munguar kulturës sonë. Shkëputja e jetës private nga ndikimi i opinionit

dhe ndryshimi i mentalitetit përse i përket paragjytimeve të të tjerëve, është një element kulturor që është kultivuar së fundmi në shoqërinë tonë. Është rritur shkalla e individualitetit dhe e privatësisë. Kjo ka vlera sociale dhe rëndësia individuale sipas (Tushi, G. 2012, f. 90). Edhe pse në pamje të parë duket paksa e çuditshme pasi si mund të ndikojë emigrimi në këtë gjë, gjatë disa intervistave dhe në të dy grupet e fokusit e kemi konstatuar një fakt të tillë. Jetesa për shumë vite në një vend tjetër dhe me një kulturë tjetër por përgjithësisht më të zhvilluar përse i përket respektimit të të drejtave të grave ka rritur shkallën e ndërgjegjësimit të emigranteve për respektimin e të drejtave të tyre në familje. Ato kërkojnë të jenë pjesë e vendimarrjes në familje dhe të trajtohen në mënyrë të barabartë me bashkëshortët e tyre pasi këtë gjë e kanë parë në shoqërinë ku kanë emigruar. Pra, në një farë mënyre kultura e vendit ku kanë emigruar ka kultivuar tek këto gra ndjenjën për t'u trajtuar në mënyrë të barabartë dhe për t'u respektuar nga burrat e tyre. Sesa ia kanë arritur, është tjetër gjë por të paktën ato janë ndërgjegjësuar për ta kërkuar një gjë të tillë të cilën më parë as që e mendonin. Përse i përket respektimit të të drejtave të grave në familje shoqëria jonë lë shumë për të dëshiruar. Ky fakt konstatohet gjatë gjithë studimit si në rastin e grupeve të fokusit po ashtu edhe në intervistat e realizuara me gratë e divorcuara. Dy nga gratë që morën pjesë në grupet e fokusit janë ndihmuar nga shoqet e tyre greke për të denoncuar në polici dhunën e ushtruar nga bashkëshortët e tyre gjatë kohës që ishin në emigracion. Po kështu edhe gratë emigrante në vende të tjera gjatë intervistave duket se janë më mendjehapura në krahasim me gratë që nuk kanë emigruar përse i përket respektimit të të drejtave të tyre. Gratë emigrante gjatë bisedës në grupet e fokusit del se kanë duruar për pak vite dhunën e ushtruar nga bashkëshorti, krahasuar me gratë që janë martuar para viteve 90-të si dhe ato që nuk kanë emigruar

ndonjëherë. Ja se çfarë ka pohur Lumturia, njëra nga gratë e cila emigronte shpesh në Itali pasi atje kishte fëmijët, gjatë grupit të fokusit:

“Kam punuar për disa vite në shumë familje italiane si pastruese, dhe nuk them se atje nuk ka probleme në marrëdhëniet burrë-grua, por të paktën ata e respektojnë gruan, dhe nuk e dhunojnë siç bëjnë shqiptarët, që çdo gjë e zgjidhin përmes dhunës. Me dajak merr vesh kafsha, se njeriu merr vesh me fjalë”.

Ndërsa Vjollca një grua tjetër ish emigrante në Greqi ku kishte jetuar për 12 vjet gjatë grupit të fokusit shprehet se:

“Unë jam dakord që probleme në familje ka si me burrin dhe me fëmijët po përse këto duhen zgjidhur me dhunë? E, unë këtë gjë nuk mund ta pranoj. Kështu na del që është më e lehtë të dhunosh gruan se sa ta bindësh atë me fjalë ose se burrat shqiptarë nuk dinë të komunikojnë me fjalë”.

E. S. një tjetër grua rreth 40 vjeç emigrante pjesëmarrëse në grupet e fokusit tregon se si u ndërgjegjësua për t'u ndarë nga bashkëshorti dhunues.

“Në familjen italiane ku unë punoja, bashkëshortët u grindën për një problem të vogël, nuk e di mirë, në lidhje me disa para të harxhuara nga gruaja. Mbas debatit ajo e nxorri burrin jashtë nga shtëpia, edhe pse ata thjeshtë u grindën me fjalë. Kjo gjë më bëri të reflektoj për situatën në të cilën ndodhesha unë. Nëse do të kisha mosmarrëveshje me burrin, edhe për gjëra të vogla, ishte e pamundur që ai të mos më shante, apo të vinte dorë ndaj meje. U mendova gjatë pas asaj që ndodhi me çiftin italian dhe vendosa të ndahem pasi dhe nga puna paguhesha mirë dhe nuk ia kisha nevojën atij për të rritur fëmijët. Po të kisha qenë në Shqipëri vështirë se do ta kisha marrë një vendim të tillë”.

Vjollca më vonë gjatë diskutimit do të shprehej:

“Kam kaq vite që punoj në Itali dhe kam vënë re se italianët i respektojnë gratë e tyre por dhe në rast se u shkelen të drejtat, gratë italiane reagojnë, nuk janë si ne shqiptaret që ulim kokën nga frika e burrit”.

Ndërsa në intervistën e realizuar me A. B. 27 vjeç emigrante që kishte shkuar që fëmijë në Greqi del në pah se sa shpejt kishte reaguar ajo duke bërë divorcin ndaj bashkëshortit dhunues.

“Problemet me ish-bashkëshortin filluan nga fundi i vitit të parë të martesë. Ai bëhej xheloz, dhe filloi të ushtronte ndaj meje dhunë emocionale fillimisht, pastaj psikologjike, dhe përgjatë vitit të dytë të martesës, çdo konflikt që kisha me të, shoqërohej me dhunë fizike. Ish-bashkëshorti nuk punonte me pretendimin se nuk gjente punë, por paratë e rrogës sime i mbante ai, dhe më duhej të bëja sherr për t’i marrë para, nëse duhej të bleja ndonjë gjë. Nuk e durova më, dhe megjithëse isha shtatzënë, u largova nga shtëpia, e u vendosa në shtëpinë e prindërve të mi. Për disa muaj u mendova, në duhet të kthehesha më me të, apo t’i jepja fund martesës. Prindërit më thanë se do më ndihmonin për të rritur vajzën. Po bëja një jetë të qetë me ta, pse të kthehesha e të jetoja prapë me atë njeri të dhunshëm, dhe kështu vendosa dhe bëra divorcin”.

Në intervistën e realizuar me N. I. 35 vjeç nga një fshat i Peqinit del sërisht në pah reagimi i menjëherëshëm i grave emigrante ndaj dhunës së bashkëshortit.

“Ai (ish-bashkëshorti) punonte, por para në shtëpi nuk sillte në shtëpi, dhe për këtë arsye, kishim konflikte të vazhdueshme me njëri-tjetrin. Më fyente e shante me fjalët më të ndyra, sa herë që e pyesja, për paratë e punës së tij. Vitin e fundit u bë i dhunshëm ndaj meje dhe sa herë që kishim konflikte ai më dhunonte. Këtë gjë s’e

durova më dhe e nxorra jashtë nga shtëpia. Mendova se do ndryshonte e do vinte të më kërkonte të falur po nuk e bëri dhe kështu unë bëra kërkesën për divorc”.

Ajo që të bie në sy gjatë intervistave më gratë emigrante është fakti që janë të punësuar dhe paguhen mjaft mirë. Më këtë gjë nënkuptojmë se ato janë të pavarura përsa i përket anës ekonomike pasi arrijnë të sigurojnë një jetesë normale për vete dhe fëmijet e tyre pa pasur nevojën e bashkëshortit. Pavorsia ekonomike e grave rrit mundësinë për divorc sipas Vignoli & Ferro (2009 f. 27). Ky fakt mund të ketë ndikuar në reagimin e shpejtë për të bërë divorcin kur martesë është shoqëruar me probleme serioze dhe të pakapërcyeshme

Krijimi i kulturës së divorcit ka luajtur një rol të rëndësishëm në shoqërinë shqiptare. Ajo ka pasur ndikim pozitiv, sepse krijoi një ndërgjegjësim të partnerëve në çift për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, duke krijuar edhe një respekt reciprok ndaj njëri-tjetrit. Ka krijuar më shumë pavarësi tek partnerët. Kultura e divorcit ka edhe anën e saj negative, sepse ka ndikuar në rritjen e numrit të divorceve. Bashkëshortët tani ndihen më të çlirët për të kërkuat divorc, madje duke mos marrë parasysh as kushtet ekonomike në të cilat ndodhen. E pohoj një gjë të tillë pasi nuk është i vogël numri i partnerëve që kanë bërë kërkesë-padinë për divorc, edhe pse janë të papunë apo nuk kanë një banesë të tyre. Shumë prej të divorcuarve, kanë gjetur mbështetje nga prindërit e tyre, duke u sistemuar bashkë me fëmijët tek ata.

Ndërsa çiftet që janë në emigracion për rastet kur të dy partnerët janë të punësuar mbas divorcit ata rikthehen në vendet ku kishin emigruar duke e vazhduar punën dhe jetën

atje. Pothuajse të gjitha gratë emigrante që kanë bërë kërkesën për divorc janë të punësuar. Nuk janë të pakta rastet e grave të cilat nuk kanë qenë të punësuar gjatë kohës që kanë qëndruar në emigracion, mbasi janë divorcuar, kanë qëndruar në Shqipëri së bashku me fëmijët e tyre.

4. 9. Ndikimi i ndryshimit të aspektit ligjor në rritjen e numrit të divorceve.

Stigmatizimi që i bënte shoqëria divorcit por edhe procedurat e ngurta që kishte percaktuar sistemi ligjor para viteve 90-të, kishin ndikimin e tyre në frenimin e bashkëshortëve për të bërë zgjidhje të martesës.

Kodin e Familjes së vitit 1982 në Neni 95 i tij parashtrohet:

Në vendimin e zgjidhjes së martesës gjykata duhet të përmendë shkaqet që kanë sjellë tronditjen e thellë të marrëdhënieve bashkëshortore dhe të përcaktojë bashkëshortin, për fajin e të cilit zgjidhet martesa, përveç rasteve kur martesa zgjidhet për shkaqe objektive.

Kur gjykata çmon se ndaj fajtorit duhet të merren masa me karakter edukativ, jep vendim të veçantë.

Përcaktimi i fajtorit të divorcit dhe masat me karakter edukativ ndaj tij janë një farë presioni që ju bëhet bashkëshortëve jo vetëm nga gjykata por edhe nga shoqëria nëpërmjet opinionit të saj. Ai mund të konsiderohej si person i pa edukuar për të mbajtur në këmbë martesën. Por kush do të ishin institucionet që do të merreshin me edukimin e tij që ai të bëhej i aftë për të krijuar dhe mbajtur një familje? Këto institucione do të kishin karakter shoqëror apo partiak?

Mënyra se si i trajtonte shoqëria të divorcuarit nëpërmjet opinionit dhe mentalitetit, bënte që shumë prej çifteve që kishin probleme në marrëdhëniet e tyre të mos i drejtoheshin gjykatës për të bërë zgjidhje të martesës. Edhe kjo është një arsye që numri i divorceve ishte i ulët.

Në Kodin e Familjes 2003 Neni 133 thotë se gjykata vendos për fajësinë, në zgjidhjen e martesës vetëm kur kërkohet nga njëri ose të dy bashkëshortët. Me këtë gjë kuptojmë se përcaktimi i fajtorit nuk është një detyrë që duhet ta kryejë me patjetër gjykata por është një e drejtë e bashkëshortëve ta kërkojnë nëse e dëshirojnë një gjë të tillë. Në këtë Kod nuk përmendet më marrja e masave me karakter edukativ ndaj bashkëshortit fajtor.

Nga ana tjetër procedurat e divorcit janë lehtësuar. Nëse bashkëshortët nuk kanë arritur të pajtohen gjatë seancës së pajtimit në gjykatë atëherë vazhdojnë seancat e mëtejshme për zgjidhjen e martesës. Kështu për një periudhë të shkurtër kohore merret vendimi nga gjykata.

Në rastet kur gjykata nuk është e bindur se bashkëshortët nuk mund të pajtohen gjykata mund ta shtyjë vendimin deri në një vit. Raste të tilla janë kur gjykata vlerëson se bashkëshortët kanë mundësi pajtimi.

Lehtësimi në aspektin ligjor por edhe thyerja e tabusë së divorcit dhe stigmatizimi që i bënte shoqëria ka ndikuar në rritjen e numrit të divorceve në Shqipëri si edhe në vende të tjera. Këtë gjë e konstatojmë dhe në studimin mbi divorcin të kryer nga Yodanis, C. (2005 f.656) ku në shoqëritë të cilat nuk kanë lehtësi në aspektin ligjor për të kryer divorc vihet re që numri i divorceve është i ulët. Nëse shoqëria është liberale ndaj divorcit atëherë dhe numri i divorceve është i lartë sipas saj. Vignoli & Ferro siç e kemi përmendur dhe në kapitullin II, konstatojnë se në Itali nuk kemi një divorc të menjëhershëm si pasojë e vështirësive ligjore dhe kosto ekonomike të lartë. Në Shqipëri jo vetëm janë lehtësuar procedurat por dhe kostoja ekonomike e divorcit nuk është e lartë. Shpenzimet e gjyqit nuk janë përmendur si pengesë as në intervistat dhe as në grupet e fokusit që u kryen në funksion të studimit.

4. 11. Martesat dhe divorcet me partnere të huaja në emigracion

Martesat dhe divorcet me partnerë shqiptarë paraqesin përgjithësisht këto problematika që trajtuam më lart. Krahas tyre kemi edhe martesë e divorce midis emigrantëve shqiptarë dhe partnereve të tyre të cilat janë kryesisht nga vendet ku kanë emigruar ata. Martesat me partnere të huaja ndahen në dy kategori:

Së pari martesat e realizuar në mënyrë normale me dashuri dhe pëlqimin reciprok të të dy partnerëve. Kryesisht nga këto martesë janë krijuar familje normale me pasardhës. Disa prej tyre kanë shkuar në divorc si rezultat i problemeve të mëvonshme që kanë patur partnerët me njëri-tjetrin.

Së dyti janë martesat jo normale të cilat janë vetëm formale në letër. Ato janë realizuar për të kryer një funksion të caktuar që kryesisht lidhem me mundësinë për t'u pajisur me leje qëndrimi në vendin ku kanë emigruar. Kjo është një praktikë e ndjekur nga disa emigrantë shqiptarë kohët e fundit në vendet e zhvilluara të BE-së.

Përsa i përket martesave normale mes emigrantëve dhe partnereve të huaja vihet re se problemet që i kanë çuar në divorc këto martesë janë më të pakta krahasuar me martesat ndërmjet partnerëve shqiptarë. Nëse partneret shqiptare kanë duruar për vite të tëra të dhunohen nga bashkëshortët e tyre, kjo gjë nuk ka ndodhur me të huajat, pasi ato i kanë dhënë fund martesës kur problemet kishin pak kohë që kishin filluar. Një tjetër fakt që të bie në sy ndër rastet e studiuara të kësaj kategorie është se divorcin e kanë kërkuar bashkëshortet e huaja dhe jo burrat e tyre shqiptarë.

Ja se çfarë tregon për martesën e tij me shtetasen britanike G. S. 35 vjeç, emigrant në Angli.

“Vendosëm të martoheshim pasi kishim rreth dy vjet që bashkëjetonim dhe ish-bashkëshortja ishte shtatzënë. Martesa jonë ishte e lumtur por kohët e fundit ajo kishte filluar të bëhej xhelozë dhe gjithmonë kontrollonte telefonin tim. Bëmë fjalë sepse mua nuk më pëlqente që ta bënte një gjë të tillë. Më pas kur në shtëpi vinin miq të mi shqiptarë ajo gjithmonë acarohet pasi nuk kuptonte kur flisnim shqip. I dukej

sikur unë po flisja keq për të, nuk e di pse i ishte bërë fiksim një gjë e tillë. Këto qenë shkaqet të cilat krijuan mosmarrëveshje mes nesh dhe më pas u shoqëruan me ftohje të marrëdhënieve. Ajo u largua nga shtëpia duke marrë dhe vajzën me vete. Kishim rreth 6 muaj që jetonim të ndarë dhe një ditë më thotë se donte të bënim divorcin pasi martesë nuk kishte më kuptim”.

Ndërsa një tjetër emigrant D. B. që kishte qenë për rreth 10 vjet i martuar me një shtetase gjermane shprehet se nuk e kishte menduar asnjëherë se martesë e tij do të shkonte në divorc pasi të dy partnerët kishin pasur një martesë të lumtur për shumë vite. Problemet në çift kishin lindur me ardhjen në jetë të djalit. Kjo gjë kishte bërë që bashkëshorti të ndihej paksa i lënë jashtë vëmendjes nga gruaja e cila kujdesej gjatë gjithë kohës për fëmijën. Gjatë intervistës ai ka pohuar se:

“Ajo (ish-bashkëshortja) dëshironte shumë të kishte fëmijë dhe kur lindi djali u gëzua jashtë mase saqë gjithë vëmendjen e kishte vetëm tek ai. Filloi të mos interesohej më për mua pasi merrej vetëm me djalin. Kjo gjë nuk po më pëlqente, ia pata thënë edhe asaj por, mesa duket, kjo ndikoi për keq pasi ajo po sillej ftohtë ndaj meje saqë më dukej vetja si i huaj në shtëpi. Kohët e fundit kishim mosmarrëveshje dhe një ditë për shkak të një konflikti ajo mori djalin dhe u largua nga shtëpia. I kërkova disa herë që të kthehej në shtëpi por ajo nuk pranoi dhe më pas bëme divorcin”.

Krahas intervistave të mësipërme u realizuan edhe tre intervista të cilat ishin paksa të veçanta nga të parat. Ato ishin të veçanta përse i përket problematikës me të cilën lidhej divorci që kishin realizuar këta të intervistuar. Nëse divorci mes çifteve me partnerë shqiptarë kishte ardhur si pasojë e një sërë problemesh sociale dhe ekonomike, tek intervistat e fundit martesë dhe divorci ishte realizuar për arsye të tjera të cilat kryesisht kishin të bënin me sigurimin e lejeve të qëndrimit në vendet ku ata kishin emigruar.

Ja se çfarë na tregon A. Ç. nga një fshat i Librazhdit emigrant në Zvicër rreth martesës dhe divorcit të tij me një shtetase zviceranë:

“Ilegalisht si shumë shqiptarë shkova në Zvicër por e kisha shumë të vështirë të punoja se isha pa letra. Një shqiptar nga Maqedonia më mbante në shtëpinë e tij dhe më kishte punësuar si ndihmës mekanik në oficinën e tij. Por më kalimin e kohës dhe ai kishte frikë të më mbante ashtu se mos po e merrnin vesh autoritetet dhe mund t’i dilnin shumë probleme pastaj, dhe për këtë gjë më sugjeroi të bëja një martesë formale sa për të siguruar leje qëndrimi me një shtetase zvicerane të cilën ai e njihte. Edhe ajo ishte në dijeni për këtë gjë prandaj martesë do të bëhej kundrejt një pagese për të cilën ajo kishte rënë dakord. Gjithashtu ramë dakord që mbasi të merrja dokumentat për të qëndruar në Zvicër, do të fillonim procedurat e divorcit. Dhe kështu bëmë martesë formale, kuptohet sa për letra, e cila zgjati për 4 vjet dhe pasi mora letrat ndenja dhe 1 vit tjetër i martuar e më pas fillova procedurat për divorc”.

Gati një histori të ngjashme na a tregon dhe L. B. një emigrant në Britaninë e Madhe për mënyrën se si ishte martuar dhe divorcuar me një shtetase britanike por me kombësi ruse.

Ja se çfarë tregon ai për këtë gjë:

“Në Angli m’u refuzua kërkesa për azil të cilën e bëra sapo mbërrita atje. Kisha dëgjuar nga shqiptarë të tjerë që kur u refuzohej alizi bënin martesë formale me shtetase britanike me qëllim që të merrnin pasaportën dhe pastaj bënin divorc. Kështu pas 4 vjetësh vendosa të bëj dhe unë një martesë të tillë. Për këtë gjë i kërkoja ndihmë një kolegeje me kombësi ruse por që kishte pasaportë britanike. Ajo fillimisht sikur nuk po pranonte por kur i thashë për shumën e parave që do të merrte si shpërblim u tregua e gatshme. Kështu bëra martesë formale sa për të marrë pasaportën dhe kur e mora atë pas 3 vjetësh bëra divorcin nga rusja e cila po priste me padurim pasi kishte krijuar familje me një person tjetër”.

Ndërsa në intervistën e realizuar me V. D. i cili ka qenë martuar me shtetase britanike por jo për të marrë pasaportë sipas tij na dalin në pah detaje të tjera gjatë intervistës. Ja se çfarë pohon ai gjatë intervistës:

“Ish-bashkëshorten time angleze e kam njohur në punë dhe pas një kohe të gjatë që ishim lidhur vendosëm të bashkëjetojmë. Kur kishim gati tre vjet që bashkëjetonim mua m’u refuzuan dokumentat dhe për këtë gjë duhej të kthehesha në Shqipëri. Ajo

(ish-bashkëshortja) u interesua tek një avokat për të parë ndonjë mundësi që unë të qëndroja, por ai i kishte thënë se vetëm nëse ajo martohej me mua do të mund të qëndroja atje. Meqë të dy e donim njëri-tjetrin vendosëm të martoheshim dhe kështu bëmë. Nga martesë bëmë 2 fëmijë dhe gjithçka vazhonte normalisht për disa vjet me radhë. Unë e mora pasaportën dhe erdhëm për vizitë në Shqipëri. Mbas kthimit filluam të kishim probleme në marrëdhëniet tona të cilat nuk i kishim pasur më parë. Nuk e kuptova se çfarë nuk i kishte pëlqyer nga qëndrimi në Shqipëri por filloi të krijonte konflikte pa pasur ndonjë arsye të rëndësishme. Kjo gjendje vazhdoi për disa muaj derisa një ditë më kërkoi të largohem nga shtëpia e më pas bëmë divorcin”.

4. 12. Specifika të divorcit tek komunitetet romë dhe egjyptian

Gjatë trajtimit të dosjeve psikologjia e gjykatës kishte ndarë një grup dosjesh më vete nga shumica. Ajo më komunikoi se këto dosje i përkisnin dy komuniteteve, romë dhe egjyptianë. Këto komunitete përbëjnë një numër të konsiderueshëm anëtarësh në qarkun e Elbasanit. Gjëja e parë që të binte në sy ishte fakti që ishin një numër shumë i kufizuar dosjesh. Psikologjia më sqaroi se përgjithësisht anëtarët e këtyre komuniteteve nuk bënin martesë ligjore, pra celebrim të martesës së tyre. Kryesisht martesë e tyre ishte në formën e bashkëjetesës për arsye të ndryshme ku njëri sipas saj kishte të bënte me moshën. Ata bënin një martesë shumë më të hershme se mosha 18 vjeç që parashikon Kodi i Familjes në vendin tonë.

Mbledhja e të dhënave nga këto dosje u bë veçmas nga dosjet e tjera me qëllim për të kuptuar specifikën e problemeve që kanë martesat apo bashkëjetesat e këtyre komuniteteve. Gjatë analizës së të dhënave nga këto dosje të bie menjëherë në sy mosha shumë e re në të cilën ata janë martuar si për gratë po ashtu edhe për burrat. Përsa u përket shkaqeve të divorcit tek martesat e këtyre dy komuniteteve ato përgjithësisht janë të kufizuara tek tradhëtia bashkëshortore. Partnerët akuzojnë njëri-tjetrin për tradhëti bashkëshortore, madje arrijnë deri në vënien në diskutim të atësisë së fëmijëve të tyre. Kjo gjë nuk është konstatuar në asnjë nga të dhënat e dosjeve të tjera jasht, këtyre komuniteteve. Gjithashtu në asnjërën nga këto dosje nuk përmendet emigracioni si problem në marrëdhëniet bashkëshortore.

KAPITULLI V: PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

5. 1. Përfundime

Në këtë studim u identifikua dhe u nxorr në pah **kategoria e çifteve që janë më të prirur për të bërë divorc.**

Me kategori të çifteve në këtë studim nënkuptojmë karakteristikat e përbashkëta që kanë çiftet e divorcuar. Karakteristikat e tyre lidhen me: sa vite kanë që janë martuar, marrëdhëniet ndërmjet partnerëve, gjendjen ekonomike që kanë pasur partnerët gjatë martesës, jetesa e përbashkët apo e ndarë e çiftit, në cilat zona është më e përhapur dukuria, shkalla e arsimimit të partnerëve.

Së pari nga të dhënat e studimit arrihet në përfundimin se martesa është më e rrezikuar sidomos në vitet e para deri në 10-vjeçarin e parë të saj. Këtë gjë e kemi konstatuar si nga të dhënat e mbledhura gjatë analizimit të dosjeve të zgjidhjeve martesore pranë Gjykatës së rrethit Elbasan por gjithashtu e kemi konstatuar dhe gjatë intervistave dhe grupeve të fokusit të realizuara me pjesëmarrësit në studim. Çiftet që bëjnë divorc 2-3 vitet e para të martesës kanë si shkak kryesor mospërputhjen e karakterit. Këtë shkak e ndeshim vetëm te këto çifte. Martesa paraqet më tepër probleme gjatë fazës së dytë të saj kur çiftet janë bërë me fëmijë, gjë e cila kërkon më shumë impenjim nga bashkëshortët, si për rritjen e tyre po ashtu për të kontribuar ekonomikisht pasi nevojat e familjes janë më të mëdha gjatë kësaj periudhe. Problemet i shkaktojnë faktorë të jashtëm që kanë një ndikim jo të drejtpërdrejtë tek martesa por që efektet e tyre ndihen në cilësinë e jetës në çift.

Së dyti studimi konstatoi se nga familjet që përballen me vështirësi ekonomike si rezultat i papunësisë partnerët kryesisht burra detyrohen të emigrojnë në vende të tjera për të siguruar të ardhura për familjen e tyre. Një fakt i tillë ka sjellë ndryshime në jetesën në çift por është shoqëruar dhe me pasoja negative në marrëdhëniet e çiftit. Ndër dosjet e zgjidhjeve martesore dominojnë ato çifte që kanë pasur njërin apo të dy partnerët në emigracion. Gjatë studimit të këtyre dosjeve del se, si pasojë e jetesës së ndarë, bashkëshortët kanë probleme në marrëdhëniet e tyre si ftohje të marrëdhënieve, tradhëti bashkëshortore, shfaqjen e veseve të këqija të cilat nuk i kishin patur para se të emigronin. Këto probleme i kemi konstatuar dhe në intervistat e kryera gjatë studimit ku gratë e intervistuar shprehen se bashkëshortët kanë ndryshuar sjellje pas emigrimit.

Së treti studimi konstatoi se numri i divorceve është më i lartë në zonat urbane krahasuar me ato rurale. Kjo dukuri është më e përhapur në zonat urbane edhe pse popullsia është më e ulët. Kjo mund të lidhet edhe me mundësitë më të mëdha të grave për punësim si dhe për të siguruar një banesë me qera në këto zona gjë e cila është shumë e vështirë, thuajse e pamundur në zonat rurale. E pohojmë këtë fakt pasi referuar të dhënave nga dosjet e zgjidhjeve martesore por dhe nga intervistat gratë e divorcuara nga zonat rurale përgjithësisht pas divorcit shkojnë të jetojnë në shtëpinë e prindërve të tyre sepse nuk kanë mundësi të gjejnë një shtëpi me qera sepse nuk ka të tilla në këto zona. Ato përgjithësisht janë të papunësuar. Në këtë gjetje jemi në të njëjtin përfundim si dhe Vignoli & Ferro (2009) se rritja e pavarësisë ekonomike të grave rrit mundësinë për divorc.

Së katërti studimi konstatoi se numri i divorceve është më i lartë në çiftet me partnerë që kanë kryer ose jo vetëm arsimin e detyrueshëm 8-vjeçar. Çiftet me partner që kanë kryer vetëm arsimin e detyrueshëm 8-vjeçar shfaqin më tepër probleme ekonomike. Këto probleme vijnë si pasojë e mos pasjes së një profesioni të caktuar dhe vështirësive për të gjetur një punë të qëndrueshme. Pikërisht ky fakt bën që ato të emigrojnë për të siguruar të ardhura. Emigracioni i njërit partner më pas shkakton një sërë problemesh të tjera sociale të cilat çojnë këto çifte drejt divorcit. Prandaj referuar të dhënave kjo kategori përbën edhe numrin më të lartë të divorceve. Kjo gjetje nuk konstatohet në studime të mëparëshme mbi divorcin në Shqipëri

Janë të pakta në numër çiftet e divorcuar me partnerë që kanë kryer arsimin e lartë. Këtë gjë mund ta shohim në dy këndvështrime:

- a- Mirëarsimimi i partnerëve rrit stabilitetin në martesë pasi kanë më tepër mundësi punësimi dhe ekonomi më të qëndrueshme. Pra këto çifte kanë më pak probleme sociale pasi komunikojnë më mirë me njëri-tjetrin. Divorci tek këto çifte vjen kryesisht si rezultat i tradhëtisë bashkëshortore.
- b- Çiftet me partnerë të mirëarsimuar janë më të paktë në numër për arsye se një pjesë e vogël e popullsisë arrin të kryejë arsimin e lartë, ndërsa pjesa më e madhe e popullsisë arrin të kryejë vetëm arsimin e detyrueshëm. Nga të dhënat e Cencus 2011 grupmosha 25-39 vjeç, 45 përqind e meshkujve dhe 49 përqind e femrave rezultojnë të kenë kryer vetëm arsimin e detyrueshëm ndërsa 34 përqind e meshkujve dhe 26 përqind e

femrave të kësaj grupmoshe kanë kryer arsimin e mesëm. Në këtë grupmoshë arsimin e lartë e kanë kryer 15 përqind e meshkujve dhe 21 përqind e femrave. Përsa i përket grupmoshës 40-64 vjeç, 40 përqind e meshkujve kanë kryer arsimin e detyrueshëm dhe 47 përqind e femrave. Ndërsa po për këtë grupmoshë arsimin e mesëm e kanë kryer 42 përqind e meshkujve dhe 34 përqind e femrave. Arsimin e lartë në këtë grupmoshë e kanë kryer 12 përqind e meshkujve dhe 10 përqind e femrave (INSTAT. 2015, f. 38).

Kjo është një çështje e hapur e cila vlen për t'u diskutuar ose për të bërë studime rreth saj nga studiues të tjerë.

Së pesti studimi konstatoi se ndërhyrjet e prindërve të partnerëve në marrëdhëniet e çiftit kanë pasur një ndikim negativ në jetëgjatësinë e martesës. Këtë fakt e kemi konstatuar si gjatë analizimit të të dhënave nga dosjet e zgjidhjeve martesore po gjithashtu e kemi konstatuar edhe gjatë intervistave të kryera me pjesëmarrësit në studim. Ndërhyrjet e prindërve kanë nxitur mosmarrëveshje, të cilat me vonë janë kthyer në konflikte të vazhdueshme. Me kalimin e kohës kanë çuar në divorc ato çifte që e kanë pasur një problem të tillë. Ndërhyrjet e prindërve kanë nxitur mosmarrëveshje të cilat me vonë janë kthyer në konflikte të vazhdueshme. Si pasojë e tyre është krijuar ftohje e marrëdhënieve ndërmjet partnerëve dhe më vonë çiftet që kanë pasur një problem të tillë kanë shkuar drejt divorcit. Rastet e ndërhyrjeve të prindërve të bashkëshortëve kanë qenë më të shumta në numër krahasuar me prindërit e grave. Kjo vjen edhe për faktin se çifti dhe prindërit e bashkëshortit kanë jetuar në një banesë. Kjo gjetje nuk konstatohet në studime të mëparëshme të kryera mbi divorcin në Shqipëri por edhe në vende të tjera.

Gjatë studimi u konstatua se bashkëshortët kanë qëndruar të martuar për vitë të tëra edhe pse martesë ka qenë problematike në të mirë të fëmijëve të tyre. Çiftet shqiptare që bëjnë divorc kanë arsye shumë të forta para se ta ndërmarrin një veprim të tillë. Këtu nënkuptojmë një kombinim problemesh në marrëdhëniet e tyre të cilave partnerët nuk kanë arritur t'u japin zgjidhje tjetër veç divorcit. Në të gjitha rastet e divorceve të përfshira në studim, partnerët kanë pasur fëmijë gjatë martesës. Kjo gjë tregon se asnjëri partner nuk e ka dëshiruar divorcin por ai ka ndodhur si pasojë e rrethanave të krijuar në marrëdhëniet ndërmjet partnerëve.

Në këtë studim janë trajtuar në mënyrë specifike **çiftet që kanë pasur njërin apo të dy partnerët në emigracion.**

Këto çifte paraqesin një problematikë specifike që lidhet me mënyrën e jetesës që kanë pasur, si dhe me problemet që shfaqen gjatë ribashkimit të tyre në emigracion.

1- Në rastet kur partnerët kanë jetuar vetëm për një kohë të gjatë si pasojë e emigrimit të partnerit kjo gjë është shoqëruar me ftohje të marrëdhënieve në çift, tradhëti bashkëshortore si nga partnerët në emigracion por edhe nga partnerët që kanë qëndruar në Shqipëri. Kjo gjetje konstatohet në studimin e Beqja & Sokoli, (2000). Një fakt tjetër është se në shumë raste të studiuara konstatohet se emigrantët kanë krijuar lidhje të reja madje kanë pasur dhe fëmijë në vendet ku kanë emigruar.

2-Gjatë studimit kemi konstatuar se emigrantët që janë kthyer si pasojë e krizës që ka kapur vendet ku ata kishin qenë, kanë shfaqur vese të këqija të cilat nuk i kishin para se

të emigronin. Si pasojë e papunësisë ata janë bërë të varur nga alkooli, lojërat e fatit, bixhozi, madje në dy raste gjatë intervistave është pohuar se partnerët janë bërë të varur nga substancat narkotike. Kjo gjetje nuk konstatohet në studime të mëparëshme mbi divorcin në Shqipëri

3- Problem tjetër që u konstatua tek çiftet me partnerë në emigracion është se, edhe në rastet kur ata kanë bërë bashkim familjar dhe e gjithë familja ka emigruar, jetesa e përbashkët ka qenë e vështirë dhe ka shfaqur probleme mjaft të rënda dhe të pakapërcyeshme çka i ka detyruar disa nga këto çifte të bëjnë divorc. Këto probleme lidhen kryesisht me vështirësitë në përshtatje me mënyrën e jetesës pasi bashkëshortët kanë pasur një jetë të ndarë për shumë kohë. Kjo gjë ka sjellë dhe mosmarrëveshje e konflikte mes tyre të cilat lidhen kryesisht me probleme familjare. Si rezultat i tyre partneret gra kryesisht janë kthyer në Shqipëri dhe kanë bërë divorc. Edhe pse e kanë pritur për një kohë të gjatë mundësinë për t'u ribashkuar në emigracion marrëdhëniet pas emigrimit kanë qenë aq të vështira, saqë ka qenë e pamundur jetesa në çift. Kjo gjetje nuk konstatohet në studime të mëparëshme mbi divorcin në Shqipëri.

4- Gjatë studimit u konstatua fakti se pothuajse në të gjitha rastet e studiuara kemi të pranishme dhunën në marrëdhëniet bashkëshortore. . Kjo gjetje konstatohet në studimin e Beqja & Sokoli, (2000). Të gjitha problemet që shfaqen në familje apo ndërmjet partnerëve shoqërohen me dhunë.

Gjatë realizimit të grupit të fokusit dhe intervistave me gra që janë martuar para viteve 90-të kemi konstatuar **ndryshimin e mënyrës së jetesës në çift me ndryshimin e sistemit politik**. Ato sollën fakte konkrete të cilat tregojnë se si ka ndryshuar mënyra e jetesës në çift për shumë prej tyre të cilët kanë partner në emigracion. Pra me këtë kuptojmë se si partnerët kanë pasur jetesë të përbashkët dhe përgjithësisht më të qetë gjatë sistemit të kaluar, referuar të dhënave. Gjatë intervistave u konstatua se bashkëshortët kanë qenë të punësuar dhe kishin të ardhura të qëndrueshme edhe pse ishin të pakta. Me ndryshimin e sistemit politik dhe shfaqjen e emigracionit kjo gjë ka ndryshuar. Mbas emigrimit të bashkëshortit ata kanë pasur jetesë të ndarë e cila përgjithësisht ka shfaqur probleme të rënda ndërmjet partnerëve. Si pasojë e tyre shumë partnerë kanë parë si zgjidhje të vetme divorcin.

Një fakt tjetër që kemi konstatuar gjatë studimit është **dhe krijimi i kulturës së divorcit si rezultat i rritjes së shkallës së emancipimit të grave shqiptare për të drejtat dhe liritë e tyre brenda familjes**.

Studimi konstatoi se ndryshimi i sistemit politik, hapja e shoqërisë dhe emigracioni i shumë shqiptarëve, kanë ndikuar në ndryshimin e mentalitetit në Shqipëri përse i përket respektimit të të drejtave të grave. Kjo gjetje nuk konstatohet në studime të mëparëshme mbi divorcin në Shqipëri

Nga grupet e fokusit me gra të cilat janë martuar para viteve 90-të por edhe nga intervistat e realizuara doli në pah se ndërgjegjësimi i grave për të drejtat e tyre ka ardhur pas ndryshimit të sistemit politik. Mendësi tjetër kanë pasur gjatë sistemit të kaluar përse iu përket të drejtave të tyre e cila ka ndryshuar gjatë viteve të fundit. Ato pothuajse nuk i njihnin të drejtat e tyre

dhe për më tepër të prisnin që të respektoheshin nga bashkëshortët e tyre. Gjatë grupeve të fokusit u konstatua se kohët e fundit gratë janë bërë më të ndjeshme dhe reagojnë ndaj shkeljes së të drejtave të tyre në familje, gjë të cilën nuk e kishin bërë më parë për shkak të mentalitetit ekzistues, shprehen ato. Hapja e shoqërisë nga ana tjetër ka bërë që të rritet shkalla e emancipimit të grave. Studimi konstaton se emigracioni solli një frymë të re përsa i përket zhvillimit dhe emancipimit të grave emigrante. Gjatë intervistave vihet re se ato janë më pak tolerante ndaj problemeve që shkaktojnë burrat në familje. Kërkojnë më shpejt për t'u ndarë nga bashkëshortët e tyre problematikë krahasuar me gratë që nuk kanë emigruar ndonjëherë. Këtu dalim në përfundimin se ato duke jetuar për disa vjet në një vend të huaj janë përshtatur me kulturën vendase duke qenë në marrëdhënie të vazhdueshme me komunitetin ku kanë emigruar. Komunikimet e vazhdueshme midis tyre dhe vendasve nga pikëpamja kulturore, sidomos për gratë, ka ndikuar në rritjen e shkallës së emancipimit të tyre. Në disa intervista konstatohet se ato janë ndikuar nga mjedisi kulturor ku kanë jetuar gjatë emigrimit për të ndryshuar pikëpamjet që kishin për rolin dhe të drejtat e tyre në familje. Ato i njohin mirë të drejtat e tyre dhe kanë hedhur pas krahëve mendësinë e pushtetit të padiskutueshëm të burrit në familje. Për këtë gjë kërkojnë të respektohen dhe t'u jepet vendi që u takon në familje.

Studimi konstatoi krijimin e kulturës së divorcit në shoqërinë shqiptare. Kultura e divorcit në Shqipëri ka një specifikë të veçantë e cila lidhet vetëm me realitetin tonë. Në shoqëritë e tjera kulturën e divorcit e kuptojmë si rritje të shkallës së barazisë ndërmjet partnerëve në një martesë, ndërsa në vendin tonë e kuptojmë si një reagim me kërkesën për divorc të bërë

nga gratë të cilave u janë shkelur të drejtat apo janë dhunuar. Kjo gjetje nuk konstatohet në studime të mëparëshme mbi divorcin në Shqipëri

Gjatë studimit të kryer nëpërmjet intervistave dhe grupeve të fokusit u konstatua se gratë kanë pasur martesë problematike por nuk kanë guxuar të kërkojnë divorc si rezultat i mentalitetit. Në një realitet të tillë shoqëror as që mund të mendojmë ekzistencën e kulturës së divorcit. Gjatë grupeve të fokusit por edhe gjatë intervistave u konstatua se edhe gra intelektuale nuk kanë bërë divorc nga frika e paragjytimeve që mund t'u bënte shoqëria dhe kanë duruar për vite të tëra marrëdhëniet problematike me bashkëshortin dhe shpesh edhe dhunën e ushtruar prej tij. Me ndryshimet politike dhe shoqërore kemi reagimin e grave ndaj problemeve në martesë. Ato nuk qëndrojnë më të heshtura para shkeljes së të drejtave apo dhunës së ushtruar ndaj tyre nga bashkëshorti. Ato kërkojnë divorc kur martesë e tyre paraqet probleme të tilla. Rritja e numrit të kërkesave për divorc që janë bërë nga gratë nënkupton jo vetëm reagimin e tyre, por dhe krijimin e kulturës së divorcit si një element që i kishte munguar kulturës së shoqërisë sonë. Studimi konstatoi se nuk kemi rritjen e barazisë ndërmjet burrave dhe grave në martesë, por në realitetin shqiptar kemi reagimin e grave ndaj shkeljes së të drejtave të tyre dhe abuzimit që i bëhet duke u dhunuar fizikisht nga bashkëshortët e tyre. Kjo mund të quhet kulturë e divorcit në shoqërinë shqiptare.

Studimi evidentoi **vështirësitë ekonomike me të cilat janë përballur çiftet gjatë kohës që kanë qenë të martuar dhe pas divorcit.** Gjatë studimit të martesat u zbulua ndikimi i faktorit ekonomik në dy mënyra:

Ekonomia e dobët është faktor destabilizues për martesën referuar të dhënave nga studimi. Çiftet me partnerë që nuk kontribuojnë ekonomikisht, apo që shpërdorjnë të ardhurat e familjes, kanë marrëdhënie konfliktuale ndërmjet tyre. Varfëria ka ndikim negativ në jetëgjatësinë e martesës sidomos kur çifti ka dhe fëmijë, pasi nevoja për para është më e madhe. Konfliktet intensifikohen me kalimin e kohës e më pas shoqërohen me dhunë. Ekonomia e dobët që shkaktohet nga shpërdorimi i të ardhurave në lojëra fati, bixhoz e bën martesën të jetë më e ekspozuar ndaj divorcit. Kjo gjetje konstatohet edhe nga Tushi, G. (2012).

Ekonomia e qëndrueshme e partnerëve si rezultat i një punë me pagesë të mirë, mund të rrisë mundësinë për divorc, nëse martesa ka probleme në marrëdhëniet ndërmjet partnerëve, si konflikte të dhunshme, tradhëti bashkëshortore, ndërhyrjen e prindërve në marrëdhëniet e partnerëve etj.. Punësimi i grave i bën ato më të pavarura dhe të reagojnë me divorc kur kanë probleme të tipit social por dhe ekonomik. Si nëpërmjet intervistave, po ashtu edhe nga studimi i dosjeve të zgjidhjeve martesore, u konsatua se kur bashkëshortët shpërdorjnë paratë e fituara nga puna e grave ato kërkojnë divorc. Kjo gjetje nuk konstatohet në studime të mëparëshme mbi divorcin në Shqipëri

Studimi konstatoi se pas divorcit gjendja ekonomike e partnerëve ka ndryshuar në varësi të problemeve ekonomike që kanë pasur partnerët gjatë martesës. Kur divorci ka ardhur si rezultat i shpërdorimit të parave nga partneri ndarja prej tij është shoqëruar me rritje në aspektin ekonomik. Në rastet kur partnerët e divorcuar kanë qenë të papunë gjendja e tyre ekonomike ka rezultuar më e rëndë pas divorcit, po kështu jetesat është vështirësuar

dhe shumë prej grave janë kthyer për të jetuar me prindërit e tyre sepse nuk kanë pasur zgjidhje tjetër. Gjithashtu studimi konstatoi se nëse partnerët kanë probleme serioze në marrëdhëniet e tyre ata bëjnë divorc edhe pse gjendja ekonomike pas divorcit mund të përkeqësohet. Kjo gjetje nuk konstatohet në studime të mëparëshme mbi divorcin në Shqipëri.

Gjatë studimit u konstatua se periudha pas divorcit është shoqëruar me vështirësi në aspektin social në varësi të problemeve të cilat e kanë çuar çiftin në divorc. Kur divorci ka ardhur si pasojë e mosmarrëveshjeve, konflikteve, dhunës, partnerët pas divorcit kanë pasur një jetë sociale dhe familjare më të qetë. Kjo gjetje nuk konstatohet në studime të mëparëshme mbi divorcin në Shqipëri. Në asnjë studim tjetër nuk është analizuar ky problem.

Gjatë studimit u konstatua se **divorci shoqërohej me pasoja psikologjike si për partnerët po ashtu edhe për fëmijët e tyre.** Psikologet e gjykatës pohuan vështirësitë e fëmijëve në zgjedhjen e prindit me të cilin do të vazhdojnë të jetojnë pas divorcit të tyre. Nga ana tjetër, si pasojë e një martese me probleme të zgjatura, partnerët kryesisht gratë paraqesin probleme psikologjike përgjithësisht stres, depresion. Ndërsa gjatë intervistave me pjesëmarrës të cilët kishin pak kohë që kishin kryer zgjidhje të martesës u konstatua se divorci nuk ishte i lehtë dhe shoqërohej me pasoja psikologjike dhe gjendje të rënduar

emocionale. Kjo gjetje nuk konstatohet në studime të mëparëshme mbi divorcin në Shqipëri.

Studimi evidentoi **ndryshimet në aspektin ligjor të procedurave për divorc si dhe ndikimet e tyre në rritjen e numrit të divorceve.**

Studiues të huaj (Salvini & Vignoli, 2011, f.164), (Yodanis, C. 2005, f.656) në vendet e tyre kanë konstatuar se vështirësitë në aspektin ligjor për kryerjen e divorcit si dhe kostoja ekonomike e lartë ndikon në frenimin e çifteve për të bërë divorc. Një fenomen i tillë ka ndodhur dhe në Shqipëri para ndryshimit të sistemit. Krahas vështirësive në aspektin ligjor përse i përket përcaktimit të bashkëshortit fajtoj për zgjidhjen e martesës si dhe masa për edukimin e tij në shoqëri ishte e përhapur edhe stigma që i bëhej divorci nga opinion publik. Para fakteve të tilla bashkëshortët pranonin të jetonin në një martesë problematike më mirë se të divorcoheshin. Kjo ka ndikuar në numrin e ulët të divorceve që janë kryer në atë periudhë. Problemet që shfaq familja sot si dhe lehtësitë në aspektin ligjor kanë ndikuar në rritjen e numrit të divorceve gjatë viteve të fundit në Shqipëri. Me pak seanca gjyqi gjatë një periudhe të shkurtër kohore zgjidhja martesore merr fund. Duhet përmendur se dhe kostoja ekonomike për realizimin e gjyqit nuk është e lartë për tu përballuar nga bashkëshortët që e kërkojnë atë.

Studimi konstatoi **rolin e shtetit dhe institucioneve të tij në ndërmarrjen e politikave për rritjen e punësimit në vend.** Nga studimi dhe analizimi i dosjeve të zgjidhjeve martesore

gjithashtu edhe nga të dhënat e intervistave del se partnerët kanë emigruar si rezultat i gjendjes së vështirë ekonomike dhe papunësisë në vend. Me emigrimin e tyre ata kanë zgjidhur problemin ekonomik që kishin familjet e tyre, por nga ana tjetër kanë dalë probleme sociale në marrëdhëniet ndërmjet partnerëve. Siç e kemi përmendur edhe më lart, si pasojë e jetës larg njëri-tjetrit kemi ftohjen e marrëdhënieve në çift, probleme me tradhëtinë bashkëshortore, lidhje jashtë martesore të cilat janë bërë shkas për divorc të bashkëshortëve. Studimi konstatoi se këto probleme nuk kishin ekzistuar për sa kohë partnerët kanë jetuar pranë njëri-tjetrit, ato janë shfaqur pas emigrimit të njërit partner. Emigracioni ka pasur impakt negativ në marrëdhëniet bashkëshortore dhe në jetëgjatësinë e martesës. Referuar të dhënave nga dosjet e divorcit pjesën më të madhe të tyre e përbënin çifte të cilët kishin pasur njërin apo të dy partnerët në emigracion. Pra, rritja e divorcit është shkaktuar më së shumti nga emigracioni si rezultat i problemeve që krijon ai në jetën bashkëshortore. Pikërisht nga një konstatim i tillë del si detyrë për shtetin dhe institucionet e tij që të frenojnë emigrimin e shqiptarëve si rezultat i papunësisë. Duke frenuar emigracionin do të shfaqen më pak probleme në marrëdhëniet ndërmjet partnerëve pasi ata kanë jetesë të përbashkët dhe rrjedhimisht do të eliminohen problemet që krijohen si rezultat i largimit të njërit partner. Me eliminimin e tyre do të kemi dhe uljen e numrit të divorceve dhe sidomos ato që shkaktohen si rezultat i emigracionit. Ulja e shkallës së emigracionit mund të arrihet nëse do të krijohen më tepër mundësi për punësim në vend. Gjatë intervistave u konstatua se bashkëshortët kishin emigruar jo nga dëshira, por nga nevoja për punë. Kjo gjë nënkupton se ata nuk do të kishin emigruar nëse do të punësoheshin në vend.

Gjatë studimit u kontsatua se shteti ka filluar të ndërhyjë nëpërmjet institucioneve të tij për të rritur punësimin e të rinjve, kryesisht në sektorin e bujqësisë i cili ishte pothuajse i braktisur, ndërkohë që pjesa më e madhe e emigrantëve janë nga zonat rurale. Rritja e punësimit në këtë sektor nëpërmjet strategjive afatgjata ka sjellë ngushtimin e hendekut të papunësisë ndërmjet burrave dhe grave pasi numrin më të madh të të punësuarve në këtë sektor e përbëjnë ato. Gratë e divorcuara nga zonat rurale kanë pohuar gjatë intervistave se kryejnë punë në bujqësi, kryesisht në tokat që i kanë pronë të tyre. Ndërhyrja e institucioneve shtetërore për të rritur punësimin duhet të ndihet edhe në sektorë të tjerë pasi sektori i bujqësisë siç shprehen të punësuarat nuk është shumë fitimprurës për to dhe nuk i plotëson të gjitha nevojat ekonomike të familjes. Realizimi i një politike efikase për të rritur punësimin në vend do të mënjanonte emigracionin dhe divorcin e shkaktuar prej tij. Një detyrë tjetër për shtetin dhe institucionet e tij janë krijimi i mundësive për emigrim familjar për ata që kanë dëshirë të emigrojnë me qëllim që të mos shfaqen ato probleme që konstatuam gjatë studimit të cilat i kemi përmendur dhe më lart.

5. 2. Rekomandime për studime të mëtejshme

Divorci si një problem social është mjaft kompleks. Ky studim u fokusua në problemet që solli tranzicioni i tejzgatur që po kalon shoqëria jonë. Tranzicioni nga ana e tij u shoqërua me gjendje të vështirë ekonomike, papunësi, emigrim ilegal mjaft problematik si për ata që emigruan, por dhe për familjet që lanë pas. Të gjitha këto probleme shoqërore u konstatuan në familjet shqiptare por edhe në marrëdhëniet e bashkëshortëve. Të ndodhura në një situatë të tillë këto marrëdhënie u tronditën rëndë saqë shumë çifte shkuan në divorc.

Studimi u fokusua gjithashtu në pasojat ekonomike, sociale dhe psikologjike tek personat e divorcuar se si kishte ndikuar divorci te kjo kategori.

Nga ana tjetër studimi u fokusua gjithashtu edhe në ndryshimin e mentalitetit për divorcin që gjatë sistemit të kaluar stigmatizohej duke u konsideruar një turp. Hapja e shoqërisë si pasojë e ndryshimit të sistemit dhe emigrimit të shumë shqiptarëve në vende me ekonomi dhe kulturë më të zhvilluar se e jona, bashkëjetesa me vendasit, komunikimi i vazhdueshëm me ta ka sjellë dhe ndryshimin e mentalitetit për marrëdhëniet në çift si dhe divorcin. Studimi konstatoi krijimin e kulturës së divorcit si një reagim i grave me kërkesë për divorc ndaj shkeljes së të drejtave të tyre në familje. Kjo gjë tregon dhe rritjen e shkallës së emancipimit të gruas shqiptare. Studiues të tjerë të shkencave sociale mund të kryejnë studime cilësore ose sasimore për të matur shkallën e rritjes së emancipimit të gruas shqiptare gjatë sistemit të ri demokratik dhe ndikimit të emancipimit në rritjen e numrit të divorceve në Shqipëri. Studimi u fokusua tek të dhënat nga dosjet e divorcit të marra gjatë periudhës kohore 2008-2014 si dhe intervistave të realizuara gjatë periudhës kohore 2013-2015. Gjatë kësaj hapësire kohore në qarkun e Elbasanit u konstatuan këto probleme në familje dhe marrëdhëniet martesore të cilat u paraqitën më lart. Studiues të tjerë mund të kryejnë një studim me karakter kombëtar përse i përket dukurisë së divorcit dhe shkaqeve në rritje të tij.

SHTOJCE

INTERVISTE

Përshëndetje!

Unë quhem Alketa Molla, mësuese pranë gjimnazit “Luigj Gurakuqi” Elbasan. Aktualisht jam duke kryer studimin e doktoraturës në fushën e sociologjisë dhe po studioj divorcin, ndikimin që ka pasur emigracioni dhe hapja e shoqërisë në rritjen e numrit të tij në qarkun e Elbasanit. Të dhënat nga intervista juaj do të përdoren për arsye studimore si dhe do të ruhet konfidencialiteti i tyre. Në studim do të përdoren vetëm inicialet tuaja për të vërtetuar origjinalitetin e intervistës suaj. A pranoni të bashkëpunoni në kryerjen e intervistës?

Pjesa e parë: Karakteristika sociale dhe demografike

1. *Emri dhe Mbiemri ose inicialet:*
2. *Mosha:*

3. *Vendlindja: Qyteti / Fshati*
4. *Vendbanimi: Vendi ku po jeton aktualisht?*
5. *Arsimi: Specifiko nivelin e arsimit të kryer*
6. *A jeni i / e punësuar?*
7. *Sa kohë keni që jeni divorcuar?*

PJESA E DYTE; karakteritika të përgjithshme të partnerëve dhe realizimit të martesës

- 8- *Sa vjeç jeni martuar ju?*
- 9- *Sa vjeç ishte partneri juaj kur u martuat?*
- 10- *Si është realizuar martesa me dashuri apo mblesëri?*
- 11- *A keni bashkëjetuar me partnerin para se të martoheshit?*
- 12- *Mbas martese keni jetuar më vete apo me prindërt tuaj ose të partnerit?*
- 13- *A keni fëmijë dhe nëse po, sa fëmijë keni?*
- 14- *Si kanë qenë marrëdhëniet tuaja martesore pas ardhjes në jetë të fëmijëve?*

PJESA E TRETË; Evidentimi i shkaqeve të problemeve në martesë.

- 15- *Kur ka emigruar për herë të parë bashkëshorti juaj?*
- 16- *Cilat ishin arsyet e emigrimit të tij?*
- 17- *Përse nuk keni emigruar familjarisht?*

18- Përse nuk keni bërë bashkim familjar kur ai u pajis me leje qëndrimi?

19- Sa kohë ka qëndruar në emigracion?

20- Sa herë në vit kthehej pranë familjes?

21- Sa kohë qëndronte kur kthehej?

PJESA E KATERT; Ndikimi i emigracionit në marrëdhëniet martesore

22- Si ishin marrëdhëniet tuaja bashkëshortore para se bashkëshorti juaj të emigronte?

23- Si ka ndikuar emigracioni tek ai si njeri?

24- Si ndikoi emigrimi në sjelljen e tij?

25- Si sillej ai me ju para dhe pas emigrimit?

26- Si ishin marrëdhëniet tuaja gjatë kësaj periudhe?

27- Si ka ndikuar emigracioni në marrëdhëniet tuaja bashkëshortore?

28- A mendon se këto marrëdhënie do të ishin më të mira nëse ju do të emigronit bashkë?

29- A mendoni se martesa juaj do të kishte më pak probleme nëse bashkëshortri juaj nuk do të emigronte?

PJESA E PESTE; Kërkesa për divorc

30- Cilat ishin arsyet që të nxitën për të bërë kërkesë-padinë për divorc?

31- A menduat se kjo ishte zgjidhja më e mirë për ju dhe fëmijët tuaj?

32- A i morët parasysh pasojat psikologjike që mund të kishin fëmijët tuaj nga divorci?

33- A menduat që edhe ju vetë mund të kishit pasoja nga divorci?

34- A e morët parasysh se ku dhe me çfarë të ardhurash do të jetonit pas divorcit?

35- A folët me dikë tjetër para se të vendosnit për të bërë kërkesën për divorc?

36- Me kë biseduat konkretisht?

37- Cili ishte mendimi i tij / saj në lidhje me vendimin që ju kishit marrë?

38- Si e pritë bashkëshorti juaj këtë vendim?

39- Si reagoi ai më pas?

40- A menduat ndonjëherë gjatë kësaj kohe që t'i ndërprisnit procedurat e divorcit?

PJESA E GJASHTË; Periudha pas divorcit

41- Si u ndjetë ju pas divorcit? A ishit më të qetë emocionalisht? A mund të më thoni se si e përjetuat ju periudhën pas divorcit?

42- Po fëmijët tuaj si e pritën divorcin?

43- Si e përjetuan ata ndarjen e prindërve? A patën probleme psikologjike fëmijët pas divorcit?

44- Si i zgjidhët ju këto probleme?

45- A mendoni se keni bërë gjënë e duhur duke u ndarë nga partneri?

46- Çfarë ndodhi me gjendjen tuaj ekonomike? A u përmirësuan apo u përkeqësuan të ardhurat tuaja?

PJESA E SHTATË; Pikëpamje të ndikimit të emigracionit tek martesat

47- Çfarë mendimi keni ju për emigrimin? Si ndikon ai në marrëdhëniet martesore?

48- A mendoni se ai është shkaktar për divorcin e shumë çifteve?

49- Po për emigrimin familjar çfarë mendimi keni?

50- A mendoni se martesat do të ishte më pak e kërcënuar nga divorci nëse do të emigronit të gjithë së bashku?

51- A duhet të marrin masa institucionet shtetërore për frenimin e emigracionit?

52- Si mendoni ju, çfarë masa konkrete duhet të marrin këto institucione?

53- A mendoni se mundësia për punësim në vend do të frenonte emigrimin?

54- A mendoni se kjo gjë do të ndikojë në uljen e numrit të divorceve që vijnë si pasojë e emigracionit?

Faleminderit!

(shtojcë) Pyetjet shtesë për grupet e fokusit

Dhuna ndaj bashkëshortes, partneres.

- 1- A jeni dhunuar nga bashkëshorti juaj?*
- 2- Kur ka filluar t'ju dhunojë për herë të parë?*
- 3- Specifiko çfarë lloj dhune përdorte ai fizike apo psikologjike?*
- 4- Përse ju dhunonte ai? Cilat ishin arsyet?*
- 5- Ju dhunonte vetëm apo në prani të fëmijëve?*
- 6- Çfarë bënit ju më pas? Përse nuk e denoncuat këtë gjë?*
- 7- Cilat ishin arsyet që ju penguan?*
- 8- Për sa kohë keni qenë e dhunuar?*
- 9- Si ndodhi që vendosët të denonconit dhunën e ushtruar ndaj jush? Kush ndikoi në këtë vendim?*
- 10- A mendoni se duhet ta kishit bërë më parë një gjë të tillë?*

BIBLIOGRAFIA

Aleanca Gjinore për Zhvillim. *Dhuna në familje në fokusin e medias - Guidë* (2008). Tiranë:

Amato, P. R. & D. Previti (2003). *People's reasons for divorcing*. "Journal of Family" vol. 24, No. 5 (marrë nga: <http://www2.psychology.uiowa.edu/faculty/harvey/People's%20Reasons%20for%20Divorcing.pdf>).

Amato, P.R. & B. Beattie (2011). *An analysis of state data 1960–2005*. "Social Science Research" (marrë nga: <http://www.elsevier.com>).

Ambert, A.M. (2009). *Divorce; Facts, Causes & Consequences*. "Contemporary Family Trends" (marrë nga: <http://thefamilywatch.org/doc/doc-0073-es.pdf>).

Graaf, P.M. (de) & M. Kalmijn (2006). *Change and stability in the social determinants of divorce; A comparison of marriage cohorts in the Netherlands*. "European Sociological Review" vol. 22, nr. 5, f. 561-572.

Bajraba, K. (1995). *Pauzat e integritetit*. Tiranë: Shtëpia botuese Europa.

Becker, G. S; E. M. Landes; R.T. Michael (1977). *An Economic Analysis of Marital Instability*. "Journal of Political Economy" vol. 85, no. 6 (marrë nga: http://www.unc.edu/courses/2010fall/econ/586/001/Readings/Becker_Landes_Michael.pdf

Beqja, H. & Sokoli, L. (2000). *Divorci; Vrojtme e refleksione*. Tiranë: Dudaj & Rinia.
Po ata (2004). *Familja Tradicionale Shqiptare dhe Alternativat e saj*. "Politika dhe Shoqëria" vëll.7, nr. 2, f 74.

Bernardi & Martínez-Pastor (2011). *Divorce risk factors and their variation over time in Spain*. "Demographic Research" vol. 24, Article 31 (marrë nga: <http://www.demographic-research.org/volumes/vol24/31/24-31.pdf>).

Bijwaard, G.E. & S. Doeselaar (van) (2012). *The Impact of Divorce on Return-Migration of Family Migrants*. IZA/ Discussion Paper No. 6852.

Chan, T.W. & B. Halpin (2008). *The Instability of Divorce Risk Factors in the UK* (marrë nga: <http://users.ox.ac.uk/~sfos0006/papers/change8.pdf>).

Carletto, C. Davis, B. Stampini, M. Zezza, A. (2006). *A country on the move: international migration in post-communist Albania*, International Migration Review, 40(4),

Carletto, C. Davis, B. Stampini, M. Trento, S. Zezza, A.: (2004) *Internal Mobility and International Migration in Albania*, 04-13.

Cavounidis, J. (2004) “*Migration to Greece from the Balkans*”. South Eastern Europe Journal of Economics Vol. 2, 35-59
(marrë nga: <http://www.asecu.gr/Seeje/issue03/cavounidis.pdf>)

Davila, J. Brandbery, TH. N. (2001) “*Attachment Insecurity and the Distinction Between Unhappy Spouses Who Do and Do Not Divorce*”. Journal of Family Psychology. Vol. 15, N. 3.
(marrë nga: <http://www.psychology.sunysb.edu/attachment/danfords2002/documents/davila1.pdf>)

Dervishi, Z. (2003) : *Vështrime të kryqëzuara në det. Sociologji kulture1*, Jerusalem, Tiranë

Ferraro, Garry & Andreatta, Lusa (2010) "Cultural Anthropology, An Applied Prespective" Belmont, CA: Wadsworth, : 206-283

Forumi i Gruas Elbasan, USAID, (2013) “Raport mbi monitorimin rregullshmërisë së proceseve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan”

Gëdeshi, I. (2010) *Global Crisis and Migration. Monitoring a Key Transmission Channel to the Albanian Economy A joint study by IOM and UNDP with the support of WB, CESS, IOM*, Tiranë.

Gidens, A. (1996) “Sociologjia” Çabej

Gottman, J. Levenson, R. Y. (2000) “*The Timing of Divorce: Predicting When a Couple Will Divorce Over a 14-Year Period*”. Journal of Marriage and the Family 62: 737-745

(marrë nga : <http://ist-socrates.berkeley.edu/~ucbpl/docs/61-Timing%20of%20Divorce00.pdf>)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, Të dhëna nga Zyra e psikologut të gjykatës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, Evidenca statistikore për çështje civile.

Hackstaff, K. B. (2009) : “*Marriage in a Culture of Divorce*”.

(marrë nga: http://www.temple.edu/tempress/titles/1407_reg.html)

Hammond, R. J.: (2010) “Sociology of the Family”

Härkönen, J. Dronkers, J. : (2006) “ *Stability and Change in the Educational Gradient of Divorce. A Comparison of Seventeen Countries*”. European Sociological Review Vol. 22 N. 5. 501–517

(marrë nga:
<http://apps.eui.eu/Personal/Dronkers/articles/europeansociologicalreview2006.pdf>

Härkönen, J. : (2013) “*Divorce: Trends, Patterns, Causes, Consequences*”.

(marrë nga:
http://www.su.se/polopoly_fs/1.133184.1366922030!/menu/standard/file/WP_2013_3.pdf

Hiller, V. Recoules, M. : (2009) “*Divorce decisions, divorce laws and social norms*”.

Publikuar në: <http://www.parisschoolofeconomics.eu/IMG/pdf/Magali.pdf>

INSTAT. (2015) “Femra dhe meshkuj 2015”

INSTAT. (2014) “Migracioni në Shqipëri 2014”

Jalovaara, M. : (2003) “*The joint effects of marriage partner’s socioeconomic positions on the risk of divorc*”. Demography, Vol. 40-N. 1,; 67-81

(marrë nga: <http://blogs.helsinki.fi/pmartika/files/2009/01/jalovaara-2003.pdf>)

Karney, B. R. Bradbury, Th. N.; (1995) “*The longitudinal Course of Marital Quality and Stability: A review of Theory, Method, and Research*”. Psychological Bulletin, Vol. 118. N.1

(marrë nga:
http://www.academia.edu/660843/The_longitudinal_course_of_marital_quality_and_stability_A_review_of_theory_methods_and_research)

Kalmijn, M. Loeve, A. Mantin, D. ; (2007) “*Income dynamics in couples and the dissolution of marriage and cohabitation*”. Demography, Vol. 44, N. 1,

(marrë nga: <http://www.baylorisr.org/wp-content/uploads/matthijs1.pdf>)

Kalmijn, M. Poortman, A. (2006) “*His or Her Divorce? The Gendered Nature of Divorce and its Determinants*”. European Sociological Review Vol. 22. N. 2. p. 201–214

Këshilli i Evropës (2006) Fjalor i Sigurimeve Shoqërore, Shkup

Kulu, H. Boyle, P. J. (2010) “*Premarital cohabitation and divorce: Support for the “Threal Marriage” Theory*”? Demographic Research: Vol. 23, 31
(marrë nga: <http://www.demographic-research.org/volumes/vol23/31/24-31.pdf>)

Malaj, N. Sokoli, L. (2013) “Problemet sociale bashkohore”

Matthews, B.; Ross, L.:(2010) *Metodat e hulumtimit. Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane*. CDE.

Ministrie e Drejtësisë (2009) “Vjetari statistikor”

Ministria e Drejtësisë (2010) “Vjetari statistikor”

Ministria e Drejtësisë (2011) “Vjetari statistikor”

Ministria e Drejtësisë (2012) “Vjetari statistikor”

Ministria e Drejtësisë (2013) “Vjetari statistikor”

Papajani, A.:(2014) *Kërkimi shkencor*. Mediaprint.

Projekti i Njësisë së Barazisë Gjinore dhe Shoqërisë Civile pranë Organizatës për Sigurim dhe Bashkëpunim në Europë, Prezenca në Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. “*Strategjia kombëtare për barazinë gjinore dhe kundër dhunës në familje 2007-2010*”

Qendra e Publikimeve Zyrtare, (2004) “*Kodi i familjes i Republikës së Shqipërisë*”.

Rands, M. Levinger, G. (1979) “*Implicit Theories of Relationship: An Intergenerational Study*”. Journal of Personality and Social Psychology, Vol. 37, No. 5, 645-661
(marrë nga: http://people.umass.edu/levinger/1980_Implicit%20theories%20of%20relationship.pdf)

Salvini, S. Vignoli, D. : (2011) “*Things change: Women’s and men’s marital disruption dynamics in Italy during a time of social transformations, 1970–2003*”. Demographic Research: Vol. 24, 5,
(marrë nga: <http://www.demographic-research.org/volumes/vol24/5/24-5.pdf>)

Sokoli, L.: (2006) “Analizë sociologjike”. Tirane: Insituti i Sociologjisë & Rinia.

Sokoli, L.: (2009) “*Hyrje në sociologji*” (Ribotim), Instituti i Sociologjisë, Kristalina-HK.

Sokoli, L.: (2011) “*Metodat e kërkimit*”, Instituti i sociologjisë, Kristalina-HK.

SOS. Fshatrat e fëmijëve në Shqipëri, (2012) “Legjislacioni shqiptar mbi statusin e jetimit. Analizë e nevojave për ndryshime”.

publikuar

në:

<http://www.soskd.org.al/doc/SOS%20AL%20Statusi%20Jetimit%20Analize%20Ligjore.pdf>

nga: SOS

Thibaut, J.W., & Kelly, H.H. (1959). “The social psychology of groups”. New York: Wiley, H. & Song, Inc.

(marrë nga: <https://archive.org/stream/socialpsychology00thib#page/128/mode/2up>)

Tushi, G. (1012) “*Martesa Familja Seksualiteti*”

Tushi, G. (2006) “*Probleme dhe dilemma sociale*”

UNICEF (2009) “Migracioni shqiptar ndikimi i tij në jetën ekonomike dhe sociale të fëmijëve të lënë pas”

Vignoli, D. Ferro, I.: (2009) “*Rising marital disruption in Italy and its correlates*”. Demographic Research: Vol. 20, 4.

(marrë nga: <http://www.demographic-research.org/volumes/vol20/4/20-4.pdf>)

Wolfinger, N. H. (2005). “*Understanding the divorce cycle: The children of divorce in their own marriages*”. Cambridge University Press.

Yodanis, C.: (2009) “*Divrce culture and marital gender equality*”. SAGE Publications on June 26,